



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHEVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**

**“MBI PËRKTHIMIN SHQIP TË ROMANIT PLAKU DHE DETI: KRAHASIM
PËRKTHIMI PËRMES SHITJELLIMIT LETRAR”**

**PUNIM PËR GRADËN DOKTOR I SHKENCAVE
NË GJUHËSI**

Komisioni:

- | | |
|------------------------------------|----------|
| 1. Prof. Dr. Viktor RISTANI | Kryetar |
| 2. Prof. Dr. Shpresa QATIPI (RIRA) | Oponente |
| 3. Prof. Dr. Seit MANCAKU | Oponent |
| 4. Prof. Dr. Enver HYSA | Anëtar |
| 5. Prof. Asoc. Dr. Mirela PAPA | Anëtar |

Përgatiti:
MSc. Silvana DERVISHI

Udhëheqës shkencor:
Prof. As. Dr. Ukë ZENEL Buçpapaj

TIRANË 2020

FALENDERIME

Dua t'i shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e mia cilitdo që, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, më ka nxitur, më ka mbështetur dhe më ka ndihmuar, për të bërë këtë punim në lëmin e përkthimit.

Së pari, kam kënaqësinë të falënderoj Udhëheqësin Shkencor, Prof. As. Dr. Ukë Zenel BUÇPAPAJ, i cili, përmes gatishmërisë, njohurive dhe përvojave të veta, më dha mundësi që ta merrja përsipër dhe ta përfundoja këtë studim, qoftë si sfidë, qoftë si përgjegjësi, si dhe ndoqi hap pas hapi ecurinë time me përkushtim dhe me kompetencë profesionale.

Shpreh falënderime të veçanta për Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në përgjithësi, si dhe për Departamentin e Gjuhës Angleze në veçanti, që me dashamirësi m'i kanë hapur të gjitha “dyert” ligjore dhe njerëzore, falë të cilave ndodhem sot para këtij Komisioni të Nderuar, duke mbrojtur Disertacionin me temë **“Mbi përkthimin shqip të romanit *Plaku dhe deti*: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar”** në kërkim të Gradës Shkencore “Doktor”.

Së fundi, do të doja të shprehja falënderimet e mia të padiskutueshme për gjithë familjen time, për dashurinë e tyre të pamasë dhe për mirëkuptimin dhe nxitjen e pafund gjatë këtyre viteve.

Faleminderit!

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	4
0.1 Përligjja e punimit	4
0.2 Qëllimi i studimit dhe rezultatet e pritshme	4
0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit	5
0.4 Struktura e punimit	5
Kreu i parë	8
Gjuha dhe kultura	8
1.1 Llojet e përkthimit.....	9
1.2 Shifrimi dhe deshifrimi	10
Kreu i dytë	16
Probleme të ekuivalencës	16
2.1 Çfarë humbet dhe çfarë fitohet	21
2.2 Papërkthyeshmëria	22
Kreu i tretë	26
Kapërcimi i pengesave përkthimore.....	26
Kreu i katërt	34
4.1 Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar (<i>The Old Man and the Sea</i> versus <i>Plaku dhe deti</i>).....	34
4.1.1 Ernest Heminguei: Jeta dhe vepra (1899-1961)	34
4.1.2 <i>Plaku dhe deti</i> (1952): Përmbledhje e shkurtër	40
4.1.3 Pjesa 1: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar	55
4.1.4 Pjesa 2: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar	62
4.1.5 Pjesa 3: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar	69
4.1.6 Pjesa 4: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar	76
4.1.7 Pjesa 5: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar	83
4.1.8 Pjesa 6: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar	88
4.1.9 Pjesa 7: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar	96
4.2 Analiza e personazheve	103
4.3 Simbolizmi dhe motivet	106
4.4 Stili dhe struktura e të shkruarit.....	111
4.5. Ekonomia e fjalës te <i>Plaku dhe deti</i> në gjuhën përkthimore	111
Kreu i pestë	289
Përfundime.....	289
Literatura Kryesore	300
Bibliografia	301

Hyrje

Përkthimi ka moshë të njëjtë me gjuhën. Ai ka buruar dhe vazhdon të burojë nga takimi i folësve të gjuhëve të ndryshme, si dhe nga nevojat e tyre për t'u marrë vesh me njëri-tjetrin. Megjithatë, edhe pse përkthimi është kaq i lashtë, ende mbeten të panjohura mënyrat se si shndërrohet në mjeshtri, madje, në art të mirëfilltë. Kështu, me gjithë analizat e shpeshta dhe të vazhdueshme, studiuesit ende nuk kanë arritur të qartësojnë se çfarë është në të vërtetë përkthimi. Prandaj, duhet të pranojmë se përkthimi, duke qenë art më vete, mund të përkufizohet vetëm nga ata ,që e ushtrojnë atë dhe, njëherësh, i njohin mundësitë e tij të brendshme dhe të jashtme.

0.1 Përligjja e punimit

Përkthimi është shprehje e veçantë e të shkruarit, është lloj krijimi letrar me zanafillë të përcaktuar, si fëmija që rimerr të atin dhe të ëmën, që ngjan me ta, vetëm se duke i ruajtur tiparet e veta dallimore. Mirëpo, nëse nuk e arrin këtë, atëherë mund të shfaqet si mashtrues dhe keqinterpretim, ngaqë nuk e ka as shpirtin, as amën e natyrshme të tekstit burimor. Edhe pse mund ta shfrytëzojë frymëzimin e ndërsjelltë dhe larushinë gjuhësore, përkthyesi asnjëherë nuk mund ta ketë lirinë e autorit të origjinalit, sepse akti i krijimit është i papërsëritshëm njëlloj në dy kohë dhe te dy veta të ndryshëm. Atij i duhet të ndjekë metodën e hulumtuesit në një mjedis gjuhësor dhe kulturor të panjohur, të hapë shtigje për të zbuluar mesazhin qëndror dhe mesazhet e shtresuar dhe për të kapur thelbin e tyre, gjë mundëson përcjelljen e tij te audiencia marrëse. Megjithëse për autorin e origjinalit vështirësia lidhet me emërtimin e objekteve, të veprimeve, të ideve, si dhe me përzgjedhjen e fjalëve, prapëseprapë ai mbetet prodhuesi i paqortueshëm i frytit krijues përfundimtar. Mirëpo, përkthyesi nuk e ka këtë epërsi. Përkundrazi, përveç këtij mundimi të mishëruar në tekstin burimor, ai duhet të përballojë agoninë e vendimmarrjes në Gjuhën Përkthimore, e cila, në rastin tonë, është Gjuha Shqipe.

Megjithatë, në të gjitha rastet, përkthimi varet nga saktësia e përmbushjes së kriterit themelor për gjithë komunikimin ndërnyerëzor, i cili është përputhja me parimin e gjegjësisë. Pra, larushitë e ndryshme të përkthimit mund të shpjegohen pa kërkuar ndihmë te tipologjia e teksteve, e përkthimeve, e funksioneve ose e gjërave të ngjashme me to. Ndërkohë, përkthimi, sidomos përkthimi letrar, edhe si punë, edhe si gjykim, edhe si vlerësim, mbart vështirësi të përmasave gati-gati të papërballueshme. Nga kapërcimi ose moskapërcimi i tyre, varet fund e krye mbarëvajtja e komunikimit ndërkulturor.

0.2 Qëllimi i studimit dhe rezultatet e pritshme

Në këtë Disertacion shqyrtohen rrugët, mënyrat dhe mjetet që përkthyesi Ismail Kadare ka zgjedhur dhe ka shfrytëzuar për të zgjidhur problemet e shumta, të cilat kanë lindur gjatë leximit të thelluar, domethënë, në rrjedhën e punës për përkthimin e romanit Plaku dhe D eti (The Old Man and the Sea) të Ernest Hemingueit nga Gjuha Angleze në Gjuhën Shqipe, duke u mbështetur në shtjellimin letrar si mjet për zbulimin dhe kapërcimin e pengesave përkthimore.

Ky roman, për shkak të rrafshëve të shumëfishta të simboleve, të zërave dhe të ngjarjeve, të cilat edhe lidhen, edhe nuk lidhen me njëra-tjetrën, përcjell mesazhe të pafundme. Ato përbëjnë “farën” dhe “frytin” e domethënies themelore të kumtimit burimor të synuar, si dhe shkaktojnë valë të njëpasnjëshme të përhershme leximi, kuptimi dhe interpretimi, që lëvizin në drejtim të brigjeve dhe, nga brigjet, në drejtim të qendrës së “detit” të mendimit njerëzor, i cili diku është “i thellë” dhe diku “i cekët”, diku është “i qetë” dhe diku “i trazuar”, diku është “i kthjellët” dhe diku “i turbulluar”, diku është “i njohur” dhe diku “i panjohur”.

Ndërkohë, përkthyesit, këtij lexuesi të thellësive të mëdha mendore, të pajisur me përvoja të ndryshme, gjuhësore, letrare, kulturore, etj., por gjithsesi me dije joshteruese, i duhet “të lundrojë” dhe “të zhytet” thellë e më thellë, për të zbuluar dhe kapur burimin e burimeve kuptimore të romanit në fjalë, por edhe të veprave të tjera, që u përkasin gjinive të ndryshme letrare.

Sidoqoftë, “prodhimi” i tij përfundimtar mishëron thjesht rimarrjen krijuese, më pak ose më shumë e arrirë të tekstit në Gjuhën Burimore, por assesi shëmbëllesën e vërtetë të tij, ngaqë përjetimet janë të papërsëritshme brenda të njëjtit njeri (autori, lexuesi i rëndomtë, përkthyesi), të njëjtit çast (koha), dhe të njëjtës hapësirë (mjedisi gjeografik, mjedisi shoqëror, mjedisi kulturor, mjedisi njohës).

0.3 Metodologjia dhe struktura e punimit

Kështu, në bazë të dëshmive letrare-përkthimore, të vjela nga përkthimi i romanit Plaku dhe deti (The Old Man and the Sea) të Ernest Hemingueit nga Gjuha Angleze në Gjuhën Shqipe, vërehet se përkthyesi Ismail Kadare, i ndihmuar nga përvoja krijuese vetjake, ka shfrytëzuar një varg rrugësh dhe mjetesh diturore, për të sjellë te lexuesi shqiptar rimarrjen e plotë të këtij krijimi të arrirë letrar. Ai u ka kushtuar vëmendje të veçantë leximeve shteruese, burimeve shkakësore librore, përjetimeve të përvojave vetjake të autorit burimor, të mishëruara tek unat e tij të shumëfishtë, duke kapur dhe zbërthyer thelbin e interpretimit zanafillor të këtij romani, gjë që i ka dhënë mundësi ta sjellë atë në Gjuhën Shqipe “shëndosh e mirë”.

Rrjedhimisht, synimi i autorit përputhet me synimin e përkthyesit, ndonëse, si njëri, edhe tjetri, u drejtohen lexuesve përkatës në kushtet e dy gjuhëve të ndryshme, e dy kulturave të ndryshme, e dy kohëve të ndryshme, e dy hapësirave të ndryshme, e dy mjediseve të ndryshme shoqërore, e dy zërave të ndryshëm krijues, të pajisur me dije dhe përvoja të pabarabarta. Megjithatë, edhe në këtë rast, ky roman në Gjuhën Shqipe mbetet shëmbëllesa më e ngjashme e romanit në Gjuhën Burimore, por kurrsesi përdytësimi i plotë saj, sepse ndryshojnë krijuesi dhe rikrijuesi saj.

0.4 Struktura e punimit

Ky Disertacion përbëhet nga katër krerë:

*Në **Kreun e parë** trajtohen probleme që lidhen me gjuhën dhe kulturën, duke theksuar se, edhe pse bërthama e përkthimit është veprimtaria gjuhësore, ai, në të vërtetë, i përket semiotikës, shkencës që studion sistemet ose strukturat, proceset dhe funksionet e shenjave. Prandaj, përkthyesi priret nga mbajtja parasysh se asnjëherë dy gjuhë nuk*

janë kaq të ngjashme saqë të merren si përfaqësuese të një realiteti shoqëror të njëjtë. Gjuha është zemra brenda trupit të kulturës, domethënë, pikërisht ndërveprimi midis të dyjave, mundëson vijimin e energjisë së jetës.

Po ashtu, këtu janë trajtuar edhe llojet e përkthimit sikundër janë përkthimi brendagjuhësor, ose riformulimi; përkthimi ndërgjuhësor ose përkthimi i vërtetë; përkthimi ndërsemiotik ose shndërrimi, duke vënë në dukje se e mundur është vetëm zhvendosja krijuese, domethënë, zhvendosja brendagjuhësore: nga një formë poetike në një tjetër, ose zhvendosja ndërgjuhësore: nga një gjuhë në një tjetër, ose, së fundi, zhvendosja ndërsemiotike: nga një sistem shenjash në një tjetër, për shembull, nga arti verbal në muzikë, në balet, në kinema ose në pikturë, gjë që nënkupton se përkthimi është vetëm zberthimi i saktë i një njësie kodi të panjohur, ndërsa barasvlera mbetet e pamundur. Ndërkohë, vëmendje e posaçme u është kushtuar shifrimit dhe deshifrimit, duke nënvizuar se transformimet semiotike janë zëvendësimet e shenjave, që shifrojnë mesazhin nëpërmjet shenjave të një kodi tjetër, duke ruajtur informacionin e pandryshueshëm në lidhje me një sistem të dhënë referimi.

Në **Kreun e dytë** shqyrtohen probleme që lidhen me barasvlerën, me humbjen dhe përfitim, si dhe me rastet e papërkthyeshmërisë. Po ashtu, jepen edhe këto katër lloje barasvlera: barasvlera gjuhësore, ku ka homogjenitet në rrafshin gjuhësor në tekstet e Gjuhës Burimore dhe të Gjuhës Përkthimore, njëherësh, domethënë, përkthim fjalë për fjalë; barasvlera paradigmatiske, ku ka barasvlerë të “elementëve të boshtit paradigmatisht”, domethënë, të elementëve të gramatikës; barasvlera stilistike (përkthimore), ku ka “barasvlerë funksionale të elementëve në origjinal dhe në përkthim, duke synuar një identitet shprehës nëpërmjet një pandryshoreje me kuptim të njëjtë; barasvlera tekstuale (sintagmatike), ku ka barasvlerë të ndërtimit sintagmatik të një teksti, domethënë, barasvlerë të formës dhe të trajtës.

Ndërkohë, analizohet edhe fakti se përkthimi përfshin më tepër se sa zëvendësimin e njërive leksikore dhe gramatikore ndërmjet gjuhëve, duke arritur në përfundimin se, sapo përkthyesi largohet nga barasvlera e afërt gjuhësore, nisin të shfaqen problemet e përcaktimit të natyrës ekzakte të nivelit të barasvlerës që synohet të arrihet. Kështu, studimet përkthimore kanë dëshmuar tashmë se, kur disa përkthyes merren me përkthimin e të njëjtit tekst letrar, ata prodhojnë versione të ndryshme, të dallueshme nga njëri-tjetri. Por, prapëseprapë, diku në këto versione të ndryshme dhe të dallueshme nga njëri-tjetri, do të haset “bërthama e pandryshueshme” e origjinalit, e cila mishërohet në elementët e qëndrueshëm, themelorë dhe konstantë semantikë të tekstit. Transformimet ose variantet janë ato ndryshime, të cilat nuk e modifikojnë bërthamën e kuptimit, por ndikojnë te forma shprehëse. Shkurtimisht, pandryshorja mund të përkufizohet si diçka e përbashkët, e cila përshkon të gjitha përkthimet ekzistuese të një vepre të vetme, domethënë, barasvlera rrjedh nga rezultatet e përgjithshme të lidhjes ndërmjet vetë shenjave, nga lidhja ndërmjet shenjave dhe asaj që shënjojnë, si dhe nga lidhja ndërmjet shenjave të asaj që shënjojnë dhe atyre që i përdorin ato.

Përveç kësaj, këtu hidhet dritë mbi çështjen e asaj që humbet dhe e asaj që fitohet gjatë procesit të përkthimit duke theksuar se ajo që shpesh shihet si “humbje” nga konteksti i Gjuhës Burimore mund të zëvendësohet në kontekstin e Gjuhës Përkthimore. Gjithashtu, flitet edhe për dy llojet e papërkthyeshmërisë: të

papërkthyeshmërisë gjuhësore dhe të papërkthyeshmërisë kulturore, duke sqaruar se, në rrafshin gjuhësor, papërkthyeshmëria shfaqet, kur nuk ka asnjë zëvendësues leksikor ose sintaksor në Gjuhën Përkthimore për njësinë në Gjuhën Burimore, ndërsa, për aq kohë sa gjuha është sistemi parësor modelues brenda një kulture, papërkthyeshmëria kulturore duhet të nënkuptohet në çdo proces përkthimi.

*Në **Kreun e tretë** hulumtohen pengesat përkthimore dhe kapërcimi i tyre në lëmin e përkthimit letrar, i cili nënkupton përkthimin e letërsisë së vërtetë imagjinare, të katër tipave kryesorë të saj, domethënë, të poezisë, të dramës, të tregimit dhe të romanit, por duke theksuar se çdo vepër letrare, nga autori në autor, pavarësisht nga përkatësia e gjinisë letrare, mbart vështirësitë veta specifike përkthimore. Kështu, gjatë **përkthimit të dramës**, përkthyesi i kushton vëmendje çështjës së vënies në skenë dhe dialogut, duke zgjedhur gjuhën që përshtatet me mjediset ku veprojnë personazhet, si dhe me marrëdhëniet ndërmjet tyre. **Përkthimi i tregimit** është forma më e vështirë letrare për t'u përkthyer menjëherë pas poezisë, sepse kërkohet ruajtja me kujdes e përqëndrimit, unitetit formal dhe tematik, njëherazi. Kryesor, mes problemeve gjatë **përkthimit të romanit**, është domethënia relative e kulturës së Gjuhës Burimore dhe e qëllimit moral të autorit për lexuesin. Ndërkohë, nga të katër këto gjini letrare, **përkthimi i poezisë** mbetet më i vështiri. Pranadaj, në këtë rast, më së shumti, jemi përqëndruar në sfidat me të cilat ndeshet përkthyesi gjatë përpjekjeve për të imituar formën, ritmin, kuptimin dhe imazhet e poezisë në një gjuhë tjetër, duke sugjeruar procedura për përballimin e tyre.*

*Në **Kreun e katërt**, në mënyrë të përmbledhur, analizohet jeta, kushtet dhe rrethanat në të cilat u "gatuan" botëkuptimi dhe formimi letrar i Ernest Hemingueit, si dhe jepet një përmbledhje e shkurtër e romanit Plaku dhe deti (The Old Man and the Sea). "Zemrën" e këtij kreu e përbën krahasimi i përkthimit nëpërmjet shtjellimit letrar të pesë pjesëve, domethënë, pesë ditëve të zhvillimit të ngjarjeve të romanit në fjalë.*

Kështu, jemi përpjekur të ndriçojmë kontekstet herë-herë fragmentare të këtij romani, të cilat krijojnë kontekstin e ngjizur dhe të ngjeshur, por të fshehtë, në të cilin "strehohet" mesazhi qëndror, si shumë e kuptimeve, e nënkuptimeve, e simboleve dhe e imazheve të shumëfishta, të ngarkuara me ambiguitet të përmasave të pazakoshme, duke nënvizuar rëndësinë e procesit të leximit dhe të interpretimit, si dhe mjeshtrinë që ka dëshmuar përkthyesi Ismail Kadare gjatë gjetjes së barasvlerësve nëpërmjet shfrytëzimit të pasurive të Gjuhës Shqipe, dhe hulumtimeve të shumta, për të gjetur referimet burimore, të tregura dhe të patreguara, të kuptuara dhe të nënkuptuara, në mënyrë që Lexuesi Shqiptar të mund ta lexojë, natyrisht, sipas mënyrës së vet, këtë krijim të arrirë, njëlloj si në Gjuhën Burimore. Pastaj, janë analizuar personazhet, tematika, simbolizmi dhe motivet, stili dhe struktura e të shkruarit, duke u mbështetur në leximin krahasimtar të veprës në Gjuhën Burimore dhe në Gjuhën Përkthimore.

Po ashtu, kemi nxjerrë edhe përfundimet që lidhen me mjeshhtërinë vetjake të përkthyesit Ismail Kadare, të ilustruara me shembuj. Metoda që kemi përdorur në këtë punim është ajo e krahasimit të përkthimit përmes shtjellimit letrar, duke u mbështetur në burime teorike, interpretuese dhe aplikuese konkrete të modelit që ka zgjedhur përkthyesi për përkthimin e këtij romani. Së fundi, përmes këtij Disertacioni, synojmë ta ndihmojmë sadopak përkthyesit letrarë për të gjetur rrugën që i çon në drejtim të përmbushjes së misionit të vet, pa ia "dëmtuar" shpirtin kuptimor tekstit burimor, duke u mbështetur në një model përkthimi mjaft të arrirë.

Kreu i parë

Gjuha dhe kultura

Hapi i parë në drejtim të shqyrtimit të procesit të përkthimit duhet të jetë pranimi se, edhe pse bërthama e përkthimit është veprimtaria gjuhësore, ai, në të vërtetë, i përket semiotikës, shkencës që studion sistemet ose strukturat e shenjave, proceset e shenjave dhe funksionet e shenjave (Shih: Hawkes, *Structuralism and Semiotics*, London 1977). Përtej nocionit që vihet në pah nga qasja e ngushtë gjuhësore, se përkthimi përfshin përcjelljen e kuptimit të përmbajtur në një bashkësi shenjash gjuhësore të një bashkësi tjetër shenjash gjuhësore nëpërmjet përdorimit me zotësi të fjalorit dhe të gramatikës, ky proces përfshin gjithashtu edhe një bashkësi të tërë kriteresh jashtëgjuhësore. Eduart Sapiri mëton se “gjuha është udhërrëfyese për të realiteti shoqëror” dhe se qeniet njerëzore janë në mëshirë të gjuhës, e cila është bërë mjeti i shprehjes për shoqërinë e tyre. Përvoja, shpall ai, përcaktohet në shkallë të gjerë nga shprehitë gjuhësore të komunitetit, dhe secila strukturë e veçantë përfaqëson një realitet të veçantë:

Asnjëherë dy gjuhë nuk janë aq të ngjashme, sa të merren si përfaqësuese të një realitet shoqëror të njëjtë. Botët në të cilat jetojnë shoqëri të ndryshme janë botë të dallueshme, dhe jo thjesht e njëjta botë, të cilës i ngjiten etiketa të ndryshme.¹

Teza e Sapirit, që më vonë u përkrah dhe u vërtetua nga Benjamin Li Uorfi, lidhet me pikëpamjen e kohëve të fundit, të parashtruar nga semioticieni sovjetik, Juri Lotman, se gjuha është *sistem modelues*. Lotmani i përshkruan letërsinë dhe artin në përgjithësi si *sisteme modeluese dytësore*, si tregues të faktit se rrjedhin nga sistemi modelues parësor i gjuhës dhe shprehet me po aq vendosmëri sa Sapiri dhe Uorfi se “asnjë gjuhë nuk mund të ekzistojë, po të mos jetë e futur në mënyrë të thiktë në kontekstin e kulturës; dhe asnjë kulturë nuk mund të ekzistojë, po të mos e ketë në qendrën e vet strukturën e gjuhës natyrore”.² Atëherë, gjuha është zemra brenda trupit të kulturës dhe pikërisht ndërveprimi midis të dyjave mundëson vijimin e energjisë së jetës. Njësoj si kirurgu, i cili që gjatë operacionit në zemër nuk mund të shpërfillë trupin ku ndodhet zemra, edhe përkthyesi nuk mund ta shtjellojë tekstin të veçuar apo të shkëputur nga kultura me një të rënë të lapsit.

¹ E. Sapir, *Culture, Language and Personality*, University of California Press, Berkeley, Los Angeles, 1956, Faqe 69.

² J. Lotman dhe B. A. Uspensky, ‘On the Semiotic Mechanism of Culture’, *New Literary History*, IX (2), 1978, Faqe 211-232.

1.1 Llojet e përkthimit

Në artikullin e tij “Mbi aspektet gjuhësore të përkthimit”, Roman Jakobsoni dallon tre lloje përkthimi³:

1. Përkthimin brendagjuhësor, ose *riformulimin* (interpretimi i shenjave verbale nëpërmjet shenjave të tjera në të njëjtën gjuhë).
2. Përkthimin ndërgjuhësor ose *përkthimin e vërtetë* (interpretimi i shenjave verbale nëpërmjet një gjuhe tjetër).
3. Përkthimin ndërsemiotik ose *shndërrimin* (interpretimi i shenjave gojore nëpërmjet shenjave të sistemeve të shenjave jo-verbale).

Pas përcaktimit të këtyre tre llojeve, nga të cilat lloji (2), domethënë, *përkthimi i vërtetë*, përshkruan procesin e përcjelljes nga Gjuha Burimore në Gjuhën Përkthimore, Jakobsoni, aty për aty, parashtron problemin qëndror që haset në të gjitha këto lloje: se, ndërkohë që mesazhet mund të shërbejnë si interpretime të sakta të njësive të kodit ose të mesazheve, zakonisht nuk ka barasvlerë të plotë tejpërtej përkthimit. Bile as sinonimia e qartë nuk prodhon barasvlerë, dhe Jakobsoni tregon mënyrën sesi përkthimit ndërgjuhësor shpesh i duhet të mbështetet në bashkërendimin e njësive të kodit, me qëllim që të interpretojë kuptimin e një njësie të vetme. Pra, fjalori i sinonimeve mund të japë fjalën *i / e përkryer* si sinonim të fjalës *ideale*, *i / e përsosur*, ose fjalën *automjet* si sinonim të termit *mjet transporti*, por në asnjërin rast nuk mund të flitet për barasvlerë të plotë, përderisa secila njësi përmban brenda vetvetes një bashkësi asosacionesh dhe konotacionesh të papërkthyeshme.

Ngaqë barasvlera e plotë (në kuptimin e sinonimisë ose të ngjashmërisë) nuk mund të ndodhë në asnjërin kategori të përcaktuar prej tij, Jakobsoni shprehet se, pikërisht për këtë arsye, gjithë arti poetik teknikisht është i papërkthyeshëm. E mundur është vetëm zhvendosja krijuese: ose zhvendosja brendagjuhësore, domethënë, nga një formë poetike në një tjetër, ose zhvendosja ndërgjuhësore, domethënë, nga një gjuhë në një tjetër, ose, së fundi, zhvendosja ndërsemiotike, domethënë, nga një sistem shenjash në një tjetër, për shembull, nga arti verbal në muzikë, në balet, në kinema ose në pikturë.


Atë që thotë këtu Jakobsoni e merr përsëri Zhorzh Munini, teoricieni francez, i cili e kupton përkthimin si varg operacionesh, nga të cilat, pika fillestare dhe produkti i përfunduar janë *kuptime* dhe funksionojnë në një kulturë të caktuar.⁴ Kështu, për shembull, fjala anglisht *pastry – brumë ëmbëlsirash*, po të përkthehet në Gjuhën Shqipe pa pasur parasysh kuptimin e saj, nuk do të jetë në gjendje të kryejë funksionin e vet kuptimor brenda një fjalie, edhe sikur fjalori të japë një “barasvlerës”; sepse *pasta* i përket një fushe asociative krejt të ndryshme. Në këtë rast, përkthyesit i duhet të mbështetet në bashkërendimin e njësive, me qëllim që të gjejë një barasvlerës të përafërt. Jakobsoni merr si shembull fjalën rusisht *syr - ushqim i përftuar nga shtrydhja e gjizërave të fermentuara*, të cilën e përkthen në anglisht *cottage cheese – djathë stani*. Në këtë rast, ai shprehet se përkthimi është vetëm zberthim i saktë i një njësie kodi të panjohur, ndërsa barasvlera mbetet e pamundur.

³ R. Jakobson, ‘On Linguistic Aspects of Translation’, në R. A. Brower (redaktor), *On Translation*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, 1959, Faqe 232-239.

⁴ G. Mounin, *Les problèmes théoriques de la traduction*, Gallimard, Paris, 1963, Faqe 33.

1.2 Shifrimi dhe deshifrimi

Prandaj, përkthyesi përdor kritere që i kapërcejnë ato që janë të mirëfillta gjuhësore, ndërkohë që ndodh procesi i shifrimit dhe i deshifrimit. Modeli i Eugjen Nidas i procesit të përkthimit ilustron më së miri etapat e përfshira:⁵



Si shembuj të disa komplikimeve, të cilat hasen gjatë përkthimit ndërgjuhësor të atyre që mund të duken se janë gjëra të pakundërshtueshme, studiuesit e fushës marrin në shqyrtim përkthimin e *yes* dhe *hello* në Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht dhe Shqip. Në shikimin e parë, kjo detyrë mund të duket e drejtpërdrejtë, përderisa të gjitha gjuhët indo-evropiane janë të lidhura ngushtë në rrafshin leksikor dhe në rrafshin sintaksor, por edhe termat e përhëndetjeve dhe të miratimit janë të përbashkët në të katër këto gjuhë. Për fjalën *yes* fjalorët standardë japin:

Frëngjisht: *oui, si;*

Gjermanisht: *ja;*

Italisht: *si;*

Shqip: *po;*

Bie lehtë në sy se ekzistenca e dy termave në Frëngjisht përbën një përdorim që nuk ekziston në gjuhët e tjera. Hulumtimet e mëtejshme tregojnë se, ndërsa *oui* është termi i përdorur në përgjithësi, *si* përdoret posaçërisht në rastet e kundërshtimit, zënkës dhe mospajtimit. Prandaj, përkthyesit i duhet të tregohet i vëmendshëm ndaj këtij rregulli gjatë përkthimit të kësaj fjale, e cila mbetet e pandryshuar në të gjitha kontekstet.

Kur merret në shqyrtim përdorimi i pohimit në gjuhën e folur, lind një tjetër çështje. *Yes* nuk mund të përkthehet gjithmonë me fjalët e veçanta *oui, ja, si* ose *po*, sepse Frëngjishtja, Gjermanishtja, Italishtja dhe Shqipja shpesh i dyfishojnë ose “i lidhin në varg” pohoret në një mënyrë që del jashtë procedurave të Anglishtes Standarde, për shembull, *si, si; si, si; ja, ja: po, po*, etj. Kësisoj, përkthimi në Italisht, në Gjermanisht dhe në Shqip i fjalës *yes* me një fjalë të vetme, nganjëherë, mund të duket kejt nopran, ndërkohë që lidhja varg e pohoreve në Anglisht është kaq hiperbolike saqë shpesh krijon efekte komike.

⁵ E. Nida dhe C. Taber, *The theory and Practice of Translation*, E. J. Brill, Leiden, 1969, Faqe 484.

Gjatë përkthimit të fjalës *hello*, formës standarde në Anglisht të përshëndetjes miqësore kur takohesh me dikë, problemet shumëfishohen. Fjalorët japin:

Frëngjisht: *ça va?; hallo*

Gjermanisht: *wie geht's; hallo*

Italisht: *olà; pronto; ciao*

Shqip: *tungjatjeta, ngjatjeta; përshëndetje; ç'kemi?*

Ndërkohë që Anglishtja nuk afron asnjë lloj dallimi ndërmjet rastit kur fjala përdoret për të përshëndetur dikë ballë për ballë dhe rastit kur i përgjigjesh një thirrjeje telefonike, Frëngjishtja, Gjermanishtja, Italishtja dhe Shqipja paraqesin dallime. Fjala Italisht *pronto* mund të përdoret vetëm si përshëndetje telefonike, ashtu si fjala Gjermanisht *hallo*. Për më tepër, Frëngjishtja dhe Gjermanishtja përdorin si forma përshëndetjeje pyetje të shkurtra retorike, ndërsa e njëjta pyetje në anglisht *How are you?* ose *How do you do?* përdoret vetëm në situata më formale. Fjala Italisht *ciao*, e cila më së shumti është forma më e zakonshme e përshëndetjes në të gjitha shtresat e shoqërisë Italiane, përdoret njëlloj si në ardhje, si në ikje, duke qenë e lidhur me çastin e kontaktit mes njerëzve që janë duke ardhur ose duke u larguar, dhe jo me një kontekst të dhënë të ardhjes ose të takimit fillestar. Kështu, për shembull, përkthyesit, gjatë përballimit të detyrës së përkthimit të fjalës *hallo* në Frëngjisht dhe në Shqip, fillimisht i duhet të kap dhe të nxjerrë nga ky term bërthamën e kuptimit, ndërsa etapat e këtij procesi, duke ndjekur diagramin e Nidas, mund të shfaqen si më poshtë vijon:

GJUHA BURIMORE


HELLO



PËRSHËNDETJE MIQËSORE



TRANSFERIMI



GJUHA PËRKTHIMORE

Ça va?

TUNGJATJETA

Ç'kemi?



VENDIMI PËR TË BËRË

DALLIMIN NDËRMJET

FORMAVE TË

SHFRYTËZUESHME TË

PËRSHËNDETJES



Ajo që ka ndodhur gjatë procesit të përkthimit është se *nocioni i përshëndetjes* është izoluar dhe fjala *hello* është zëvendësuar me një frazë që mbartë të njëjtin nocion. Jakobsoni do ta përshkruante këtë si zhvendosje ndërghjuhësore, kurse *Ludskanovi* do ta quante transformim semiotik. Transformimet semiotike janë zëvendësimet e shenjave që shifrojnë mesazhin nëpërmjet shenjave të një kodi tjetër duke ruajtur (sa

të jetë e mundur përballja e entropisë) informacionin e pandryshueshëm në lidhje me një sistem të dhënë referimi.⁶

Në rastin e fjalës *yes* informacioni i pandryshueshëm është *pohimi*, ndërsa në rastin e fjalës *hello* e pandryshueshmja është *nocioni i përshëndetjes*. Por, në të njëjtën kohë, përkthyesit merr parasysh edhe kritere të tjera, për shembull, ekzistencën e rregullit që lidhet me fjalët Frëngjisht *oui / si*, funksionin stilistikor të pohoreve të lidhura varg (të përsëritura), *kontekstin shoqëror* të përshëndetjes, qoftë telefonik, qoftë ballë për ballë, pozitën dhe statusin shoqëror të folësve, si dhe *peshën* rezultante të përshëndetjes së përditshme në shoqëri të ndryshme. Gjithë këta faktorë përfshihen në përkthimin edhe të fjalës që shfaqet dukshëm me kuptim të drejtpërdrejtë.

Çështja e transformimit semiotik shtrihet më tej kur merret në shqyrtim përkthimi i një emri të thjeshtë, të tillë si fjala Anglisht *butter* (*gjalpë*). Sipas Sosyrit, lidhja strukturore ndërmjet të shënjuarit (*signifie*), ose konceptit të fjalës *butter* dhe shënjesit (*signifiant*), ose imazhit tingullor të fjalës *butter*, përbën shenjën gjuhësore *butter*.⁷ Dhe, përderisa gjuha perceptohet si sistem lidhjesh të ndërvarura, del se fjala *butter* në Anglisht sillet si emër në një marrëdhënie të caktuar strukturore. Por Sosyri, gjithashtu, ka bërë edhe dallimin ndërmjet lidhjeve sintagmatike (horizontale) që ka fjala me fjalët që e rrethojnë në një fjali dhe lidhjet asociative (ose vertikale) që ajo ka me strukturën e gjuhës si tërësi. Për më tepër, brenda sistemit modelues dytësor, gjendet një lloj tjetër lidhjeje asociative dhe përkthyesi, ashtu si specialisti i teknikave të reklamës, kujdeset për linjat asociative parësore dhe dytësore njëherësh. Për fjalën *butter*, Anglishtja, nëpërmjet saj, përcjell një bashkësi asosacionesh të plotmërisë, dëlirësisë, si dhe të statusit të lartë (në krahasim me margarinën, e cila dikur perceptohej vetëm si *gjalpë* i dorës së dytë, edhe pse tani tregtohet gjithashtu si ushqim mjaft praktik sepse nuk ngrihet gjatë qëndrimit në frigorifer).

Gjatë përkthimit të fjalës *butter* në Italisht dhe në Shqip ndodh zëvendësimi i drejtpërdrejtë dhe fjalë për fjalë: *butter – burro – gjalpë*. Edhe fjala *butter*, edhe fjalët *burro*, *gjalpë*, përshkruajnë produktin e bërë prej qumështi, i cili tregtohet në trajtë fetash të buta yndyre të ngrënshme, për t'u konsumuar nga njerëzit. Por, prapëseprapë, brenda konteksteve të tyre të veçanta kulturore, fjalët *butter*, *burro* dhe *gjalpë* nuk mund të quhen shënjes të barasvlerëshëm. Në Itali, fjala *burro* zakonisht me ngjyrë të çelët dhe i pakripur, përdoret kryesisht për gatim, dhe nuk mbart asnjë asosacion të statusit të lartë, ndërkohë që në Britani dhe në Shqipëri fjala *butter – gjalpë*, të shumtën e herës me ngjyrë të verdhë të shndritshme dhe i kripur, përdoret për lyerjen e bukës dhe fare rrallë për gatim. Për shkak të statusit të lartë të fjalës *butter – gjalpë*, shprehja *bread and butter – bukë me gjalpë* është e pranueshme në përdorim edhe atëherë kur produkti i përdorur është margarina.⁸ Pra, kemi një dallim edhe ndërmjet *objekteve* të shënjuara nga fjalët *butter*, *gjalpë* dhe *burro*, edhe ndërmjet *funksionit* dhe *vlerës* të këtyre objekteve në kontekstin e tyre kulturor. Problemi i barasvlerës këtu përfshin shfrytëzimin dhe perceptimin e objektit në një kontekst të caktuar. Përkthimi i fjalëve *butter* dhe *gjalpë* me *burro*, edhe pse i

⁶ A. Ludskanov, 'A Semiotic Approach to the Theory of Translation', *Language Sciences*, Nr. 35, Prill, 1975, Faqe 5-8.

⁷ Shih F. de Saussure, *Course in General Linguistics*, Fontana, London, 1974.

⁸ Edhe pse ekziston gjithashtu një përdorim idiomatik i shprehjes *bread and butter* që shënjon gjërat e domosdoshme, mjetet e jetesës, për shembull, *to earn one's bread and butter – fitoj bukën e gojës*.

përkryer në njërin rrafsh, shërben gjithashtu si kujtojsë e vlefshmërisë së pohimit të Sapirit se çdo gjuhë përfaqëson një realitet më vete.

Fjalët *butter* dhe *gjalpë* përshkruajnë një produkt posaçërisht të identifikueshëm, mirëpo në rastin e një fjale me një gamë më të gjerë kuptimesh në Gjuhën Burimore, problemet shtohen. Skica diagramatike e strukturës semantike të fjalës *spirit* – *shpirt*, e paraqitur nga Nida, ilustron një bashkësi më të koklavitur lidhjesh semantike.⁹

Spirit

(having personality – me personalitet <i>versus</i> not having personality – pa personalitet)										
(non-human <i>versus</i> human)						(character <i>versus</i> substance)				
(theological <i>versus</i> non-theological)						(human <i>versus</i> non human)				
(unseen <i>versus</i> seen)										
(inferior <i>versus</i> superior)			(technological <i>versus</i> folk)			(individual <i>versus</i> grup)				
(evil <i>versus</i> good)										
1 [demons]	2 [angels]	3 [God gods]	4 [gremilins]	5 [fairies, spirits]	6 [part of personality]	7 [ghost]	8 [liveliness, animation]	9 [ethos of group]	10 [intent meaning as of a document]	11 [alcohol]

Aty ku haset një bashkësi kaq e pasur lidhjesh semantike si në rastin e sipërpërmendur, një fjalë mund të përdoret në lojëra fjalësh, një lloj humorit që vepron duke ngatërruar ose përzier kuptime të ndryshme, për shembull, shakatë për priftin e dehur që bisedonte shumë shpesh me “frymën e shenjtë”, etj. Atëherë, përkthyesi nuk ka sesi të mos merret me përdorimin e dhënë të fjalës *spirit* në vetë fjalinë, në fjalinë në raport me lidhjet e saj strukturore me fjalitë e tjera, si dhe në kontekstet e përgjithshme tekstuale dhe kulturore të fjalisë. Kështu, për shembull:

The spirit of the dead child rose from the grave – *Shpirti i fëmijës së vdekur u ngrit nga varri* lidhet me kategorinë 7 dhe jo me ndonjë tjetër të përcaktuar nga Nida, kurse *The spirit of the house lived on* – *Fryma e shtëpisë vijoi të jetonte* mund të lidhet me kategorinë 5 ose 7 ose, kur përdoret në mënyrë metaforike, me kategorinë 6 ose 8, dhe kuptimi mund të përcaktohet vetëm nga konteksti.

⁹ Kjo skicë është marrë nga E. Nida, *Towards a Science of Translating. With Special Reference to Principles and Procedures Involved in Bible Translating*, E. J. Brill, Leiden, 1964, Faqe 107. Të gjitha citimet nga Nida, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga ky vëllim.

Firthe e përcakton kuptimin si “kompleks lidhjesh të llojeve të ndryshme ndërmjet termave përbërës të një konteksti situatë”¹⁰ dhe citon shembullin e shprehjes anglisht *Say when – Thuaj kur*, ku fjalët shprehin të njëjtin kuptim që mbartin. Gjatë përkthimit të kësaj shprehjeje, merret parasysh funksioni dhe jo vetë fjalët, dhe procesi i përkthimit përfshin vendimin për të zëvendësuar elementët gjuhësorë në Gjuhën Përkthimore. Dhe përderisa shprehja, siç vë në dukje Firthe, lidhet drejtpërsëdrejti me Gjedhet e Sjelljes Shoqërore të Anglezëve, përkthyesi që e përkthen këtë shprehje në Frëngjisht, në Gjermanisht ose në Shqip ndeshet me problemin e mospasjes së një konvencionit të ngjashëm në asnjërën nga kulturat e Gjuhëve Përkthimore. Po ashtu, edhe përkthyesi i shprehjes Frëngjisht *Bon appetit – Të bëftë mirë* ndeshet me të njëjtin problem, ngaqë edhe në këtë rast kuptimi i shprehjes varet nga situata. Si shembull të ndërlikimeve që përfshihen këtu, le të marrim një situatë të hamendësuar dramatike, në të cilën shprehja *Bon appetit – Të bëftë mirë* përfiton rëndësi të dorës së parë:

A family group have been quarrelling bitterly, the unity of the family has collapsed, unforgivable things have been said. But the celebratory dinner to which they have all come is about to be served, and the family sit at the table in silence ready to eat. The plates are filled, everyone sits waiting, the father breaks the silence to wish them all “Bon appetit” and the meal begins.

Pjesëtarët e një familje vijojnë të zihen keq, harmonia familjare është rrënuar, janë thënë gjëra të pafalshme. Por darka festive, ku kanë ardhur të gjithë, do të shtrohet pas pak, ndërsa familja ka zënë vend në tryezë e heshtur dhe gati për të ngrënë. Pjatat mbushen, çdo njëri syresh rri duke pritur, babai thyen heshtjen, për t’iu uruar të gjithëve “Bon appetit” – “Ju bëftë mirë” dhe darka fillon.

Nuk përcaktohet nëse kjo shprehje përdoret mekanikisht, apo si pjesë e ritualit të përditshëm, apo në mënyrë ironike, apo trishtueshëm, apo me egërsi. Në skenë, aktorit dhe regjisorit u duhet të arrijnë në një përfundim rreth mënyrës së interpretimit të kësaj shprehjeje duke u mbështetur në konceptin e tyre të tipizimit, të kuptimit, si dhe të strukturës së përgjithshme të veprës skenike. Interpretimi do të kryhej nëpërmjet lojës me zërin. Por cilido qoftë ky interpretim, do të mbetet rëndësia e kësaj shprehjeje të thjeshtë, e cila ndërhyr në mes të një situatë tensioni të madh.

Përveç problemit të përzgjedhjes të shprehjes në Gjuhën Përkthimore, e cila duhet të ketë kuptim afërsisht të njëjtë, përkthyesi i kushton vëmendje çështjes së interpretimit. Përkthimi i përpiktë është i pamundur: *Good appetite* në Anglisht, kur përdoret jashtë një fjalisë të përbërë, nuk ka kuptim, ndërsa, në të njëjtat rrethana, në Shqip *Të bëftë mirë* ose *Ju bëftë mirë* përfiton kuptim metaforik, i cili nuk lidhet fare me ushqimin. Madje, në këto dy gjuhë, domethënë, në Anglisht dhe në Shqip, nuk ka asnjë shprehje me përdorim të përgjithshëm, që të mund të përmbushë të njëjtin funksion si shprehja në Frëngjisht. Mirëpo ekzistojnë një varg shprehjesh që mund të shfrytëzohen në situata të caktuara, për shembull, shprehja e gjuhës së folur *Dig in – Hani* ose *Tuck in – Futjuni*, ose ajo pak më zyrtare *Do start – Filloni*, ose edhe shprehja e përditshme ndjesë-kërkuese *I hope you like it – Besoj se do t’ju pëlqej*, ose *I hope it’s alright –*

¹⁰ J. R. Firth, *The Tongues of Men and Speech*, Oxford University Press, London, 1970, Faqe 110.

Besoj se do të ngopeni. Për përcaktimin e asaj që do të përdorë në Anglisht dhe në Shqip, përkthyesi:

(1) Pranon papërkthyeshmërisë e shprehjes së Gjuhës Burimore në Gjuhën Përkthimore në rrafshin gjuhësor.

(2) Pranon mungesën e konvencioneve të ngjashme kulturore në Gjuhën Përkthimore.

(3) Merr parasysh gamën e shprehjeve të shfrytëzueshme të Gjuhës Përkthimore, duke respektuar parashtrimin e klasës, të statusit, të moshës dhe të gjinisë së folësit, marrëdhënieve të tij me dëgjuesit dhe kontekstin e takimit të tyre në Gjuhën Burimore.

(4) Vlerëson rëndësinë e shprehjes në kontekstin e dhënë të saj, domethënë, si çast tensioni të lartë në tekstin dramatik.

(5) Zëvendëson në Gjuhën Përkthimore bërthamën e pandryshueshme të shprehjes në Gjuhën Burimore në të dy sistemet e saj të referimit (sistemi i veçantë i tekstit dhe sistemi i kulturës, prej të cilës ka buruar teksti).

Levi, ky studiues i madh i përkthimit, këmbëngulte se çdo tkurrje apo heqje e shprehjeve të vështira gjatë përkthimit ishte imorale. Përkthyesi, besonte ai, mbante përgjegjësi për gjetjen e zgjidhjeve të problemeve më të vështira, dhe shprehej se pikëpamja funksionale duhet të përvetësohet jo vetëm në lidhje me kuptimin, por edhe me stilin dhe me formën. Pasuria e studimeve mbi përkthimin e Biblës dhe dokumentimi i mënyrës në të cilën përkthyesit e veçantë të Biblës përpunonin t'i zgjidhin problemet e veta përmes zgjidhjeve të zgjuara është burim posaçërisht i pasur shembujsh të transformimit semiotik.

Gjatë përkthimit të shprehjes *Bon appetite – Të bëftë mirë / Ju bëftë mirë* në skenarin e dhënë më lart, përkthyesi ka përcaktuar një bashkësi kriteresh nga teksti për të gjetur mundësinë e një zëvendësimi të përshtatshëm në Gjuhën Përkthimore. Mirëpo, qartas, në një kontekst të ndryshëm, shprehja në Gjuhën Përkthimore mund të pësojë ndryshime. Gjatë përkthimit theksi bie mbi *lexuesin* ose *dëgjuesin*, dhe përkthyesit i duhet të ndalet te teksti në Gjuhën Burimore, në mënyrë të tillë që versioni në Gjuhën Përkthimore t'i përgjigjet versionit në Gjuhën Burimore. Natyra e kësaj përputhjeje mund të ndryshojë ndjeshëm, por parimi mbetet i pandryshueshëm. Prandaj, pikëpamja e Albreht Neubertit se soneti i Shekspirit “*Shall I compare thee to a summer’s day?*” – “*A të krahasoj me një ditë vere?*” nuk mund të përkthehet semantikisht në një gjuhë ku stina e verës është e pakëndshme, është kryekëput e drejtë, ashtu si koncepti i *Zotit* si *Ai* nuk mund të përkthehet në një gjuhë ku hyjnia është e gjinisë femërore. Përpyekja për t'i imponuar kulturës së Gjuhës Përkthimore sistemin e vlerave të Gjuhës Burimore është terren i rrezikshëm, dhe përkthyesi nuk ka arsye pse të joshet nga shkolla që pretendon të përcaktojë *qëllimet* burimore të autorit mbi bazën e tekstit të mëvetësishëm. Përkthyesi nuk mund të jetë autori i tekstit në Gjuhën Burimore, por, si autor i tekstit në Gjuhën Përkthimore, ai mban përgjegjësi morale përpara lexuesve të Gjuhës së Përkthimore.

Kreu i dytë

Probleme të ekuivalencës

Përkthimi i idiomave na çon një etapë më tej në shqyrtimin e çështjes së kuptimit dhe të përkthimit, sepse idiomat, ashtu si lojërat me fjalë, janë të lidhura me kulturën. Idioma në Italisht *menare il can per l'aia* jep një shembull të mirë të llojit të zhvendosjes që ndodh gjatë procesit të përkthimit¹¹. (11) E përkthyer fjalë për fjalë në Shqip, fjalia

Giovanni sta menando il can per l'aia.

bëhet:

Xhoni është duke e çuar qenin e vet pranë rrymës.

John is leading his dog around the threshing floor.

Imazhi që të sjellë në mendje kjo fjali është disi befases dhe, sikur konteksti të mos i referohej pikërisht një vendndodhjeje të tillë, fjalia do të dukej e errët dhe pothuaj pa kuptim. Idioma në Anglisht që përputhet më së shumti me idiomën në Italisht dhe në Shqip është *to beat about the bush – Grij ujë në havan / Nuk futem në temë*, gjithashtu e errët, po të mos përdoret në mënyrë idiomatike, dhe, prandaj, fjalia e përkthyer drejtë bëhet:

Xhoni po grin ujë në havan.

John is beating about the bush.

Edhe Anglishtja, edhe Italishtja, edhe Shqipja, kanë shprehje idiomatike gjegjëse, të cilat përcjellin idenë e dredhimit dhe, kështu, gjatë procesit të përkthimit ndërgjuhësor, një idiomë zëvendësohet me një tjetër. Ky zëvendësim nuk bëhet as në bazë të elementëve gjuhësorë në shprehje, as në bazë të një imazhi gjegjës ose të ngjashëm që përmban shprehja, por në bazë të funksionit të idiomës. Shprehja në Gjuhën Burimore zëvendësohet me një shprehje të Gjuhës Përkthimore, që i shërben të njëjtit qëllim në kulturën e Gjuhës Përkthimore dhe procesi këtu përfshin zëvendësimin e shenjës së Gjuhës Burimore me shenjën e Gjuhës Përkthimore. Shënimet e Dagutit për problemet e përkthimit të metaforës janë interesante, kur zbatohen edhe në lidhje me problemin e marrjes me idiomat:

¹¹ Popoviçi dallon disa tipa zhvendosjesh:

- Zhvendosja themelore* (në përkthim), e përshkruar si zhvendosje e pashmangshme, ndodh si rrjedhojë e dallimeve ndërmjet dy gjuhëve, ndërmjet dy poetikeve dhe ndërmjet dy stileve.
- Zhvendosja e përgjithshme*, ku tiparet themelore të tekstit, si zhanër letrar, mund të ndryshojë.
- Zhvendosja e përveçme*, ku stili i vetë përkthyesit dhe idiolekti mund të fusin një sistem të përveçëm shmangiesh.
- Zhvendosja mohore*, ku informacioni përkthehet në mënyrë të pasaktë për shkak të mosnjohjes së gjuhës ose të strukturës së origjinalit.
- Zhvendosja tematike*, ku dëshmitë tematike të origjinalit ndryshohen në përkthim.

Përderisa metafora në Gjuhën Burimore, sipas përkufizimit, është një pjesë e re përmbushjeje, një risi semantike, nuk është assesi e mundur që të ketë “barasvlerës” në Gjuhën Përkthimore: unakja nuk ka asnjë gjegjëse. Këtu, zotësia bilinguale e përkthyesit – siç shprehet Malarmeja, “*le sens de ce qui est dans la langue et de ce qui n’en est pas*” – i vjen në ndihmë atij vetëm në kuptimin negativ të të treguarit atij se çdo “barasvlerës” në këtë rast nuk mund “të gjendet”, por duhet “të krijohet”. Kësisoj, çështja parësore që lind është nëse vërtetë metafora mund të përkthehet si *e tillë*, apo nëse ajo vetëm mund të “riprodhohet” në një farë mënyre¹².

Por dallimi i Dagutit ndërmjet “përkthimit” dhe “riprodhimit”, ashtu si dallimi i Ketfordit ndërmjet përkthimit “fjalë për fjalë” dhe përkthimit të “lirë”¹³, nuk merr parasysh pikëpamjen që e sheh përkthimin si transformim semiotik. Në përkufizimin e barasvlerës së përkthimit, Popoviçi dallon këto katër lloje:

(1) *Barasvlerën gjuhësore*, ku ka homogjenitet në rrafshin gjuhësor në tekstet e Gjuhës Burimore dhe të Gjuhës Përkthimore, njëherësh, domethënë, përkthim fjalë për fjalë.

(2) *Barasvlerën paradigmatiche*, ku ka barasvlerë të “elementëve të boshtit paradigmatic”, domethënë, elementët e gramatikës, të cilët Popoviçi i sheh si një kategori më të lartë se sa barasvlera leksikore.

(3) *Barasvlera stilistikore (përkthimore)*, ku ka “barasvlerë funksionale të elementëve në tekstin burimor dhe në tekstin përkthimor, duke synuar një identitet shprehës nëpërmjet një pandryshoreje me kuptim të njëjtë.

(4) *Barasvlera tekstuale (sintagmatike)*, ku ka barasvlerë të ndërtimit sintagmatik të një teksti, domethënë, barasvlerë të formës dhe të trajtës¹⁴.

Prandaj, rasti i përkthimit të idiomës italiane, përfshin përcaktimin e barasvlerës stilistikore, e cila çon në zëvendësimin e idiomës së Gjuhës Burimore me një idiomë me funksion të barabartë në Gjuhën Përkthimore.

Përkthimi përfshin më tepër se sa zëvendësimin e njëjësive leksikore dhe gramatikore ndërmjet gjuhëve dhe, siç mund të shihet gjatë përkthimit të idiomave dhe metaforave, procesi mund të përfshijë heqjen dorë nga elementët bazë gjuhësorë të tekstit në Gjuhën Përkthimore, në mënyrë që të arrihet qëllimi i Popoviçit në lidhje me “identitetin shprehës” ndërmjet teksteve në Gjuhën Burimore dhe në Gjuhën Përkthimore. Por, sapo përkthyesi largohet nga barasvlera e afërt gjuhësore, nisin të shfaqen problemet e përcaktimit të natyrës ekzakte të nivelit të barasvlerës që synohet të arrihet.

Albreht Neuberti, vepra e të cilit mbi përkthimin, fatkeqësisht, nuk është e shfrytëzueshme për lexuesit shqiptar, bën dallimin ndërmjet studimit të përkthimit si *proces* dhe si *produkt*. Ai pohon hapur se: “mungesa e *hallkës lidhëse* ndërmjet të dy

¹² M. B. Dagut, ‘Can Metaphor Be Translated?’ *Babel*, XXII (1), 1976, Faqe 21-33.

¹³ J. C. Catford, *A Linguistic Theory of Translation*, Oxford University Press, London, 1965.

¹⁴ Të gjitha citimet nga Popoviçi, po të mos thuhet ndryshe, janë marrë nga vepra e tij *Dictionary (Fjalori)*.

komponentëve të një teorie të plotë të përkthimeve shfaqet si teoria e lidhjeve të barasvlerës, që mund të përfytyrohen edhe për modelin dinamik, edhe për modelin statik”¹⁵. Problemi i barasvlerës, term ky i përdorur dhe keqpërdorur me tepri në Studimet Përkthimore, ka rëndësi parësore dhe, megjithëse Neuberti ka të drejtë kur thekson nevojën për teorinë e lidhjeve të barasvlerës, Raimond van den Broku, gjithashtu, ka të drejtë kur sfidon përdorimin e tepruar të këtij termi në Studimet Përkthimore dhe pohon se përkufizimi i saktë i barasvlerës në matematikë është pengesë serioze për përdorimin e saj në teorinë e përkthimit.

Eugjen Nida dallon dy lloje barasvlere, *formalen* dhe *dinamiken*, ku *barasvlera formale* “e përqendron vëmendjen te vetë mesazhi, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Në një përkthim të tillë, përkthyesi merret me përputhje të tilla si poezia me poezinë, fjalia me fjalinë, dhe koncepti me konceptin”. Nida e quan këtë lloj përkthimi “përkthim sqarues”, i cili synon t’i japë mundësi lexuesit të kuptojë sa më shumë që të jetë e mundur kontekstin e Gjuhës së Origjinalit. Ndërkaq, *barasvlera dinamike* mbështetet në parimin e *efektit të barasvlershëm*, domethënë, lidhja ndërmjet marrësit dhe mesazhit duhet të synojë të jetë e njëjtë me atë ndërmjet marrësve burimorë dhe mesazhit në Gjuhën Burimore. Si shembull të kësaj lloj barasvlere, ai citon J. B. Filipin gjatë përkthimit të veprës *Romans (Romakët16:16)*, ku ideja e “përhëndetjes me puthje hyjnore” përkthehet si “shtrëngim i përzemërt dhe i gjatë duarsh”. Nëpërmjet këtij shembulli që duket se është një copë përkthimi e pasaktë dhe pa shije, mund të duken qartë llojet e përkufizuara lirshëm nga ana e Nidas. Parimi i *efektit të barasvlershëm*, i cili në kultura të ndryshme është përfaqëuar në masë të gjerë, mund të çojë në nxjerrjen e përfundimeve tejet të dyshimta. Kështu, vendimi i paramenduar i E. V. Riesë për të përkthyer Homerin në anglisht në trajtën e prozës, ngaqë rëndësia e formës epike në Greqinë e Lashtë mund të quhej e barasvlershme me rëndësinë e prozës në Evropën Moderne, është një rast i *barasvlerës dinamike*, i zbatuar në tiparet formale të tekstit, çfarë tregon se kategoritë e përcaktuara nga Nida, në të vërtetë, mund të bien ndesh me njëra-tjetrën.

Studimet Përkthimore kanë dëshmuar tashmë se, kur disa përkthyes meren me përkthimin e së njëjtës poezi, ata prodhojnë versione të ndryshme, të dallueshme nga njëri-tjetri. Por, prapëseprap, diku në këto versione të ndryshme dhe të dallueshme nga njëri-tjetri, do të haset ajo që Popoviçi e quan “bërthamë të pandryshueshme” të poezisë burimore. Kjo bërthamë e pandryshueshme, pohon ai, mishërohet në elementët e qëndrueshëm, themelorë dhe konstantë semantikë të tekstit, ekzistenca e të cilëve mund të vërtetohet përmes eksperimentimit të kondensimit semantik. Transformimet ose variantet janë ato ndryshime, të cilat nuk e modifikojnë bërthamën e kuptimit, por ndikojnë te forma shprehëse. Shkurtimisht, pandryshorja mund të përkufizohet si diçka e përbashkët që përshkon të gjitha përkthimet ekzistuese të një veprë të vetme. Pra, pandryshorja është pjesë e lidhjes dinamike dhe nuk duhet të ngatërrohet me argumentet spekulativë rreth “natyrës”, “frymës” ose “shpirtit” të tekstit, “cilësisë së papërcaktueshme”, të cilën përkthyesit arrijnë ta kapin shumë rrallë.

Gjatë përpjekjeve për të zgjidhur problemin e barasvlerës së përkthimit, Neuberti shprehet se, nga pikëpamja e teorisë së teksteve, barasvlera e përkthimit duhet të

¹⁵ A. Neubert, ‘Elemente einer allgemeinen Theorie der Translation’, *Actes du Xe Congres International des Linguistes*, , Bucarest II, 1967, Faqe 451-456.

quhet *kategori semiotike*, që përbën një komponent *sintaksor, semantik dhe pragmatik*, duke iu përmbajtur kategorive të përcaktuara nga Pirs¹⁶. Këta komponentë vendosen në marrëdhënie hierarkike, ku barasvlera semantike merr përparësi ndaj barasvlerës sintaksore, ndërsa barasvlera pragmatike kushtëzon dhe modifikon të dy elementët e tjerë. Barasvlera rrjedh nga rezultatet e përgjithshme të lidhjes ndërmjet vetë shenjave, nga lidhja ndërmjet shenjave dhe asaj që shënjojnë, si dhe nga lidhja ndërmjet shenjave të asaj që shënjojnë dhe atyre që i përdorin ato. Kështu, për shembull, vlerat tronditëse të shprehjeve blasfemuese në Italisht dhe në Spanjisht mund të përkthehen në Anglisht dhe në Shqip në mënyrë pragmatike, duke i zëvendësuar shprehjet me tone të theksuara seksuale, për të prodhuar ndikim të krahasueshëm tronditës, për shembull, *porca Madonna - fucking hell – ferr shkërdhatë*¹⁷. Po ashtu, ndërveprimi ndërmjet tre komponentëve përcakton procesin e përzgjedhjes në Gjuhën Përkthimore si, për shembull, në rastin e shkrimit të një letre. Normat që zbatohen gjatë shkrimit të letrave ndryshojnë ndjeshëm nga gjuha në gjuhë dhe nga periudha në periudhë, madje edhe brenda Evropës. Kështu, një grua që i shkruante një mikut të vet më 1812, nuk do të mundej t'i kishte mbyllur letrat e veta me shprehjen *With love – Dashurisht* apo *In sisterhood – Si motra motrës*, siç arrijnë të bëjnë Anglezet dhe Shqiptaret e sotme; po ashtu as një italian nuk do të mundej t'i mbyllte letrat pa një varg përshëndetjesh formale për marrësin e letrës dhe të afërmit e tij. Në të dy rastet, domethënë, në lidhje me formulat e të shkruarit të letrave dhe me gjënë e turpshme, përkthyesi deshifron dhe përpiket të shifrojnë në mënyrë pragmatike.

Çështja e përcaktimit të barasvlerës ndiqet nga dy linja zhvillimi në Studimet Përkthimore. E para, në mënyrë krejt të parashikueshme, e vë theksin te problemet e veçanta të semantikës dhe te transferimi i përmbajtjes semantike nga Gjuha Burimore në Gjuhën e Përkthimore. Nëpërmjet të dytës, e cila eksploron çështjen e barasvlerës së teksteve letrare, vepër kjo e Formalistëve Rusë dhe e Shkollës së Pragës, së bashku me disa zhvillime të mëvonshme në analizën e diskursit, kanë zgjeruar problemin e barasvlerës gjatë zbatimit të saj në përkthimin e teksteve të tilla. Xhejms Holmsi, për shembull, e ndjen se përdorimi i termit barasvlerë është i “gabuar”, përderisa, të kërkosht njëjtësinë do të thotë të kërkosht shumë, fort shumë, ndërsa Durisini argumenton se përkthyesi i një teksti letrar nuk merret me vendosjen e barasvlerës të gjuhës natyrore, por të procedurave artistike. Dhe këto procedura nuk mund të merren në shqyrtim të izoluar, por duhet të vendosen brenda kontekstit të veçantë kulturor të përkohshëm në të cilin arrijnë të shfrytëzohen¹⁸.

Le të marrim si shembull dy reklama në shtojcën me ngjyra të gazetave Angleze të së dielës, një për uiskin skocez dhe tjetrën për martinin, ku secili nga produktet tregtohet për plotësimin e nevojave për një shije të veçantë. Tregu i uiskit, më i vjetër dhe më tradicional se sa tregu i martinin, plotëson nevojat përmes reklamës, duke e vënë theksin te cilësia e produktit, te shija e spikatur e blerësit dhe te statusi social që do të akordojë produkti. Po ashtu, theksi vihet te natyrshmëria dhe cilësia e lartë e procesit

¹⁶ Shih C. S. Pierce, *Collected Papers* (8 vëllime), redaktuar nga P. C. Hartshorne, Weiss dhe A. Burks, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, 1931-1958. Për një diskutim lidhur me kontributin që ka dhënë Pirs në lëmin e semiotikës, shih T. Hawkes, *Structuralism and Semiotics*, Methuen, London, 1977, Faqe 126-130.

¹⁷ Një aspekt interesant i gjuhëve në kontakt është se sistemet e betimit dhe të blasfemisë shpesh bëhen të këmbyeshme.

¹⁸ Shembujt e cituar nga Raimond van den Broku në ‘The Concept of Equivalence in Translation Theory: Some Critical Reflections’, te J. S. Holmes, J. Lambert dhe R. van den Broeck (redaktorë), *Literature and Translation*, ACCO, Louvain, 1978, Faqe 29-48.

të distilimit, të pastërtia e ujit Skocez, të kohëzgjatja e pjekjes së produktit. Reklama përbëhet nga një tekst i shkruar dhe fotografia e produktit. Nga ana tjetër, martini tregtohet për të tërhequr vëmendjen e një grupi të ndryshëm shoqëror, atij grupi që duhet të fitohet përmes produktit që është shfaqur relativisht vonë. Prandaj, martini tregtohet për një perspektivë më të re dhe nuk e vë theksin te çështja e cilësisë së produktit aq sa të statusi i modës që do të akordojë. Fotografia që shoqëron tekstin e shkurtër të shkruar tregon “njerëz të bukur” që janë duke pirë martini; anëtarët e shoqërisë së lartë ndërkombëtare, të cilët popullojnë botën e fantazisë, ku çdo njeri mendohet i pasur dhe magjepsës. Këto dy lloje reklamash janë bërë kaq stereotipe në Kulturën Britanike sa që dallohen menjëherë nga kushdo dhe shpesh edhe parodizohen.

Me reklamimin e këtyre dy produkteve të njëjta në një revistë italiane të përjavshme lajmesh, po ashtu, kemi një bashkësi të dyfishtë imazhesh, domethënë, njëra që vë në dukje pastërtinë, cilësinë, statusin social dhe tjetra që vë në dukje magjepsjen, eksitim, të jetuarit sipas modës dhe rininë. Por, ngaqë martini ka kohë që njihet dhe uiski Skocez është një prurje relativisht e re në tregun masiv, imazhet e parashtruara me produktet janë krejt e anasjella e atyre Britanike. Të njëjtat mënyra, por të zbatuara në mënyra të ndryshme, përdoren për reklamimin e këtyre dy produkteve në të dyja shoqëritë. Produktet mund të jenë të njëjta në të dyja shoqëritë, por ato kanë vlera të ndryshme. Prandaj, uiski Skocez në kontekstin Britanik mund të përkufizohet besueshmërisht si barasvlerës i martinit në kontekstin Italian, dhe anasjelltas, përderisa paraqiten nëpërmjet reklamës si përmbushësh të funksioneve të barasvlershme shoqërore.

Pikëpamja e Mukarovskit se teksti letrar ka edhe karakter autonom, edhe karakter komunikues, është marrë nga Lotmani, i cili argumenton se një tekst është i *qartë* (shprehet me shenja të përcaktuara), i *kufizuar* (fillon dhe mbaron në një pikë të dhënë), dhe ka *strukturë* si rrjedhojë e organizimit të brendshëm. Shenjat e tekstit janë në marrëdhënie kundërshtie me shenjat dhe strukturat jashtë tekstit. Përkthyesi, prandaj, u kushton vëmendje edhe aspekteve të tij autonome, edhe aspekteve të tij komunikuese, dhe çdo teori e barasvlerës duhet t’i marrë parasysh të dy këta elementë së bashku¹⁹.

Atëherë, barasvlerës në përkthim nuk ka sesi t’i qaset si kërkim për njëjtësinë, përderisa njëjtësia as që mund të ekzistojë ndërmjet dy versioneve të të njëjtit tekst në Gjuhën Përkthimore, për të mos folur për atë ndërmjet versionit në Gjuhën Burimore dhe versionit në Gjuhën Përkthimore. Katër llojet e Popoviçit afrojnë një pikë fillestare të dobishme, kurse tre kategoritë semiotike të Neubertit tregojnë rrugën në drejtim të një qasjeje, që e përfytyron barasvlerën si dialektikë ndërmjet shenjave dhe strukturës brenda dhe përfaqë teksteve në Gjuhën Burimore dhe në Gjuhën e Përkthimore.

¹⁹ Për një diskutim të teorive të Lotmanit, shih D. W. Fokkema, ‘Continuity and Change in Russian Formalism, Czech Structuralism, and Soviet Semiotics’, *PTL*, I (1) Janar, 1976, Faqe 153-196, dhe A. Shukman, ‘The Canonization of the Real: Juri Lotman’s Theory of Literature and Analysis of Poetry’, *PTL* I (2), Prill, 1976, Faqe 317-339.

2.1 Çfarë humbet dhe çfarë fitohet

Sapo pranohet parimi se njëjtësia ndërmjet dy gjuhëve nuk mund të ekzistojë, bëhet e mundur t'i qaset çështjes së *asaj që humbet dhe asaj që fitohet* gjatë procesit të përkthimit. Përsëri kjo tregon statusin e ulët të përkthimit, ngaqë duhet të jetë shpenzuar shumë kohë duke diskutuar se çfarë humbet gjatë transferimit të një teksti nga Gjuha Burimore në Gjuhën Përkthimore, ndërkohë që injorohet se çfarë mund të fitohet, sepse, përkthyesi, shpesh, mund të pasurojë ose qartësojë tekstin në Gjuhën Burimore, si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e procesit të përkthimit. Për më tepër, ajo që shpesh shihet si “humbje” nga konteksti i Gjuhës Burimore mund të zëvendësohet në kontekstin e Gjuhës Përkthimore, ashtu siç ndodh në përkthimet e Petrarkës nga ana e Uajtit dhe e Surrit (shih faqet 56-57; 104-109).

Eugjen Nida është burim i pasur informacioni për problemet e humbjes gjatë përkthimit, sidomos për vështirësitë që has përkthyesi, kur përballet me termat ose me konceptet në Gjuhën Burimore, të cilat nuk ekzistojnë në Gjuhën Përkthimore. Ai citon rastin e gjuhës së Venezuelës së Jugut, ku përkthyesi has ca vështirësi për të gjetur terma të kënaqshëm në vend të atyre në anglisht: *murder, stealing, lying*, etj., po ku termat për *good, ugly, beautiful* mbulojnë një fushë shumë të ndryshme kuptimore. Si shembull, ai thekson se kjo gjuhë nuk përputhet me klasifikimin diktomik të “good” dhe “bad”, por atë triktomik, si më poshtë vijon:

(1) *Good* - *E mira* përfshin ushqimin e dëshirueshëm, vrasjen e armiqve, përtypjen e drogës për të ruajtur gjakftohtësinë, rrahjen e bashkëshortes për ta mësuar të bindet, dhe vjedhjen e cilitdo që nuk i përket të njëjtës bandë.

(2) *Bad* - *E liga* përfshin frutat e kalbur, çdo objekt me cene, vrasjen e pjesëtarit të së njëjtës bandë, vjedhjen nga një anëtarë i familjes së nderuar dhe mashtrimin e cilitdo.

(3) *Violating taboo* - *Shkelja e tabusë* përfshin incestin, afrimin me vjehrrën, ngrënien e tapirit nga një grua e martuar para lindjes së fëmijës së parë, dhe ngrënien e brejtësve nga fëmijët.

Nuk është, po ashtu, e nevojshme të kërkohet shumë përtej Evropës për të gjetur shembuj që mbartin një diferencim të tillë. Numri i madh i termave në Finlandisht për variacionet e borës, në Arabisht për aspektet e sjelljes së devesë, në Anglisht për dritën dhe ujin, në Frëngjisht për llojet e bukës, me të cilët duhet të përballet përkthyesi, dhe ky, në një rrafsh, është problem papërkthyeshmërie. Përkthimet e Biblës kanë dokumentuar vështirësi të tjera shtesë, të cilat kanë të bëjnë, për shembull, me konceptin e Trinisë, ose rëndësinë shoqërore të parabolave në kultura të caktuara. Përveç problemeve leksikore, patjetër që ka gjuhë, të cilat nuk kanë sistem kohor ose koncepte të kohës, që mund të përputhen në një mënyrë ose në një tjetër me sistemet Indo-Evropiane. Krahasimi i Uorfit (i cili mund të mos jetë i besueshëm, por këtu citohet si shembull teorik) ndërmjet një “gjuhe të përkohshme” (Anglishtja) dhe një “gjuhe të përjetshme” (Hopi) shërben për të ilustruar këtë aspekt²⁰.

²⁰ B. L. Whorf, *Language, Thought and Reality* (Selected Writings) redaktuar nga J. B. Carroll, The MIT Press, Cambridge, Massachusetts, 1956, Faqe 213.

2.2 Papërkthyeshmëria

Sa herë që përkthyesi has vështirësi të tilla, lind krejt çështja e përkthyeshmërisë së tekstit. Ketfordi dallon dy lloje *papërkthyeshmërie*, të cilat ai i quan *gjuhësore* dhe *kulturore*. Në rrafshin gjuhësor, papërkthyeshmëria shfaqet kur nuk ka asnjë zëvendësues leksikor ose sintaksor në Gjuhën Përkthimore për njësinë në Gjuhën Burimore. Kështu, për shembull, fjalia në Gjermanisht *Um wieviel Uhr darf man Sie morgen wecken?* ose fjalia në Danisht *leg fandt brevet gjuhësisht janë të papërkthyeshme*, sepse të dyja fjalitë përfshijnë struktura që nuk gjallojnë në Shqip. Megjithatë, të dyja mund të përkthehen në Shqip saktë, nëse zbatohen rregullat e strukturës së Shqipes. Përkthyesi, pa pikë mëdyshjeje, do t'i përkthente të dyja fjalitë si *Kur dëshiron të zgjohesh nesër?* dhe *E gjeta letrën*, duke ristrukturuar rendin e fjalëve në Gjermanisht dhe duke përshtatur vendin e njëjës së shquar që vjen pas emrit në Danisht në përputhje me normat e shqipes.

Kategoria e përcaktuar nga Ketfordi e papërkthyeshmërisë gjuhësore, e cila, propozohet dhe nga Popoviçi, është e drejtpërdrejtë, por kategoria e dytë e përcaktuar prej tij është më problematike. Papërkthyeshmëria gjuhësore, argumenton ai, ndodh për shkak të mungesës në Gjuhën Përkthimore të një tipari situatësor gjegjës për tekstin në Gjuhën Burimore. Ai citon shembullin e koncepteve të ndryshme të termit “bathroom” në një kontekst Anglez, Finlandez ose Japonez, ku, edhe objekti vetë, edhe përdorimi i objektit nuk janë fare të ngjashëm. Por Ketfordi, gjithashtu, pohon se edhe njësi leksikore më abstrakte, të tilla si termi Anglisht “home” ose “democracy” nuk mund të përshkruhen si të papërkthyeshmë, dhe argumenton se shprehjet në Anglisht *I'm going home*, ose *He's at home* mund “të përkthehen aty për aty me barasvlerës përkthimore në shumicën e gjuhëve”, ndërkohë që termi “democracy” është ndërkombëtarizëm.

Tani, në njërin rrafsh, Ketfordi ka të drejtë. Shprehjet në Anglisht mund të përkthehen në shumicën e gjuhëve evropiane, kurse “democracy” është term i përdorur në shkallë ndërkombëtare. Por, ai shmang marrjen parasysh të dy faktorëve të rëndësishëm, dhe kjo duket se e tipizon problemin e një qasjeje tepër të ngushtë ndaj çështjes së papërkthyeshmërisë.

Nëse *I'm going home* përkthehet në frëngjisht *Je vais chez moi* dhe në shqip *Po shkoj në shtëpi*, kuptimi i përmbajtjes së fjalisë në Gjuhën Burimore (domethënë, shprehja e pohimit të sigurt të qëllimit për të vajtur në banesë dhe / ose në vendin e origjinës) riprodhohet vetëm lirshëm. Dhe nëse, për shembull, shprehja thuhet nga një Amerikan me banim të përkohshëm në Londër, ja do të nënkuptonte kthimin në “banesën” vetjake, ja kapërcimin e Atlantikut, pra kthimin në vendin e origjinës, në vartësi të kontekstit në të cilin përdoret, dallim ky që duhet të përcillet në Frëngjisht dhe në Shqip. Për më tepër, termi në Anglisht “home”, ashtu si ai në frëngjisht *foyer* dhe në shqip *shtëpi*, përmban një varg kuptimesh asociative, që nuk përkthehen nëpërmjet shprehjes shumë herë më të kufizuar *chez moi* ose *tek unë*. Prandaj, *home*, do të paraqiste me saktësi të njëjtin varg problemesh, ashtu si termi *bathroom* në Finlandisht ose në Japonisht.

Gjatë përkthimit të fjalës *democracy*, lindin probleme të ndërlikuara. Ketfordi e ndjen se termi është mjaft i pranishëm në leksikon e shumë gjuhëve dhe, megjithëse mund

të lidhet me situata të ndryshme politike, konteksti do të jetë udhërrëfyese i lexuesit për përzgjedhjen e tipareve të përshtatshme situatësore. Problemi këtu është se lexuesi do të përftojë një koncept për termin, duke u mbështetur në kontekstin e vet kulturor dhe do të zbatojë këtë pikëpamje të veçantë në përputhje me rrethanat. Kështu, dallimi ndërmjet mbiemrit *democratic*, siç shfaqet në tre shprehjet e mëposhtme, është themelor për tre koncepte politike krejt të ndryshme:

(1) the American Democratic Party – Partia Demokratike e Amerikës;

(2) the German Democratic Republic – Republika Demokratike e Gjermanisë;

(3) the democratic wing of the British Conservative Party – krahu demokratik i Partisë Konservatore të Britanisë.

Kështu, megjithëse termi është ndërkombëtarizëm, përdorimi i tij në kontekste të ndryshme tregon se nuk ka më terren të përbashkët nga ku mund të përzgjidhen tiparet situatësore relevante. Nëse kultura perceptohet si dinamike, atëherë edhe terminologjia e strukturimi shoqëror duhen të jenë dinamike. Lotmani thekson se studimi semiotik i kulturës jo vetëm që e konsideron kulturën të funksionojë si sistem shenjash, por edhe thekson se “pikërisht lidhja e kulturës me shenjën dhe kuptimin përbën një nga tiparet e saj tipologjike themelore”²¹. Ketfordi nisat nga premisa të ndryshme dhe, ngaqë nuk e tepron gjatë vlerësimit të natyrës dinamike të gjuhës dhe të kulturës, ai zhvlerëson kategorinë e tij të *papërkthyeshmërisë kulturore*. Për atë kohë sa gjuha është sistemi parësor modelues brenda një kulture, papërkthyeshmëria kulturore *de facto* duhet të nënkuptohet në çdo proces përkthimi.

Darbelneti dhe Vinaj, në veprën e tyre të dobishme *Stylistique comparée du français et de l'anglais (Stilistikë krahasuese e frëngjishtes dhe anglishtes)*²², kanë analizuar me hollësi pikat e dallimit gjuhësor ndërmjet dy gjuhëve, dallime që përbëjnë fusha ku përkthimi është i pamundur. Por, përsëri, vetëm Popoviçi është përpjekur për të përkufizuar papërkthyeshmërinë pa bërë ndarje ndërmjet gjuhësore dhe kulturores. Popoviçi, gjithashtu, dallon dy lloje.

I pari përkufizohet si:

Situatë në të cilën elementët gjuhësorë të origjinalit nuk mund të zëvendësohen me saktësi në termat strukturorë, linearë, funksionalë, as semantikë, si rrjedhojë e mungesës së denotacionit ose konotacionit.

Lloji i dytë kalon përtej pastërtisë gjuhësore:

Një situatë, në të cilën lidhja e shprehjes së kuptimit, domethënë, lidhja ndërmjet subjektit krijues dhe shprehjes së tij gjuhësore në origjinal, nuk gjen shprehje të saktë gjuhësore në përkthim.

Lloji i parë mund të duket si paralel me kategorinë e Ketfordit të papërkthyeshmërisë gjuhësore, ndërsa në këtë lloj të dytë futen shprehje të tilla si *Bon appetite* ose vargu

²¹ Lotman dhe Uspensky, vepër e cituar.

²² J. L. Darbelnet dhe J. P. Vinay, *Stylistique comparée du français et de l'anglais*, Didier, Paris, 1958.

interesant i shprehjeve në Danisht për të shprehur falënderime. Gramatika Daneze e Bredsdorfit për lexuesit Anglezë jep hollësi të përpunuara për përdorimin kontekstual të shprehjeve të tilla. Shpjegimi i shprehjes *Tak for mad*, për shembull, pohon se nuk ka barasvlerës në Anglisht, as në Shqip, për këtë shprehje që përdoret për të zotin ose zonjën e shtëpisë nga miqtë ose pjestarët e familjes pas ngrënies së një vakti.

Një shembull pak më i vështirë është shembulli në rastin e fjalës Italisht *tamponamento* në fjalinë *C'e stato un tamponamento*.

Përderisa Anglishtja dhe Italishtja janë aq të afërta, sa të ndjekin një strukturë afërsisht të ngjashme të organizimit të fjalisë në lidhje me pjesët përbërëse dhe rendin e fjalëve, fjalia del e përkthyeshme plotësisht. Edhe rrafshi konceptual është i përkthyeshem: një ngjarje që ishte duke ndodhur në të shkuarën njoftohet në të tashmen. Vështirësia lidhet me përkthimin e emrit Italisht, i cili në Shqip del si fjali dëftore pohore dhe në Anglisht del si togfjalësh emëror. Versioni në Gjuhën Përkthimore, i cili lejon larushinë në sintaksën Shqipe dhe Angleze, është:

Ka ndodhur / ndodhi një aksident i lehtë (bëhet fjalë për një automjet) – There has been/there was a slight accident (involving a vehicle).

Për shkak të dallimeve në përdorimin e kohëve, fjalitë në Gjuhën Përkthimore mund të marrin një ose dy forma, në vartësi të kontekstit të fjalisë dhe, për shkak të gjatësisë së togfjalëshit emëror, kjo, gjithashtu, mund të shkurtohet, me kusht që natyra e aksidentit të mund të përcaktohet jashtë fjalisë nga marrësi. Mirëpo, kur rëndësia e *tamponamento* shqyrtohet në raport me shoqërinë Italiane si një e tërë, termi nuk mund të mos kuptohet plotësisht pa pasur një farë njohurie për shprehitë e vozitësve Italianë, shpeshësinë e “ndodhjes së aksidenteve të lehta” dhe peshën dhe relevancën e incidenteve të tilla, kur ndodhin. Shkurtimeisht, *tamponamento* është një shenjë që lidhet me kulturën ose me kuptimin kontekstual, që nuk mund të përkthehet as edhe me një shprehje shpjeguese. Prandaj, lidhja ndërmjet subjektit krijues dhe shprehjes së tij gjuhësore nuk mund të zëvendësohet me saktësi në përkthim.

Lloji i dytë i përcaktuar nga Popoviçi, si kategoria e dytë e përcaktuar nga Ketfordi, ilustron vështirësitë e përshkrimit dhe përkufizimit të kufijve të përkthyeshmërisë, mirëpo, ndërkohë që Ketfordi niset nga brendapërbrenda gjuhësisë, Popovivçi niset nga një pozitë që përfshin teorinë e komunikimit letrar. Bogusllav Lavendovski, në një artikull ku përpiqet të përmbledhë gjendjen e studimeve përkthimore dhe semiotikës, e ndjen se Ketfordi “divorcohet nga realiteti”, kurse Zhorzh Munini e ndjen se i është kushtuar vëmendje e tepruar problemit të papërkthyeshmërisë në kurriz të zgjidhjes së disa prej problemeve aktuale me të cilat duhet të merret përkthyesi²³.

Munini pranon përfitimet e mëdha që përparimet në gjuhësi u kanë sjellë Studimeve Përkthimore; zhvillimi i gjuhësisë strukturore, vepra e Sosyrit, e Hjelmslevit, e Qarqeve Gjuhësore të Moskës dhe të Pragës kanë pasur vlerë të madhe, dhe vepra e Çomskit dhe gjuhësia transformuese, gjithashtu, kanë ushtruar ndikimet e veta,

²³ B. P. Lawendowski, ‘On Semiotic Aspects of Translation’, te Th. Sebeok (redaktor), *Sight, Sound and Sense*, Indiana University Press, Bloomington, 1978, Faqe 264-283.

sidomos në lidhje me studimin e semantikës. Munini e ndjen se, falë zhvillimeve në gjuhësinë bashkëkohore, ne mund (dhe duhet) të pranojmë se:

(1) përvoja vetjake është e papërkthyeshme.

(2) në teori, njësitë bazë të çdo dy gjuhëve (për shembull, fonemat, monemat, etj.) nuk janë të krahasueshme gjithmonë.

(3) komunikimi mundësohet, kur merren parasysh situatat gjegjëse të folësit dhe të dëgjuesit, të autorit dhe të përkthyesit.

Me fjalë të tjera, Munini beson se gjuhësia dëshmon se përkthimi është një proces dialektik, që mund të përmbushet me sukses relativ.

Përkthimi gjithmonë mund të fillojë me situatat më të qarta, me mesazhet më konkrete, me universalet më të thjeshta. Por, për sa i përket shtjellimit të gjuhës në tërësinë e vet, së bashku me mesazhet e saj më subjektive, përmes studimit të situatave të përgjithshme dhe shumëzimit të konteksteve që kanë nevojë për t'u sqaruar, atëherë, nuk ka pikë dyshimi se komunikimi nëpërmjet përkthimit nuk mund të përfundohet plotësisht, gjë që, gjithashtu, dëshmon se edhe nuk është përherë krejt e pamundur²⁴.

Siç është sugjeruar tashmë, përcaktohet qartë detyra e përkthyesit: nga përkthyesi kërkohet të gjejë një zgjidhje edhe për problemet më tmerruese. Këto zgjidhje mund të jen nga më të larmishmet; vendimi i përkthyesit se çfarë përbën informacion të pandryshueshëm në lidhje me një sistem të dhënë referimi, në vetvete, është akt krijues. Levi e vë theksin tek elementi intuitiv gjatë përkthimit:

Si në të gjitha proceset semiotike, edhe përkthimi ka *dimensionin e vet pragmatik*. Teoria përkthimore priret të jetë normative, t'u japë përkthyesve udhëzime për zgjidhjet **optimale**; mirëpo, puna reale përkthimore është pragmatike; përkthyesi zgjedh për këtë njërin nga zgjidhjet e mundshme, e cila premtion maksimumin e efektit përmes minimumit të përpjekjeve. Domethënë, ai zgjedh me intuitë të ashtu-quajturën Strategji Minimale – Maksimale²⁵.

²⁴ Mounin, vepër e cituar, Faqe 279.

²⁵ Jiff Levy, *Die literarische Übersetzung. Theorie einer Kunstgattung*, përkthyer nga Walter Schamschula, Athenaiion, Frankfurt am Main, 1969.

Kreu i tretë

Kapërcimi i pengesave përkthimore

Me përkthim letrar nënkuptohet përkthimi i gjinive të ndryshme letrare. Letërsia e vërtetë imagjinare ka katër tipa kryesorë, domethënë, poezinë, dramën, tregimin e shkurtër dhe romanin²⁶. Përkthimi i veprave letrare nuk është detyrë e lehtë. Çdo vepër letrare ka problemet e veta specifike të përkthimit.

Kështu, kryesore gjatë përkthimit të dramës është çështja e vënies në skenë, përderisa drama shkruhet për t'u shfaqur, për t'u luajtur, dhe jo thjesht për t'u lexuar. Për më tepër, përthyesi, gjatë përkthimit të dialogut, duhet të jetë në gjendje të zgjedhë gjuhën që përshtatet me mjediset ku veprojnë personazhet, si dhe me marrëdhëniet ndërmjet tyre²⁷.

Kështu, përkthimi i tregimit të shkurtër është forma më e vështirë letrare për t'u përkthyer menjëherë pas poezisë. Vështirësia buron nga fakti se duhen ruajtur me kujdes, përmes efekteve të caktuara të lidhura, përqendrimi dhe uniteti formal dhe tematik.

Kështu, kryesor mes problemeve gjatë përkthimit të romanit është domethënia relative e kulturës së Gjuhës Burimore dhe e qëllimit moral të shkrimtarit për lexuesin²⁸.

Nga të katër gjinitë letrare të letërsisë serioze, poezia është më e vështira për t'u përkthyer. Sfidat me të cilat përballlet përkthyesi letrar gjatë përpjekjeve për të imituar formën, ritmin, kuptimin dhe imazhet e poezisë në një gjuhë tjetër, si dhe procedurat e sugjeruara për të përballuar sfida të tilla, ia vlejnë të hulumtohen.

Pangjashmëritë, ndryshimet ndërmjet formave poetike të Gjuhës Burimore dhe të Gjuhës Përkthimore paraqesin një sfidë për përkthyesit e poezisë. Është më se e natyrshme që çdo gjuhë të ketë forma e veta poetike dalluese, të përveçme. Kjo mund të shihet, nëse krahasohen format e vargëzimit të Gjuhës Burimore dhe të Gjuhës Përkthimore (në rastin tonë të Gjuhës Angleze dhe të Gjuhës Shqipe).

Duke marrë si të mirëqenë faktin se përkthyesi e njeh vargëzimin në gjuhën e vet amtare, po ndalemi tek Poezia angleze, e cila ndahet në gjini të ndryshme, për sa i përket formës. Tipat më të përhapur tradicionalë janë lirikë, narrative, epikë, dhe dramatikë. Nga ana e vet, poezia lirike ndahet në tipa të shumëllojshëm, domethënë, kemi sonetin, baladën, elegjinë dhe oden. Secila syresh ka formën e vet të përcaktuar. Për shembull, soneti Shekspirian përbëhet nga 14 vargje të ndara në tre strofa katër vargëshe dhe një kuplet, kurse skema e rimës është gjithnjë ABAB-CD-DEFE-GG. Për sa i përket strukturës strofore, ka shumë lloje strofash. Një strofë është një strofë katërvargëshe; një tercinë përbëhet nga tre vargje, dhe një *otava rima* (strofë e

²⁶ P. Newmark, *A Textbook of Translation*, Longman, London, 2003, Faqe 39.

²⁷ M. Massoud, *Translate to Communicate: A Guide for Translation*, David C. Cook Foundation, 1988, Faqe 49-50.

²⁸ P. Newmark, *A Textbook of Translation*, Longman, London, 2003, Faqe 170-171.

vargëzimit epik me rimë ABABABCC), përbëhet nga tetë vargje. Te poezitë narrative dhe lirike, strofa mund të përbëhet nga gjashtë deri në shtatë vargje. Strofa Spenseriane²⁹ përbëhet 9-11 vargje. Strofa e baladës përbëhet nga një numër vargjesh, të cilët kanë përkatësisht katër këmbë dhe tre këmbë, dhe vargje të tilla mund të shoqërohen nga një refren. Në Anglisht dy fjalë rimojnë, kur zanorja e fundit e theksuar, si dhe të gjithë tingujt që e pasojnë, janë të njëjlojtë dhe dalin në të njëjtin rend, si, për shembull, “bream” (lloj krapit) / “seam” (tegel)³⁰.

Çështjet e përshtatjes dhe të zbatueshmëria kanë rëndësinë më të madhe, kur zgjidhet forma e poezisë në Gjuhën Përkthimore (Dickens, Hervej, and Higgins 92)³¹. Për të përkthyer poezinë me saktësi, përkthyesit duhet të jenë poetë, të cilët i njohin format poetike të Gjuhës Burimore dhe të Gjuhës Përkthimore. Po kaq e rëndësishme është që poetët përkthyes duhet të kenë ndjeshmërinë se kur duhet të përkthejnë një poezi në vargje dhe kur duhet ta përkthejnë atë në prozë³². Kjo është sfida më e madhe me të cilën përballen përkthyesit e vargjeve të Shekspirit në Shqip ose gjuhë të tjera. Pas kësaj, përkthyesit i duhet të vendosë kur duhet të përkthejë në vargje të lira, dhe kur të përkthejë në poezi të rregullt të rimuar, në trajtë kolone. Vendimi është i rëndësishëm për shkak të faktit se kulturat ndryshojnë në mënyrën sesi përdorin ose lidhen me tipa të ndryshme gjuhe.

Në disa raste, përkthyesi mund të zgjedhë të përkthejë poezinë në prozë ose në vargje të lira. Ka mendime se dramat poetike historike përkthehen më mirë në prozë se sa në vargje. Arsyeja është se proza mund të përcjellë kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të saktë të Gjuhës Përkthimore, si dhe të ruajë frymën e fakteve dhe të ngjarjeve historike të rrëfyera. Nganjëherë, mund të parapëlqehet përkthimi i një poezie në vargje të lira. Gjatë përpjekjeve për të imituar një poezi në Shqip, për shembull, mund të jetë e pamundur të përcillen në Anglisht tiparet e Shqipes në rrafshin fonetik (për shembull, aliteracioni dhe asonanca), e cila mund të mos jetë më pak e rëndësishme se sa tiparet e metrit dhe të ritmit. Për më tepër, imitimi mund të kërkojë që përkthyesi të ndryshojë në mënyrë dramatike kuptimin konotativ, me qëllim që të bëjë që teksti në Gjuhën Përkthimore t’i përshtatet formës së dëshiruar të vargut, vargëzimit, poezisë. Këtu, përkthyesi mund të parapëlqejë përkthimin e *Këngëve të Kreshnikëve*, për shembull, në varg të lirë, ose mundësisht në një lloj proze, e cila ruan të paktën tiparet prozodike dhe zanore, tingëllimore të poezisë. Përdorimi me kujdes i fjalorit që i përket qartas regjistrimit poetik, ose ai që ka domethënie të përshtatshme në kontekstin në të cilin është përdorur, mund të kompensojë humbjen e tipareve metrike dhe rimuese³³.

Duket sheshit se ekziston një lidhje ndërmjet qëllimit dhe formës së poezisë³⁴. Gjatë përkthimit të poezisë lirike Angleze në Shqip mund të parapëlqehet përkthimi i gjithë

²⁹ Strofë që përbëhet nga tetë vargje me pentametër jambik dhe një aleksandrinë me skemë rime: ABABBCBCC.

³⁰ Dickens, James, Hervej, Sander, and Higgins, Ian. *Thinking Arabic Translation*. London and New York: Routledge, 2002, faqe 81.

³¹ Po aty, faqe 92.

³² Massoud, Mary. *Translate to Communicate: A Guide for Translation*. David C. Cook Foundation, 1988 faqe 50.

³³ Dickens, James, Hervej, Sander, and Higgins, Ian. *Thinking Arabic Translation*. London and New York: Routledge, 2002, faqe 92.

³⁴ Basil, Hatim, and Mason Ian. *Discourse and the Translator*. London and New York: Longman, 1994, faqe 12.

poezisë së rimuar dhe të rregullt, siç janë këngët dhe psalmet, në vargje të rimuara dhe të rregullta. Padyshim, muzika e poezisë lirike është thelbësore për përcjelljen e kuptimit, domethënë, ajo ka një kuptim, i cili, padyshim, nuk është më pak i rëndësishëm se kuptimi i fjalëve. Një tjetër shembull është përkthim i psalmeve. Një psalm nuk ka formë të përcaktuar, kështu, vargjet e tij ndryshojnë për nga gjatësia. Sa të jetë e mundur, përkthyesi duhet të gjejë në mënyrë krijuese barasvlerësin e tij në Gjuhën Përkthimore, domethënë, një psalm në Gjuhën Përkthimore dhe jo thjesht përkthimin e kuptimit të Gjuhës Burimore. Pra, përkthimi i këngëve dhe psalmeve, sado i saktë të jetë përkthimi, në një formë, përveç asaj me vargje të rimuara dhe të rregullta, ka gjasa të dëmtojë, të shtrembërojë, qëllimësinë e poezive. Nga ana tjetër, gjatë përkthimit të poezisë lirike, e cila nuk ka formë të përcaktuar, përkthyesi është i lirë të zgjedhë formën poetike më të përshtatshme për lexuesin e Gjuhës Përkthimore. Pra, ai prodhon një poezi që ka karakteristikat e rimës dhe të ritmit të Gjuhës Përkthimore.

Po kaq e rëndësishme është zgjedhja e strukturës strofore më të përshtatshme për Gjuhën Përkthimore. Përkthyesit të *Këngëve të Kreshnikëve* nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Angleze, të cilat tradicionalisht shkruhen si një bllok i tërë, do t'i duhet të bëjë një zgjedhje: Ja të ruajë bllokun e plotë të vetëm nga Gjuha Burimore, ja të prodhojë një strofë që duket më e natyrshme për formën e strofës në Gjuhën Angleze. Forma strofore e vargjeve plotësuese është sfiduese gjatë përkthimit, sepse ajo ka tiparet e veta unake. Vargjet lidhen me njëri-tjetrin gramatikisht, pra, ato mund të lexohen sikur të ishte një fjali e vetme. Rrjedhimisht, ato lidhen nga pikëpamja kuptimore, domethënë, kuptimi bëhet i qartë vetëm pas leximit të të gjitha vargjeve dhe arrihet te pika. Tipare të tilla themelore duhet të ruhen në Gjuhën Përkthimore.

Rima paraqet një sfidë për shkak të faktit se çdo gjuhë ka trajtat, strukturat, modelet e veta unake rimuese. Për shembull, modelet rimuese tradicionale të Gjuhës Shqipe ndryshojnë nga modelet rimuese të Gjuhës Angleze. Pra, përkthyesi që vendos të përdorë rimën gjatë përkthimit të një poezie Shqip në Anglisht duhet të bëjë një zgjedhje: Ose të përdorë stilin rimues të Shqipes, e cila përcjell tingëllima të huaja te lexuesi Anglez, ose të përdorë një model rimues, i cili tingëllon më tepër i natyrshëm për veshin e lexuesit Anglez, pavarësisht nga humbja e ndjeshme në rrafshin fonik, domethënë, zanor.

Dallimet ndërmjet modeleve metrike të Gjuhës Burimore dhe të Gjuhës Përkthimore përbëjnë fushën e dytë problemore në përkthimin e poezisë. Metri i Shqipes është sasior: ai varet nga numri i bashkëtingëlloreve dhe i zanoreve dhe rrallë lidhet me theksin. Dallimi në Shqip ekziston ndërmjet rrokjeve të shkurtra, domethënë, të patheksuara. Në përgjithësi, çdo rrokje fillon me një bashkëtingëllore, me përjashtim të fjalëve që fillojnë me zanore; prandaj, nuk është e zorshme të dallohet se ku fillon dhe ku mbaron një rrokje. Këmbët përbëhen nga një numër i ndryshueshëm rrokjesh, të shumtën e herës, tre ose katër syresh. Një kombinim i këtyre këmbëve përbën një metër të caktuar. Nga shumë metra që njihen në vargëzimin klasik të Shqipes, vetëm njëri syresh përdoret zakonisht nga poeti në një poezi. Mirëpo, ekziston një shkallë e variacionit ritmik në të njëjtën poezi për shkak të variacionit të tipat e rrokjeve.

Ndërkohë, metri i Anglishtes është cilësor: ai varet nga mënyra se si shqiptohen rrokjet, por jo nga numri i rrokjeve. Metri i Anglishtes është metër rrokjor-dhe-theksor. Ashtu si në Shqipe, vargu përcaktohet nga pikëpamja e këmbëve. Një këmbë

është një grup tradicional rrokjesh të theksuara ose të patheksuara të vendosura sipas një rendi të caktuar. Një varg i poezisë tradicionale përbëhet nga një numër i fiksuar këmbësh të veçanta³⁵. Nga pikëpamja e kohës, domethënë, notës muzikore, metri ndahet në tipa kryesorë, domethënë, në ritme ngjitëse kohore, domethënë, note dhe në ritme zbritëse kohore, domethënë, note. Pra, valët tingëllore përfaqësojnë kalimin nga nota zbritëse te nota ngjitëse, te tipi i parë, dhe nga nota ngjitëse te nota zbritëse, te tipi i dytë. Ky quhet ritmi bazë, por në praktikë modulimet e transformojnë atë nga nota ngjitëse te nota zbritëse dhe anasjelltas, sidomos në poezinë dramatike (dramën në vargje). Mes ritmit bazë ngjitës, këmba jambike, e cila përbëhet nga një rrokje e shkurtër ose e patheksuar, që shoqërohet nga një rrokje e theksuar, është më i përhapuri. Ilustrimi i mëposhtëm është një shembull i këmbës jambike:

The cur/few tolls /the knell /of par/ting day/

Ky varg ka pesë këmbë jambike, dhe prandaj quhet pentametër jambik³⁶. E dyta më e përhapura është këmba anapestike, e cila përbëhet nga dy rrokje të shkurtra / të patheksuara, të cilat ndiqen nga një rrokje e gjatë, domethënë, e theksuar. Te ritmi bazë zbritës, këmba trokaike, e cila përbëhet nga një rrokje e theksuar, e cila ndiqet nga një rrokje e patheksuar, përdoret gjerësisht. Këmba daktilike, e cila përbëhet nga një rrokje e theksuar, e cila ndiqet nga dy rrokje të shkurtra, domethënë, të patheksuara, përdoret gjithashtu, por më rrallë. Me përjashtim të këtyre katër këmbëve, të gjitha këmbët e tjera nuk janë asgjë tjetër, përveç se moduleme. Anglishtja ka një lloj tjetër metri, pra, metrin e theksit të fortë. Në një metër të tillë, rëndësi kanë vetëm theksat, pavarësisht nga numri i rrokjeve të patheksuara, domethënë, të shkurtra. Një pjesë shumë e madhe e poezisë moderne e përdor këtë metër, shpesh duke e kombinuar me metrin rrokjor-dhe-theksor.

Askush nuk mund të vërtetojë se një metër i Anglishtes, për shembull, është barasvlerësi tipik i një metri të Shqipësisë. Në mënyrë të natyrshme, përkthyesi nuk mund të përkthejë ritmin e një gjuhe të caktuar në një gjuhë tjetër, pavarësisht nga aftësitë e tij. Në të vërtetë, atij nuk i kërkohet ta bëjë këtë gjë, sepse ritmi i Gjuhës Burimore nuk ka pikë kuptimi, as lidhjeje, me lexuesin e Gjuhës Përkthimore. Përkundrazi, përkthyesit i duhet të transferojë artistikisht ritmet e Gjuhës Shqipe, për shembull, në barasvlerësit gjegjës të Gjuhës Angleze, në mënyrë që lexuesi Anglez t'i shijojë ata. Në mënyrë të ngjashme, përkthyesi i Soneteve të Shekspirit duhet të njohë vargëzimin në Gjuhën Shqipe dhe prozodinë e tij, për të riprodhuar ritmin e Shekspirit në Gjuhën Shqipe, në mënyrë të tillë, që t'i përshtatet lexuesit Shqiptar. Zgjedhja e metrit varet nga mënyra se si përkthyesi e përjeton situatën, domethënë, gjendjen, në poezi.

Gjatësia e vargut përcakton metrin në të gjitha gjuhët, duke përfshirë Shqipërinë dhe Anglishten. Stili i vargjeve plotësuese është i përhapur si në poezinë klasike, ashtu edhe në poezinë moderne Angleze. Sipas këtij stili, vargjet lidhen me njëri-tjetrin nga pikëpamja gramatikore dhe kuptimore. Gjatë përkthimit të një poezie me tipare të tilla në Gjuhën Shqipe, përkthyesi përballet me probleme që lindin nga dallimi ndërmjet metrave, te të cilët duhet të ndalet dhe te të cilët nuk duhet të ndalet. Një tjetër sfidë

³⁵ Dickens, James, Herve, Sander, and Higgins, Ian. *Thinking Arabic Translation*. London and New York: Routledge, 2002, faqe 89.

³⁶ Po aty, faqe 89.

është të balancojë ruajtjen e imazhit ritmik të një metri të Anglishtes në Shqip me riprodhimin e tij, si një metër që është më tipik për Shqipen.

Gjatë përkthimit të poezisë, lind një sfidë nga fakti se të gjitha poezitë kanë shumësi, domethënë, pluralitet kuptimi. Siç sugjeron Beikëri³⁷, nuk është e lehtë të përcaktohet “edhe kuptimi bazë parafjalor i një fjale ose thënieje, domethënë, shprehjeje, me siguri absolute”. Natyrisht, në të shumtën e herëve, fjalët kanë “kufi të mjegulluar, domethënë, të paqartë”, dhe kuptimet e tyre janë të diskutueshëm në shkallë të gjerë³⁸. Me fjalë të tjera, çdo akt i leximit të një poezie është në vetvete akt përkthimi. Nocioni i të kuptuarit të Gjuhës Burimore është “mashtues”; leximi nga përkthyesi i poezisë në Gjuhën Burimore është vetëm njëri nga tërë vargu, domethënë, gama, e kuptimeve të mundshme. S. Basneti³⁹ pranon se ndërmjet përkthimit dhe interpretimit nuk ka asnjë dallim: përkthyesi fillimisht lexon, domethënë, përkthen, Gjuhën Burimore, dhe pastaj përkthen në Gjuhën Përkthimore⁴⁰. Prandaj, përkthyesi është i detyruar të bëjë përpjekje të pareshtura dhe shumë më të mëdha se sa lexuesi mesatar, me qëllim që të kuptojë poezinë saktë.

Përkthimi ndërgjuhësor ka gjasa të pasqyrojë interpretimin krijues të Gjuhës Burimore, të cilin e ka bërë përkthyesi⁴¹. Përkthyesi duhet të përpiqet që të perceptojë, të kapë me sa përpikmëri që të jetë e mundur kuptimet e fjalëve të Gjuhës Burimore, me qëllim që t’i përcjellë ato në Gjuhën Përkthimore. Imponimi ndaj lexuesve i leximit nga përkthyesi i Gjuhës Burimore është një gabim i zakonshëm, i cili haset gjatë përkthimit të poezisë, ngaqë polivalenca është tipar thelbësor i diskursit poetik. Përderisa Gjuha Burimore lejon shumëllojshmëri reagimesh mes lexuesit të Gjuhës Burimore, është detyrë e përkthyesit të poezisë të ruajë sa është e mundur vargun, domethënë, gamën e reagimeve të mundshme mes lexuesve të Gjuhës Përkthimore, duke ruajtur të paprekur kuptimet e mundshme të pranishme në Gjuhën Burimore. Njumarku (Newmark) sugjeron se përkthyesi mund “të përkthejë kuptimin më të mundshëm, si dhe të vendosë kuptimin më pak të mundshëm në një shënim sqarues, nëse ai gjykon se ky kuptim është i rëndësishëm”⁴².

Përkthyesi i poezisë duhet të jetë i vetëdijshëm për dallimin ndërmjet kuptimit referues dhe kuptimit poetik. Detyra e përkthyesit të poezisë nuk kufizohet në përcjelljen e kuptimit të fjalëve, domethënë, ta referojë lexuesin tek e njëjta gjë që e ka referuar poeti i Gjuhës Burimore, ajo gjithashtu përfshin përcjelljen e domethënies dhe prodhimin e të njëjtit efekt, ashtu si Gjuha Burimore. Ndryshe nga përkthimi shkencor, domethënë, teknik, suktesi gjatë përkthimit të poezisë nuk varet nga shkalla në të cilën, nga pikëpamja preferenciale, përkthimi i afrohet poezisë në Gjuhën Burimore, përkundrazi, ai varet nga kritere të tjera, të bazuara në kritikën letrare dhe nga aplikimet e tyre në gjuhë dhe në shkrimtari. Kjo është e rëndësishme, sepse teksti ka gjasa të prodhojë kuptime, të cilay nuk janë fizikisht të pranishme në të. Sërish, vështirësia gjatë përkthimit të poezive lind jo vetëm nga rrafshet

³⁷ Baker, Mona. *In Other Words: A Coursebook in Translation*. London and New York: Routledge, 1992.

³⁸ Po aty, faqe 17.

³⁹ Bassnet-Mcguire, Susan. *Translation Studies*. London: Methuen, 1980.

⁴⁰ Po aty, faqe 82.

⁴¹ Po aty, faqe 82.

⁴² Newmark, Peter. *A Textbook of Translation*. London: Longman, 2003, faqe 220.

ndryshuese të kuptimeve, por edhe nga nevoja që përkthyesi duhet të njohë kontekstin kulturor të gjuhëve në fjalë, të zgjedhë fjalën më të përafërt me kuptimin e autorit.

Përkthimi i tonit të poetit të Gjuhës Burimore është detyra më sfiduese, sepse mishëron qëndrimin e poetit ndaj poezisë së autorit; nëse ai e ka seriozisht apo do të shkaktojë të qeshura, duke vënë në lojë njerëz dhe ngjarje të përfshira në to; nëse ai synon zmadhimin ose zvogëlimin, domethënë, shfaqjen me rezerva. Përkthimi i tonit në një gjuhë tjetër që ka konvencione letrare të ndryshme nga Gjuha Burimore është padyshim tejet i vështirë. Përderisa të kuptuarit e poezisë në Gjuhën Burimore është “mashtues”, si dhe është më e saktë të përshkruhet kuptimi i përcjellë nga përkthyesi, si interpretim i kuptimit të përcjellë nga autori i tekstit poetik burimor, nuk mund të vërtetohet se poezia ka vetëm një ton ose se ekziston vetëm një ton i vërtetë ose “i synuar”. Pra, gjatë përkthimit të një poezie që ka tone të qarta dhe të nënkuptuara, përkthyesit i duhet t’i ruajë këto tone sa të jetë e mundur. Kjo do të thotë se përkthyesi duhet të jetë besnik sa të mundet, duke mos e penguar veten nga përdorimi i fjalëve dhe shprehjeve të përditshme, për shembull, nëse kjo e ndihmon për të përcjellë tonin, si dhe duke ditur se gjuha ka rrafshë të ndryshme që mund ta ndihmojnë për “të hipur” ose “zbitur” në tone. Në të vërtetë, njohja, domethënë, afria, me idetë dhe kuptimin e nënkuptuar të poetit të Gjuhës Burimore është thelbësore për përkthimin e synimit të autorit burimor të poezisë. Prandaj, thuhet se përkthyesit më të mirë të letërsisë dhe të poezisë janë ata që janë më “të akorduar” me shkrimtarin burimor. Kjo i jep mundësi përkthyesit të përvetësojë frymën e origjinalit dhe të shndërrojë synimin e poetit në synim të vetin.

Metafora është një nga figurat letrare, e cila më shumë varet nga kuptimi se sa nga tingulli. Ajo përkufizohet si një figurë letrare e mbështetur te krahasimi që më shumë nënkuptohet se sa shprehet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Të thuash: *Ai ishte luan në betejë*. Sipas Njumarku, metafora ka dy qëllime. I pari është njohës, domethënë, qëllimi referues: Të përshkruajë një proces ose gjendje mendore, një koncept, një person, një objekt, një cilësi ose një veprim më hollësisht dhe në mënyrë më të ngjeshur, domethënë, më të saktë, se sa është e mundur në gjuhën e fjalëpërfjalshme ose fizike. I dyti është estetik, domethënë, qëllimi pragmatik: të joshë shqisat, të ngjallë interes, të qartësojë, të kënaqë, të gëzojë, të befasojë⁴³. Në përgjithësi, gjatë përkthimit të imazheve, parimi më i rëndësishëm është se përkthimi duhet të japë të njëjtin kuptim, si origjinali, dhe duhet të prodhojë të njëjtin efekt emocional. Një metaforë mund të jetë universale (a “glassy” stare = vështrim “i ngrirë”); kulturore (a “beery” face = fytyrë “e burrëruar”); ose individuale (a “papery” check = çek “i hollë”⁴⁴). Njumarku argumenton se janë gjashtë tipa metaforash: të vdekura, klishé, të harruara, të përshtatura, të reja (të kohëve të fundit), dhe origjinale.

Përkthyesit të poezisë mund t’i duhet të zgjedhë një procedurë të përshtatshme për përkthimin e metaforës. Përkthyesi duhet të ketë një ndjeshmëri estetike ndaj imazheve dhe simboleve, si dhe të zotërojë shkathtësinë, domethënë, zhdërvjelltësinë, për të zgjedhur mënyrën efektive të përcjelljes së efektshme të kuptimit dhe të metaforës, duke zgjedhur mes shumë mundësive. Zakonisht, metaforat kulturore janë më të vështira për t’u përkthyer se sa metaforat universale ose personale. Vështirësia lind kur lulet dhe barërat vendore përdoren si metafora. Për të prodhuar të njëjtin

⁴³ Po aty, faqe 104.

⁴⁴ Po aty, faqe 105.

efekt, përkthyesit mund t'i duhet të krijojë një metaforë kulturalisht të barasvlershme me metaforën e Gjuhës Burimore, ose të konvertojë metaforën e Gjuhës Burimore, për të dhënë kuptimin e duhur, ose nëse është e mundur, duke i shtuar kuptime metaforës, pra, duke e pasuruar kuptimisht metaforën. Për shembull, imazhi i një personi të neveritshëm, domethënë, të padurueshëm, i përshkruar në Anglisht si “a pain in the neck” mund të përkthehet në Gjuhën Shqipe si “halë në sy”. Përkthyesit të poezisë i duhet të riprodhojë metafora origjinale në mënyrë skrupuloze edhe pse mund të shkaktojë tronditje kulturore tek lexuesi i Gjuhës Përkthimore, i cili nuk e njeh kulturën e Gjuhës Burimore. Për shembull, përkthimi në Shqip i vargjeve të Shekspir, “Shall I compare thee to a summer’s day” = Me kë të të krahasoj, veç se me një ditë vere”, nuk ngjall ndonjë lloj ngasje te lexuesi Shqiptarë. Lexuesit Shqiptar i duhet të bëjë disa përpjekje për të kuptuar të vërtetën e metaforës, duke u mbështetur në vargjet pasuese. Këtu, përkthyesi i poezisë nuk mund t'i bëjë një rrëfim lexuesit, duke transferuar kulturën e Gjuhës Burimore në barasvlerësin e Gjuhës Përkthimore. Lexuesi duhet të kuptojë këtë sfond dhe, nëse dëshiron ta ndjejë atë, leximi i përsëritur ka më shumë gjasa ta bëjë atë pronë të tij. Kur metafora njihet në kulturën e Gjuhës Përkthimore, përkthyesi mund të transferojë imazhin e metaforës. Mirëpo, nëse përkthyesi e konsideron metaforën të rëndësishme, detyra e tij është ta përcjellë atë, ta fusë atë në Gjuhën Përkthimore dhe në kulturën e saj⁴⁵.

Gjatë përkthimit të poezisë, lojërat me fjalët janë më të vështirat për t'u përkthyer, ngaqë bartin kufizime për shkak të metrit. Sipas Njumarkut, lojërat me fjalët në Anglisht janë më të përhapura, sepse njërrokëshet dalin shpesh dhe shumë lehtë. Tipi më i thjeshtë i lojës me fjalë është antanaklaza, domethënë, përdorimi i dy fjalëve që kanë të njëjtën formë dhe kuptime të ndryshme (për shembull, “wood within wood” = “i çmendur brenda në pyll”, me fjalën e parë “wood”, që ka kuptimin “mad” (“i çmendur”) dhe me fjalën e dytë që ka kuptimin “forest” (“pyll”). Një lojë fjalësh krijohet edhe duke përdorur një fjalë të vetme (për shembull, “tit” = “thithkë” dhe “trishtil”), dy fjalë që shqiptohen një lloj (“peace” = “paqe” dhe “piece” = “copë”), ose një grup fjalësh me shqiptim të njëjtë në dy kuptimet e tyre të mundshme, zakonisht duke synuar shkaktim të qeshure ose argëtim, dhe ndonjëherë për të përforcuar kuptimin⁴⁶. Loja me fjalë, për nga efektet e veta, varet nga kombinimi shqiptim-kuptim; në përgjithësi, nuk përsëritet në gjuhë të tjera, thjesht ngaqë dy gjuhë asnjëherë nuk janë të njëjta. Përkthyesit të poezisë i duhet të sakrifikojë lojërat me fjalë, thjesht ngaqë bartin kufizime për shkak të metrit. Për shembull, kur qëllimi i lojës me fjalë është vetëm shkaktimi i të qeshurës, poeti mund ta kompensojë këtë, duke zgjedhur një lojë tjetër me fjalë, me kuptim të ndryshëm, por të lidhur me burimoren. Nëse të dy kuptimet e lojës me fjalë janë më të rëndësishme se mjeti, dome thënë, mediumi, poeti mund t'i përkthejë ato, duke riprodhuar dy kuptime në mënyrë të papajteshme. Kur një lojë me fjalë përdoret në poezinë e Gjuhës Burimore për të ilustruar një gjuhë a të folur a një shkarje gjuhësore a kur kuptimi është më i rëndësishëm se vërejtja e hollë (mençuria), poeti duhet të transferojë, të përkthejë, në të dyja kuptimet, dhe zakonisht edhe ta shpjegojë atë.

Aliteracioni dhe asonanca janë nga modelet më të përhapura në poezi dhe kanë qëllime tematike dhe shprehëse. Aliteracioni është përsëritja e tingujve bashkëtingëllorë dhe zanorë identikë, shpesh në fillim të fjalëve si, për shembull,

⁴⁵ Po aty, faqe 164.

⁴⁶ Po aty, faqe 217.

“artful aid” = “ndihmës i shkathët”. Asonanca është përsëritja brenda fjalëve e të njëjtit tingull ose tog tingujsh, si, për shembull, tek “a swift snifter afterwards” = “një goditje e rrufeshme pastaj”. Tingujt fundorë që nuk janë të rimuar përkufizohen si asonancë. Të dy tipat mund të dalin së bashku. Një tjetër sfidë në rrafshin fonik, domethënë, zanor, është onomatopeja, ku kuptimi i fjalës përcillet përmes tingujve të saj, për shembull, “hiss” = “fishkëllimë” ose “buzz” = “murmurimë”. Këto tipare fonike, domethënë, zanore, quhen simbolizëm tingullor, i cili ka dy forma. E para ndodh kur tingulli i një fjale në poezi ndjell, domethënë, evokon fjalë të tjera, të cilat nuk janë të pranishme në tekst. E dyta ndodh kur një tingull shfaqet në më shumë se sa një fjalë dhe vendos lidhje ndërmjet fjalësh të tilla, duke i përcjellë asaj nënkuptimet e të tjerave.

Përkthimi i aliteracionit dhe i asonancës është një sfidë përkthimi e veçantë përderisa ato varen nga përsëritja e tingujve dhe bartin kufizime për shkak të metrit. Është e qartë se asnjë Gjuhë Përkthimore nuk mund të riprodhojë të njëjtën sekuencë tingujsh ashtu si Gjuha Burimore, ngaqë dy gjuhë kurrë nuk janë të njëjta nga pikëpamja fonike, domethënë, zanore. Përkthyesit që përballet me simbolizmin tingullor i duhet të vendosë se çfarë funksioni ka ai, para se sa të fillojë përkthimin e një poezie. Kur vlerësohet si thelbësor, përderisa qëllimi i përkthyesit është përcjellja sa të jetë e mundur e mesazhit të tekstit në Gjuhën Burimore, përkthyesit do t’i duhet të përcjellë ato në Gjuhën Përkthimore nëpërmjet simbolizmit tingullor të Gjuhës Përkthimore. Pa dyshim, simbolizmi tingullor do të jetë i ndryshëm nga ai i Gjuhës Burimore. Përkthyesi poet ka mundësi të kompensojë humbjen e tipareve fonike, domethënë, zanore, të Gjuhës Burimore, duke i zëvendësuar ato me tiparet fonike, domethënë, zanore të Gjuhës Përkthimore, të cilat kanë efekt të krahasueshëm. Zakonisht, kjo shkakton humbje nga pikëpamja e kuptimit denotativ dhe konotativ.

Si përfundim mund të thuhet se përkthimi është çështje zgjedhjeje, por kjo zgjedhje është gjithnjë e motivuar: heqjet, shtesat dhe ndryshimet janë të justifikuara në lidhje me kuptimin e synuar. Pra, përkthimi mund të quhet rrjedhojë e zgjedhjeve të motivuara. Kjo duket më se qartë në punën e përkthyesve të poezive. Kështu, së pari, kur një përkthyes vendos të përkthejë një poezi, ai fillimisht zgjedh formën poetike të Gjuhës Përkthimore, domethënë, sonetin, baladën, strofën vargun e bardhë, etj., sa më të përafërt që të jetë e mundur me atë të Gjuhës Burimore. Modeli mund të zëvendësohet nga një tjetër që është më i përshtatshëm me Gjuhën Përkthimore. Së dyti, përkthyesit do t’i duhet të përcjellë ritmin e Gjuhës Burimore në atë të Gjuhës Përkthimore në mënyrë të tillë që të sigurojë prodhimin e të njëjtit efekt kur të lexohet nga lexuesi i Gjuhës Përkthimore. Së treti, kuptimi duhet të përcillet në mënyrë krijuese dhe të saktë në Gjuhën Përkthimore. Së katërti, përkthyesi duhet të riprodhojë figurat letrare, domethënë, imazhe konkrete, ku përfshihen metaforat dhe krahasimet, si dhe tiparet fonike, domethënë, zanore, të tilla si aliteracion dhe asonanca.

Është e qartë se nuk ka përkthim të përkryer, ideal ose të saktë. Gjëja e parë që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të përkthimeve të poezisë është qëllimi i përkthimit, në mënyrë që të mund të gjykohet, duke e ballafaquar atë me objektivat.

Kreu i katërt

4.1 Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar (*The Old Man and the Sea* versus *Plaku dhe deti*)

4.1.1 Ernest Heminguei: Jeta dhe vepra (1899-1961)

Ernest Heminguei është fituesi i Çmimit Nobel për Letërsinë më 1954 me motivacionin: “Për mjeshtërinë e tij të artit të rrëfimit, të dëshmuar më së fundi në veprën *Plaku dhe deti*, si dhe për ndikimin që ai ka ushtruar në stilin bashkëkohor”.

I lindur në Ouk Park të Illinoisit, ai e filloi karrierën e vet si shkrimtar në një redaksi gazete në Kenzës Siti në moshën 17 vjeçare. Pas hyrjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Luftë, ai, vullnetarisht, u bashkua me një njësi ambulancash të Ushtrisë Italiane. Gjatë shërbimit në front, ai u plagos, u dekorua nga Qeveria Italiane, dhe kaloi shumë kohë nëpër spitale. Pas kthimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ai u bë reporter për gazetatat kanadeze dhe amerikane dhe, mjaft shpejt, u dërgua përsëri në Evropë, për të mbuluar ngjarje të tilla si Revolucioni Grek.

Në vitet 1920, Heminguei u bë anëtar i grupit të amerikanë të dëbuar nga atdheu në Paris, të cilin e përshkroi në veprën e tij të parë të rëndësishme *Lamtumirë armë* (*A Farewell to Arms*, 1929), e cila shtjellon zhgënjimin e një oficeri amerikan ambulance nga lufta dhe rolin e tij si dezertor. Heminguei i shfrytëzoi përvojat e veta të reporterit gjatë Luftës Civile në Spanjë, si sfond për romanin e tij më ambicioz *Për kë bie kambana* (*For Whom the Bell Tolls*, 1940). Mes veprave të tij të mëvonshme, shquhet romani i shkurtër *Plaku dhe deti* (*The Old Man and the Sea*, 1952), ku rrëfëhet historia e udhëtimit të një peshkatari, lufta e tij e gjatë dhe vetmitare me peshkun dhe detin, si dhe ngadhënjimi i tij mbi disfatën.

Hemingueit, këtij sportisti të madh, i pëlqente të portretizonte ushtarë, gjuetarë, toreadorë, njerëz të ashpër, herë-herë primitivë, guximi dhe ndershmëria e të cilëve vihen përballë sjelljeve brutale të shoqërisë moderne dhe që, gjatë kësaj përpallje, humbasin shpresën dhe besimin. Proza e tij e drejtpërdrejtë, dialogu i tij i kursyer, si dhe rendja e tij pas nënkuptimeve, janë veçanërisht efikase në tregimet e tij të shkurtra, disa prej të cilave janë përmbledhur në vëllimet *Burra pa gra* (*Men Without Women*, 1927) dhe *Kolona e pestë dhe dyzetentë tregimet e para* (*The Fifth Column and the First Forty-Nine Stories*, 1938).

Heminguei, një nga romancierët, tregimtarët dhe eseistët më të famshëm amerikanë, stili i prozës së të cilit, duke qenë i thjeshtë gjer në mashtim, ka ushtruar ndikim të gjerë te një varg i madh shkrimtarësh.

“S’ka pikë dyshimi se nuk ka gjueti si gjuetia e njeriut, por ata që kanë gjuajtur njerëz të armatosur për një kohë të gjatë, gjë që edhe u ka pëlqyer, pas kësaj, në të vërtetë, nuk u hyn më në sy asgjë tjetër. I takon duke bërë gjëra të ndryshme, por interesi tyre pushon së qeni, sepse, pas gjësë tjetër, shtrihet jeta monotone, si

shija e verës, kur sythet e shijes t'i kanë hequr nga gjuha, duke t'i bërë shkrumb e hi.”

(Nga “Në ujin e kaltër” – “On the Blue Water” te vepra *Shqytari – Esquire*, Prill 1936)

Marrëdhëniet dashurore të Hemingueit me një infermiere amerikane, Anjeza von Kurovskin, gjatë shtrimit në spital për të marrë veten, krijuan bazën për shkrimin e romanit *Lamtumirë armë (A Farewell To Arms)*, 1929). Kjo histori tragjike dashurie u bë film për herë të parë më 1932, ku luajtën aktorë e aktore të tilla si Geri Kuper, Helena Heis dhe Adolf Menjū. Në variantin e dytë të vitit 1957, me skenar të Ben Hektit dhe regji të Çarls Vidorit, rolet kryesore i luajtën Rok Hjudsoni dhe Xhenifer Khonsi. Dështimi i tij bëri që David O. Selzniku të mos prodhonte më filma të tjerë.

Pas luftës, Heminguei punoi për pak kohë si gazetar në Çikago. Ai u shpërngul në Paris më 1921, ku shkroi artikuj për gazetën *Toronto Star*.

“Nëse ke pasur fatin ta kalosh rininë në Paris, atëherë, kudo që të shkosh gjatë pjesës tjetër të jetës, ai qëndron me ty, sepse Parisi është një festë e lëvizshme.”

(Nga *Një festë e lëvizshme – A Moveable Feast*, 1964)

Në Evropë, pra, në qendrën e lëvizjes moderniste, Heminguei u shoqërua me shkrimtarë të tillë si Gertruda Shtajn dhe F. Skot Fixheraldi, i cili ia redaktoi disa tekste dhe u bë agjenti i tij letrar. Më vonë, Heminguei e përshkroi Fixheraldin në *Një festë e lëvizshme*, por më me pak dashamirësi. Megjithatë, Fixheraldit i erdhi keq për humbjen e kësaj miqësie. Për Gertruda Shtajnin, Heminguei i shkruante Maksuell Perkinsit, redaktorit të tij, se:

“Ajo i humbi të gjitha ndjesitë e shijes kur kaloi në menopauzë. Ishte vërtetë ngjarje e jashtëzakonshme. Papritur, ajo shfaqti paaftësinë për të dalluar një pikturë të bukur nga një pikturë e shëmtuar, një shkrimtar të mirë nga një shkrimtar i keq, u menderos çdo gjë.”

(Nga *E vetmja gjë që ka rëndësi – The Only Thing That Counts*, 1966)

Gjatë kohës që nuk shkruante për gazetën, as për veten e tij, Heminguei udhëtoi me të shoqen, Elizabeta Hadli Riçardsonin, nëpër Francë, Zvicër dhe Itali. Më 1922, ai shkoi në Greqi dhe Turqi, për të raportuar mbi luftën ndërmjet këtyre dy vendeve. Më 1923, Heminguei bëri dy udhëtime në Spanjë; të dytin e bëri për të parë ndeshjet me dema në festivalin vjetor të Pamplonës.

Librat e parë të Hemingueit, *Tre tregime dhe dhjetë poezi (Three Stories and Ten Poems)*, 1923), për të cilin nuk mori asnjë honorar, dhe *Në kohën tonë (In Our Time)*, 1924), u botuan në Paris. *Rrëketë e pranverës (The Torrents of Spring)* dhe romani i parë serioz i Hemingueit *Edhe dielli lind (The Sun Also Rises)* dolën në qarkullim më 1926. Historia e rrëfyer nga një gazetar amerikan merret me një grup të dëbuarish nga atdheu, të cilët jetojnë në Francë dhe Spanjë dhe janë anëtarë të zhgënjyer nga jeta e Brezit të Humbur të pas-Luftës së Parë Botërore. Personazhet kryesore janë Leidi Bet Eshli dhe Xheik Barnsi. Ledi Bret bie në dashuri me Xhejkun, i cili është plagosur në

luftë dhe nuk mund t'ia përmbushë nevojat. Edhe pse Heminguei asnjëherë nuk dha hollësi për dëmtimin e Xhejkut, lexuesi arrin të kuptojë se ai ka humbur testikujt, po jo penisin. Xheku dhe Breti dhe grupi i çuditshëm i miqve të tyre ndërmarrin aventura të ndryshme nëpër Evropë, në Madrid, Paris dhe Pampalona. Gjatë orvatjeve për të përballuar dëshpërimin, ata bien pre e alkoolit, e dhunës dhe e seksit. Ashtu si Xhejku, edhe Heminguei ishte plagosur në Luftën e Parë Botërore; të dy janë të dhënë pas ndeshjeve me dema:

- Oh, Xhejk, - tha Breti, - së bashku mund t'ia kishim kaluar për mrekulli.

(Nga *Edhe dielli lind – The Sun Also Rises*, 1962)

Heminguei e shkroi dhe rishkroi këtë roman në pjesë të ndryshme të Spanjës dhe të Francës ndërmjet viteve 1924 dhe 1926. Ai i solli suksesin e parë të madh. Megjithëse gjuha e Hemingueit është e thjeshtë, ai ka përdorur nënkuptime dhe shmangie, të cilat e bëjnë tekstin shumë rrafshësh dhe të pasur në aluzione.

Pas botimit të veprës *Bura pa gra (Men Without Women)*, 1927), Heminguei u kthye në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për t'u vendosur në Ki Uest të Floridës. Heminguei dhe Hadlli u ndanë më 1927. Në të njëjtin vit, Heminguei u martua me Paulina Pfajjferin, botuesen e pasur të organeve që mbullonin modën. Në Florida, ai shkroi romanin *Lamtumirë armë (A Farewell to Arms)*, i cili u botua më 1929. Vendi i zhvillimit të ngjarjeve është fronti italian në Luftën e Parë Botërore, ku dy të dashuruar arrijnë të gjejnë disa çaste të shkurtra lumturie. Romani korri sukses të jashtëzakonshëm në rrafshin e kritikës letrare dhe në rrafshin tregtar njëherësh.

Në vitet 1930, Heminguei shkroi vepra madhore të tilla si *Vdekje në mesditë (Death In The Afternoon)*, 1932), rrëfim për ndeshjet me demat në Spanjë, dhe *Kodrinat e blerta të Afrikës (The Green Hill Of Africa)*, 1935), histori për një ekspeditë gjuetie në Afrikën Lindore. “Gjithë letërsia moderne amerikane buron nga libri i Mark Tuenit, që quhet *Hakëllberri Fini*”, është ndoshta vargu më i cituar në këtë rrëfim. *Të kesh dhe të mos kesh (To Have And Have Not)*, 1937) u bë film nga regjisori Houard Houks. Ata kishin zënë miqësi me njëri-tjetrin në fund të viteve 1930. Houksi, gjithashtu, kishte qejf të dilte për gjah, të peshkonte dhe të pinte, dhe autori shkoi me të shoqen e Houksit, Slimën, i cili më vonë tha:

“Midis nesh lindi një tërheqje e menjëhershme dhe e ngutshme, e pashpallur, por shumë, shumë e fuqishme”.

Sipas një historie, Houksi i kishte thënë Hemingueit se mund të bënte “një film nga vepra më e keqe që kishte shkruar ndonjëherë”. Autori pyeti: - Cila është gjëja më e keqe që kam shkruar ndonjëherë? - kurse Houksi u përgjigj: - Ajo pjesa kotnasikoti që quhet *Të kesh dhe të mos kesh*”. – Kisha nevojë për para, - tha Heminguei. Skenarin e filmit e shkruan Xhuls Fërthmani dhe Uilliam Folkneri.

“Dhe pastaj i shkoi mendja se do të vdiste. Ky mendim vërshoi në kokën e tij, nuk ishte vërshim uji, as vërshim ere; ishte vërshimi i papritur i zbrazëtisë që buron nga nuhatja e së ligës, por çudia më e madhe ishte se hiena lëvizte vjedhurazi, lehtë-lehtë, përgjatë zgripit të saj.”

(Nga *Borërat e Kilomanxharës – The Snows of Kilimanjaro*, 1952)

Uollis Stivensi e quajti një herë Heminguein “më të rëndësishmin e poetëve të gjallë, për sa i përket çështjes së realitetit të jashtëzakonshëm”. Përmes fjalës “poet”, Stivensi u referohej arritjeve stilistikore të autorit në prozën e shkurtër. Ashtu si Gertruda Shtain, Heminguei zbatoi teknikat e poezisë moderne në shkrimet e veta, siç është përdorimi mjeshtëror i përsëritjes, megjithëse në një masë më të vogël se Shtaini. “Teoria e ajsbergut” e Hemingueit, e cila citohet më së shumti, shpjegohet kështu:

Nëse shkrimtari e di mirë se për çfarë është duke shkruar, atëherë ai mund të shmangë gjërat që di, dhe lexuesi do të arrijë t’i përjetojë këto gjëra njëloj sikur t’i kishte shprehur shkrimtari.

Një nga tregimet e shkurtra më të antologjizuara të Hemingueit është “Borërat e Kilimanxharos”, i cili u botua për herë të parë në *Esquire* në gusht të vitit 1936. Ajo fillon me një epitaf që thotë se maja perëndimore e malit quhet Shtëpia e Zotit të Lum dhe, ngjitur me të, u zbulua kërma e një leopardi. Poshtë në savanë, shkrimtari i dështuar Herri është duke vdekur nga gangrena që e zuri në një kamp gjuetie.

“Kishte dashuruar së tepërmi, kishte kërkuar së tepërmi, dhe të gjitha këto i hodhi në letër.”

(Nga *Borërat e Kilomanxharës – The Snows of Kilimanjaro*, 1952)

Pikërisht para se sa të mbyllë sytë, Herri sheh një vegim sikur e kanë ngjitur lart, për të parë majën e Kilimanxharos, nga një avion shpëtimi – “e madhërishme, e lartë dhe pabesueshmërisht e bardhë nën shkëlqimin e diellit”. Në variantin filmik të këtij tregimi, me regjisor Henri Kingun, Herri nuk vdes. Nik Adamsi, personazhi autobiografik i Hemingueit para Luftës së Dytë Botërore, paraqitet në tre përmbledhje, *Në kohën tonë*, *Burra pa gra* dhe *Fitimtari nuk merr asgjë* (*Winner Take Nothing*, 1933).

Më 1937, Heminguei ndoqi nga afër Luftën Civile në Spanjë. Si shumë shkrimtarë të tjerë, ai mbajti anën e qeverisë së krijuar asokohe. Në Madrid, ai u takua me Marta Gellhornin, shkrimtare dhe korrespondente lufte, e cila u bë gruaja e tretë e tij më 1940. Vitet e para të martesës së tij ishin të lumtura, por ai shpejt e kuptoi se Gellhorni nuk ishte amvisë, por gazetare me ambicie të mëdha. Gellhorni i e quajti Heminguein “Shokun e vet mosdashës”. Asaj ia kishte ëndja fort të udhëtonte dhe “të maste pulsin e kombit” ose të botës.

Ai u kthye përsëri në Spanjë me romanin e tij *Për kë bie kambanat* (1940). Ai ia kushtoi librin Gellhornit – Maria, e cila në këtë rrëfim, është ndërtuar pjesërisht sipas këtij modeli. “Flokët e saj ishin vetulla e artë e një fushe me misër”, shkruante Heminguei për heroinën e tij. Kjo histori mbulonte vetëm pak ditë dhe merrej me hedhjen në erë të një ure nga një grup i vogël partizanësh. Kur heroina në romanin *Lamtumirë armë* vdes në fund të rrëfimit, pasi ka lindur një fëmijë të vdekur, tani e ka radhën heroi, Robert Xhordani, për të flijuar jetën. Tema e ardhjes së vdekjes ishte, gjithashtu, qendrore në romanin *Përgjatë lumit drejt e në mes të pemëve* (*Across the River and Into the Trees*, 1950).

Përveç pjesëmarrjes në ekspedita gjuetie në Afrikë dhe Vaioming, Heminguei u dha shumë edhe pas peshkimit në thellësi të mëdha të ujërave matanë brigjeve të Ki Uestit, Brahamsit dhe Kubës. Ai, gjithashtu, e armatosi varkën e tij të gjuetisë, *Pilar (Leshatake)*, dhe, së bashku me ekuipazhin e vet, vëzhgoi veprimet e nazistëve dhe të nëndetësve të tyre në atë hapësirë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Më 1940, Heminguei bleu një shtëpi jashtë Havanës në Kubë. Rrethinat e saj ishin parajsë e vërtetë për ushtrinë e maceve të tij të padisiplinuara.

Në fillim të vitit 1941, Gellhorni, së bashku me Heminguein, bënë një udhëtim të gjatë prej 30 000 miljesh për të shkuar në Kinë. Pikërisht para pushtimit të Normandisë më 1944, Heminguei arriti të shkonte në Londër, ku u vendos në Hotelin Dorchester. Para kësaj, ai kishte zëvendësuar Gellhornin si korrespondent kryesor i gazetës *Collier*. Ajo arriti dy javë më vonë dhe zuri dhomë më vete. Heminguei e ndoqi zbarkimin e forcave aleate, duke qëndruar nën shkëmbinjtë e Normandisë; Gellhorni u bashkua me trupat në breg. Kur u kthye në Paris pas shumë vitesh, Heminguei, shumicën e kohës e kaloi në Hotelin Ric. Ndarja e Hemingueit me Gellhornin më 1945 ishte e hidhur. Më vonë Gellhorniu shpreh se meqenëse “kishte jetuar me një mitomaniak, e dinte se ata besojnë në çdo gjë që thonë, nuk janë gënjeshtarë të vetëdijshëm, shpikin për të stërmadhuar çdo gjë që lidhet me ta dhe jetën e tyre dhe e besojnë një gjë të tillë”. Më 1946, Heminguei u kthye në Kubë. Pas braktisjes nga Gellhorni, ai u martua me Meri Uerlshin, korrespondenten e revistës *Time*, të cilën e kishte takuar në një restorant të Londrës më 1944.

Heminguei kishte filluar të pinte që kur ishte reporter, dhe arrinte të mbante sasi të mëdha alkooli. Për shumë kohë, alkooli nuk ndikoi në cilësinë e krijimtarisë së tij. Në fund të viteve 1940, ai filloi të dëgjoji zëra brenda kokës së vet, ishte mbi peshë, tensionin e kishte të lartë, dhe shfaqte shenja të qarta të ceroxës në mëlçi. Shpërfilljen ndaj rreziqeve që mbartte alkooli Heminguei e zbuloi kur e mësoi të birin 12 vjeçar, Patrikun, të pinte. E njëjta gjë ndodhi edhe me vëllezërit e tij. Patriku, më vonë gjatë jetës, pati probleme me alkoolin. Gregori, i cili ishte transvestit, u dha pas drogës dhe ai vdiq në moshën 69 vjeçare në një burg grash në Florida.

Përgjatë lumit drejt e në mes të pemëve, romani i parë i Hemingueit brenda një dekade, u prit keq, por tregimi alegorik prej 27 000 fjalësh *Plaku dhe deti*, i botuar fillimisht në revistën *Life* më 1952, ia ktheu përsëri famën. Protagonisti është një peshkatar plak nga Kuba, që quhet Santiago, dhe, më në fund, pas javësh të mbushura me zhgënjime, arrin të kapë një marlin gjigant. Teksa kthehet në liman, peshkaqenët ia hanë peshkun e lidhur për varkë. Modeli për portretizimin e Santiagos ishte peshkatarin kubanez, Gregorio Fuentes, i cili vdiq në janar të vitit 2002, në moshën 104 vjeçare. Fuentesi kishte shërbyer si kapiten i barkës së Hemingueit, *Pilar*, në fund të viteve 1930, dhe ndonjëherë i shërbente edhe si shitës. Heminguei, gjithashtu, bëri një udhëtim për gjueti peshku në Peru, pjesërisht për të xhiruar pjesë për një variant filmi të veprës së tij *Plaku dhe deti*.

Më 1959, Heminguei vizitoi Spanjën, ku u takua me toreadorin e famshëm Luis Migel Domenikuin në një spital. Një dem i kishte shqyer me brirë ijët Domenikuinit. “Pse drejtin u dashka të vdesin të mirët dhe trimat para kujt do tjetër?” tha ai. Mirëpo, Dominkuini nuk vdiq. Heminguei planifikoi të shkruante një libër tjetër për ndeshjet

me dema, por, në vend të kësaj, botoi veprën *Një festë e lëvizshme*, kujtimet e tij të viteve 1920 në Paris.

Shumicën e kohës, Heminguei e kaloi në Kubë deri sa ndodhi Revolucioni i Fidel Kastros më 1959. Ai e mbështeti Kastron, por kur jetesa u vështirësua së tepërmi, ai u shpërngul në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjatë vizitës së tij në Afrikë më 1954, Heminguei pësoi dy aksidente ajrore dhe u shtrua në spital. Në të njëjtin vit, ai filloi të shkruante veprën *I vërtetë sapo lind drita* (*True at First Light*), që mbetet libri i fundit i tij i plotë. Disa pjesë të tij u botuan në *Sports Illustrated* më 1972 nën titullin *Ditari afrikan* (*African Journal*).

Më 1960, Heminguei u shtrua në spital në Klinikën Majo në Roçester të Minesotas për t'u kuruar nga depresioni, dhe doli nga spitali më 1961. Gjatë kësaj kohe, ai iu nënshtrua terapisë me elektroshok për 2 muaj me radhë. Më 2 korrik 1951, Heminguei kreu vetëvrasje me pushkën e tij të dashur të gjahut në shtëpinë e vet në Ketçam të Aidëhous. Disa nga romanet e Hemingueit janë botuar pas vdekjes së tij. *I vërtetë sapo lind drita*, ku përshkruhet një ekspedite gjuetie në Kenia, doli në qarkullim në korrik të vitit 1999. Është një nga librat më të dobët të botuar nga ndonjë shkrimtar që ka fituar Çmimin Nobel.

4.1.2 Plaku dhe deti (1952): Përmbledhje e shkurtër

Në Kubë, peshkatari plak, i cili quhet Santjago, ka kaluar tetëdhjetekatër ditë pa zënë asnjë peshk. Ai është thatanik, i rraskapitur, me rrudha të thella në qafë, ndërkohë që në duar ka shenja të thella plagësh, të bëra nga litari kur ka tërhequr ndonjë peshk të madh. Këto plagë nuk janë të freskëta, por shumë të vjetra, të vjetra sa plasat e një shkretëtire pa një pike ujë.

Krahaso:

The old man was thin and gaunt with deep wrinkles in the back of his neck. The brown blotches of the benevolent skin cancer the sun brings from its reflection on the tropic sea were on his cheeks. The blotches ran well down the sides of his face and his hands had the deep-creased scars from handling heavy fish on the cords. But none of these scars were fresh. They were as old as erosions in a fishless desert.

Plaku ishte thatanik dhe i rraskapitur, me rrudha të thella në qafë. Në faqe kish njolla ngjyrë kafe kanceri të parrezikshëm të lëkurës, shkaktuar nga pasqyrimi i diellit mbi detin tropikal. Njollat zbrisnin nga faqet deri në qafë dhe në duar kishte shenja të thella plagësh, të bëra nga litari kur kishte tërhequr ndonjë peshk të madh. Por asnjë nga këto shenja s'ishte e freskët. Ato ishin aq të vjetra, sa plasat e një shkretëtire pa ujë.

(Shih faqet 9-10 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqet 17-18 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Megjithatë, mungesa e suksesit nuk e shkatërron shpirtin e Santiagos dhe këtë gjë e tregojnë sytë e tij gazmorë dhe të paepur.

Krahaso:

Everything about him was old except his eyes and they were the same color as the sea and were cheerful and undefeated.

Çdo gjë e kish të vjetër, përveç syve, dhe sytë e tij kishin po atë ngjyrë që kishte deti dhe ishin gazmorë dhe të paepur.

(Shih faqen 10 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 18 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ai ka një mik të vetëm, një djalë me emrin Manolin, i cili e ndihmon atë gjatë dyzet ditëve të para. Pas dyzet ditësh, prindërit e Manolinit arrijnë në përfundimin se plaku është i pafat dhe e urdhërojnë të birin për të zgjedhur një barkë tjetër peshkimi. Sidoqoftë, djali e ndihmon plakun që çdo ditë kthehet me kaiken e tij të zbrazët.

Krahaso:

In the first forty days a boy had been with him. But after forty days without a fish the boy's parents had told him that the old man was now definitely and finally *salao*, which is the worst form of unlucky, and the boy had gone at their orders in another boat which caught three good fish the first week. It made the boy sad to see the old man come in each day with his skiff empty and he always went down to help him carry either the coiled lines or the gaff and harpoon and the sail that was furled around the mast. The sail was patched with flour sacks and, furled, it looked like the flag of permanent defeat.

Dyzet ditët e para, me të shkonte edhe një djalë. Por, kur kaluan dyzet ditë pa kapur asnjë peshk, prindërit i thanë djalit se plaku ish bërë tani përfundimisht *salao*, që do të thotë më tersi ndër të pafatët, dhe e kishin urdhëruar djalin të shkonte në një barkë tjetër, e cila kapi tre peshq të mirë që javën e parë. Djali pikëllohej kur shihte plakun që kthehej çdo ditë me barkën bosh dhe zbriste gjithmonë në breg për ta ndihmuar të çonte në shtëpi veglat e peshkimit ose fuzhnjën dhe litarët dhe pëlhurën e mbështjellë pas direktut. Pëlhura ishte arnuar me copa thasësh dhe, ashtu e mbështjellë, dukej si një flamur disfatash të përhershme.

(Shih faqen 9 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 17 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagoja i thotë Manolinit se të nesërmen ai do të shkojë sa më larg që të jetë e mundur për të peshkuar.

Krahaso:

“Where are you going?” the boy asked.
“Far out to come in when the wind shifts. I want to be out before it is light.”

- Nga do të shkosh nesër? - pyeti djali.
- Sa më larg, dhe do të kthehem kur era të ndërrojë drejtim. Dua të dal në det pa gdhirë.

(Shih faqen 12 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 20 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ata mbledhin veglat e peshkimit nga kaikja e Santjagos dhe shkojnë në shtëpinë e këtij të fundit.

Krahaso:

They picked up the gear from the boat. The old man carried the mast on his shoulder and the boy carried the wooden boat with the coiled, hard-braided brown lines, the gaff and the harpoon with its shaft. The box with the baits was under the stern of the skiff along with the club that was used to subdue the big

fish when they were brought alongside. No one would steal from the old man but it was better to take the sail and the heavy lines home as the dew was bad for them and, though he was quite sure no local people would steal from him, the old man thought that a gaff and a harpoon were needless temptations to leave in a boat.

I nxorën veglat e peshkimit nga barka. Plaku mbante direkun mbi sup dhe djali mbante arkën e drunjtë me litarët dhe lëmshet e fillit të fortë ngjyrë kafe dhe fuzhnjën me gremçin. Arkën me karrema, bashkë me shkopin që përdorej për të trullësuar peshkun e madh kur e nxirrnin përbri barkës, e lanë nën këmbë në barkës. Asnjëri s'mund t'i vidhte gjërat e plakut, por ishte më mirë që pëlhurën dhe litarët e rëndë t'i çonte në shtëpi, sepse i dëmtonte vesa. Megjithëse ishte i sigurt, se asnjë nga njerëzit e këtushëm nuk do ta vidhte, plaku mendoi, se fuzhnja dhe gremçi mund të ishin një tundim i keq për mëkat, po t'i linte në barkë.

(Shih faqen 15 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqet 21-22 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Banesa e tij është shumë e thjeshtë me një shtrat, me një tryezë, me një karrige, të gjitha të vendosura në një fundshtrojë krejt të rëndomtë.

Krahaso:

The shack was made of the tough budshields of the royal palm which are called guano and in it there was a bed, a table, one chair, and a place on the dirt floor to cook with charcoal.

Kasollja ishte ndërtuar me degë palmash mbretërore që quhen *guano* dhe brenda kishte një shtrat, një tryezë, një karrige, dhe në fundshtrojnë prej balte, një vend për të gatuar me qymyr druri.

(Shih faqen 15 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 22 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ata të dy bisedojnë me njëri-tjetrin për një farë kohe, pastaj Manolini e lë vetëm Santjagon dhe shkon për të marrë ushqim.

Krahaso:

"I go now for the sardines," the boy said.

- Po shkoj tani për sardele, - tha djali.

(Shih faqen 18 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 24 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ndërkohë, Santjagon e zë gjumi. Kur Manolini kthehet, ai e zgjon Santiagon. Plaku dhe djali hanë ushqimin që ka sjellë djali.

Krahaso:

When the boy came back the old man was asleep in the chair and the sun was down.

Kur djali u kthye, plaku po flinte në karrige dhe dielli kishte perënduar.

(Shih faqen 18 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 24 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

“Wake up old man,” the boy said and put his hand on one of the old man's knees.

The old man opened his eyes and for a moment he was coming back from a long way away.

- Zgjohu, o plak, - tha djali, dhe tundi me dorë njërin gju të plakut. Plaku hapi sytë dhe për një çast ai po kthehej nga një vend i largët.

(Shih faqen 19 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 25 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Gjatë ngrënies së ushqimit, djali zbulon rrekat mes të cilave jeton plaku dhe vendos me vete t'i sjellë plakut këmishë, këpucë, xhaketë dhe batanije për dimrin që po afrohet. Manolini dhe Santjagoja bisedojnë pak kohë për bejsbollin, dhe pastaj djali ikën, që të zgjohet në mëngjes nga plaku. Santjago fle.

Krahaso:

I must have water here for him, the boy thought, and soap and a good towel. Why am I so thoughtless? I must get him another shirt and a jacket for the winter and some sort of shoes and another blanket. “Tell me about the baseball,” - the boy asked him.

Mund të kisha sjellë ujë për të, sapun dhe një peshqir të mirë. Pse jam kaq i pavëmendshëm? Unë duhej t'i gjeja një këmishë tjetër dhe një xhaketë për dimër, ndonjë palë këpucë dhe një batanije tjetër. - Tregomë për bejsbollin, - iu lut djali.

(Shih faqen 21 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 26 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

The boy went out. They had eaten with no light on the table and the old man took off his trousers and went to bed in the dark. He rolled his trousers up to make a pillow, putting the newspaper inside them. He rolled himself in the

blanket and slept on the other old newspapers that covered the springs of the bed.

Djali iku. Ata kishin ngrënë pa e ndezur llambën në tryezë, dhe plaku i hoqi pantallonat dhe shkoi në shtrat në errësirë. Ai i mbështolli pantallonat dhe i bëri si jastëk, duke futur dhe gazetën në mes. U mbështoll me batanije dhe u shtri mbi gazetat e tjera të vjetra që kish shtruar mbi sustat e zhveshura të krevatit.

(Shih faqen 24 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqet 28-29 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagoja sheh në ëndërr Afrikën e djalërisë së tij. Ai jeton tani duke u endur pëgjatë atyre brigjeve dhe dëgjon zhurmën e erës mbi det dhe shikon barkat e vendasve që çajnë përmes tij. Ai shikon në ëndrra vetëm vise dhe luanë nëpër plazhe.

Krahaso:

He was asleep in a short time and he dreamed of Africa when he was a boy and the long golden beaches and the white beaches, so white they hurt your eyes, and the high capes and the great brown mountains. He lived along that coast now every night and in his dreams he heard the surf roar and saw the native boats come riding through it. He smelled the tar and oakum of the deck as he slept and he smelled the smell of Africa that the land breeze brought at morning.

He only dreamed of places now and of the lions on the beach.

Gjumi e zuri shpejt, dhe në ëndërr pa Afrikën e djalërisë së tij dhe plazhet e arta të gjata dhe rërat e bardha, aq të bardha sa të dhembnin sytë, dhe shkëmbinj të lartë dhe malet e mëdha ngjyrë kafe. Ai jetonte tani gjatë atyre brigjeve çdo natë, dhe në ëndrrat e tij dëgjonte zhurmën e erës mbi det dhe shikonte barkat e indigjenëve që çanin përmes tij. Në gjumë nuhaste erën e rrëshirës dhe të dushkut të kuvertës, dhe ndiente erën e Afrikës, që e sillte mëngjeseve fladi i bregdetit.

Tani shikonte në ëndrra vetëm vise dhe luanë nëpër plazhet.

(Shih faqet 24-25 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 28 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plaku zgjohet dhe e merr djalin nga shtëpia e tij. Të dy i marrin pajimet peshkimit të plakut nga kasollja dhe i çojnë në kaikë dhe shijojnë kafënë në një lokal që hapet herët, ku u shërbehet peshkatarve. Djali largohet për të marrë sardelet për plakun. Kur kthehet, ai i uron fat plakut, dhe Santjagoja del në det herët në mëngjes, para lindjes së diellit.

Krahaso:

The old man knew he was going far out and he left the smell of the land behind and rowed out into the clean early morning smell of the ocean.

Plaku kish vendosur të shkonte larg, la prapa aromën e tokës dhe po voziste tutje nëpër aromën e freskët mëngjesore të oqeanit.

(Shih faqen 28 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqet 32 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Shumë shpejt Santjagoja shquan peshq fluturues dhe zogj dhe shpreh keqardhje të madhe për këta të fundit.

Krahaso:

Why did they make birds so delicate and fine as those sea swallows when the ocean can be so cruel? She is kind and very beautiful.

Pse vallë zogjtë janë krijuar kaq të brishtë, si këto dallëndyshe deti, kurse oqeani nganjëherë bëhet aq i egër? Ai është i mirë dhe shumë i bukur.

(Shih faqen 29 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 32 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagoja vazhdon duke lundruar, kalon vendin ku kohët e fundit ka qenë i pasuksesshëm. Santjagoja sheh një shpend grabitqar lart dhe vë re se zogu ka pikasur diçka në ujë. Plaku vijon të lundrojë pranë zogut dhe lëshon litarin e tij në atë zonë, duke shpresuar që të kapë peshkun që zogu ka parë. Sheh një tufë të madhe delfinësh që udhëtojnë shpejt, shumë shpejt. Santjagoja vazhdon me shpresën se mos kap të “humburin” ose ndoshta edhe se mos zbulon ndonjë peshk shpatë duke ndjekur tufën. Ai zë një tunë të vogël pas pak kohe dhe pastaj ndien një tundje në një nga grepat e tij të zhytur në thellësi. Kafshimi i parë është i fortë dhe shkopi me të cilin lidhet grepi tendoset ndjeshëm. Tërheqja tjetër është më e kujdesshme, por Santjagoja e di me saktësi se çfarë ka ndodhur.

Krahaso:

One hundred fathoms down a marlin was eating the sardines that covered the point and the shank of the hook where the hand-forged hook projected from the head of the small tuna.

Dyqind metra thellë, marlina po hante sardelet që mbulonin majën dhe pjesën e përkulur të grepit, atje ku grepi i punuar me dorë kishte shpuar kokat e tunave të vogla.

(Shih faqen 41 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 42 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Duke marrë zemër nga një kafshim në një thellësi aq të madhe në Gjirin Persik, Santjagoja mendon se peshqit duhet të jenë shumë të mëdhenj. Peshku shpatë nuk i ndahet grepit, por nuk e kafshon karremin plotësisht. Santjagoja flet me zë të lartë, sikur të donte t'i joshte peshqit për të pranuar karremin.

Krahaso:

“Come on,” the old man said aloud. “Make another turn. Just smell them. Aren’t they lovely? Eat them good now and then there is the tuna. Hard and cold and lovely. Don’t be shy, fish. Eat them.”

- Eja, - tha plaku me zë të lartë. - Kthehu dhe një herë. Merru erë. A nuk janë të shijshme? Haji një here ato mirë e mirë, se pastaj ke dhe tunat. Janë të forta, të freskëta dhe të shijshme. Mos ki turp o peshk. Haji.

(Shih faqen 42 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 43 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Pas shumë kafshimeve të rreme, peshku shpatë përfundimisht kafshon tunën e vogël dhe tërheq një gjatësi të madhe të litarit. Santjagoja pret derisa peshku shpatë të gëlltisë grepin dhe pastaj tërheq shumë litarin për të nxjerrë peshkun shpatë në sipërfaqe. Peshku është i fuqishëm dhe nuk del. Në vend të kësaj, përkundrazi, ai noton larg, duke tërhequr plakun bashkë me kaiken e tij. Santjagoja dëshiron që të ketë Manolinin me vete për ta ndihmuar. Teksa perëndon dielli, peshku shpatë vazhdon në të njëjtin drejtim, dhe Santjagoja nuk sheh më tokë me sy. Ai është njeri i vendosur, prandaj e sfidon peshkun shpatë me zë të lartë.

Krahaso:

“Fish,” he said softly, aloud, “I’ll stay with you until I am dead.”

- Peshk, - i tha me zë të ulët, - unë nuk ndahem nga ty gjersa të jem gjallë.

(Shih faqen 52 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 51 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plakut vetëm sa i shtohet vendosmëria, megjithatë druhet se mos peshku shpatë, duke dashur të përfundojë luftën sa më shpejt që të jetë e mundur, do të bëjë shumë kërcime dhe, rrjedhimisht, grepi mund të zhvendoset nga goja e tij.

Krahaso:

“Fish,” he said, “I love you and respect you very much. But I will kill you dead before this day ends.”

- Peshk, - i tha plaku. - Unë të dua dhe të nderoj shumë. Por do të të vras për vdekje para se të ngryset kjo ditë.

(Shih faqen 54 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 53 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Një zog i vogël vjen në drejtim të kaikes nga veriu. Ai fluturon shumë ulët mbi det dhe është shumë i lodhur. Zogu ulet te kipi i kaikes dhe çlodhet atje. Pastaj sillet rrotull mbi kokën e plakut dhe ulet të pushojë mbi litar ku ndihet më mirë. Santjagoja fillon të flasë me zogun. Ndërkaq, peshku shpatë mësyn përpara, e tërheq plakun poshtë, dhe litari ia pret dorën. Duke futur dorën në ujë për ta pastruar, Santjagoja vë re se peshku shpatë ka ngadalësuar lëvizjen. Ai vendos të hajë një tunë që ka kapur për të marrë force, që të vazhdojë më tej. Plaku e ndien tërheqjen e vazhdueshme dhe të fortë të litarit dhe dora e majtë i është mpirë. Ajo mban shtrënguar litarin e rëndë, por Santjagoja e vështron me neveri.

Krahaso:

“What kind of a hand is that,” he said. “Cramp then if you want. Make yourself into a claw. It will do you no good.”

- Ç'dorë është kjo kështu? - tha. - Mpihu, në qoftë se të pëlqen. Bëhu po deshe këmbë zogu. S'do të dalë mirë kjo gjë.

(Shih faqen 58 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 56 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plaku ha tunën me qëllim që t'i ripërtërihen forcat dhe t'i shpihet dora. Vetëm atëherë, peshku shpatë del mbi sipërfaqen e ujit me shpejtësi dhe kridhet përsëri brenda thellë në ujë. Santjagoja habitet nga madhësia e tij, është dy metra më i gjatë se sa kaikja e tij. Plaku e kupton se, po të dojë, peshku shpatë mund të shkatërrojë kaiken. Prandaj, Santjagoja lutet për të zbutur zemrën e tij të shqetësuar dhe vihet në ndjekje peshkut edhe një herë tjetër.

Krahaso:

He is a great fish and I must convince him, he thought. I must never let him learn his strength nor what he could do if he made his run. If I were him I would put in everything now and go until something broke. But, thank God, they are not as intelligent as we who kill them; although they are more noble and more able.

Ai është peshk i madh, mendoi plaku, dhe unë duhet ta bind se jam i fortë. S'duhet ta lë asnjëherë që ai të kuptojë se ç'forcë ka ose të kuptojë se ç'mund të më bëjë mua po të fillojë vrapin. Po të isha unë në vend të tij, do ta provoja një herë fatiirduke u vërsulur përpara, derisa diçka të këputej. Por lavdi Zotit që peshqit nuk janë aq të mençur sa ne që i vrasim, megjithëse ata janë më fisnikë dhe më të shkathët.

(Shih faqen 63 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 60 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Me të perënduar dielli, Santjagoja mendon përsëri për të kaluarën e vet triumfuese, në mënyrë që të mbushet me më shumë besim në të tashmen. Santjagoja kujton një ndeshje të madhe të mundjes me krah që kishte zhvilluar njëherë në një tavernë të Kazablankës. Ajo kishte zgjatur një ditë dhe një natë të plotë, por Santjagoja, *El Campeon (Kampioni)*, siç e thërrisnin asokohe, e fitoi përfundimisht ndeshjen.

Krahaso:

He decided that he could beat anyone if he wanted to badly enough and he decided that it was bad for his right hand for fishing. He had tried a few practice matches with his left hand. But his left hand had always been a traitor and would not do what he called on it to do and he did not trust it.

Ai e kuptoi, se po të donte mund të mundte çdo njeri dhe madje ta mundte keq, dhe kuptoi se këto mundje i dëmtonin dorën e djathtë, që i duhej për peshkim. Kishte provuar disa herë të mundej me dorën e majtë. Por dora e tij e majtë i dilte e pabesë dhe nuk bënte atë që donte ai, dhe ai nuk kish besim tek ajo.

(Shih faqet 70-71 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 65 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Duke kujtuar lodhjen e tij, Santjagoja kupton se i duhet të flejë pak nëse do që të vrasë peshkun shpatë. Ai pret në feta delfinin që ka kapur për të parandaluar prishjen dhe ha një pjesë të tij para se të zbulojë një mënyrë për të fjetur. Santjagoja lidh litarin rreth vetes dhe përkulet mbi harkun për të ankoruar veten, duke lënë dorën e tij të majtë në litar për ta zgjuar atë nëse peshku shpatë ikën. Shumë shpejt plakun e zë gjumi, dhe ai fillon të shikojë në ëndërr sikur është në fshat, në shtratin e tij, atje ku po fryn veriu dhe bën shumë ftohtë, pastaj zhvendoset në një plazh të gjatë të Afrikës që po mbushet me luanët e rinisë së tij.

Santjagoja zgjohet nga litarit që rrëshqet furishëm përmes dorës së tij të djathtë. Peshku shpatë hidhet përpjetë, duke çarë ujët dhe duke ngritur stërkala mbi oqean, dhe pastaj bie përsëri rëndë në ujë. Pastaj ai kërcen përsëri dhe barka lëviz shpejt, megjithëse filli ende çmbështillet dhe plaku po e mban aq fort, saqë gati po e këput dhe disa herë e lëshon, por përsëri e mban të tendosur në kulm. Plaku zvarritet nga peshku shpatë gjer te bashi i barkës dhe fytyra i ngjeshet pas një cope të makrelit dhe s'mund të lëviz, dëgjon sesi çahet oqeani dhe sesi bën zhurmë ujët kur peshku bie rëndë në të. Dhe e vetmja gjë që Santjagoja mund të bëjë është mbajtja në litar, i cili po pret dorën e tij keq dhe po e tërheq atë poshtë në fund të kaikes. Megjithatë, Santjagoja gjen ekuilibrin dhe e kupton se peshku shpatë i ka mbushur filluskat me ajër, dhe nuk mund të zbresë poshtë dhe të vdesë atje, nga ku unë ai s'mund ta nxjerrë dot, kështu që së shpejti do fillojë të sillet rrotull dhe ahëre plaku duhet të nisë nga puna.

Përpara lindjes së diellit, peshku shpatë fillon ecjen drejt lindjes, gjë që do të thotë se ai është kapitur dhe po shkon pas rrymës. Santjagoja mban litarin fort, duke e tërhequr atë ngadalë ndërsa peshku shpatë vazhdon të bëjë rrethrotullime. Në rrethrotullimin e tretë, Santjagoja sheh peshkun shpatë dhe habitet nga madhësia e tij. Ai përgatit

fuzhnjën dhe tërheq litarin më shumë. Peshku shpate përpiqet me dëshpërim për t'u larguar. Santjagoja, që nuk mund të flasë për shkak të mungesës së ujit, thjesht mendon me vete.

Krahaso:

You are killing me, fish, the old man thought. But you have a right to. Never have I seen a greater, or more beautiful, or a calmer or more noble thing than you, brother. Come on and kill me. I do not care who kills who.

Peshk, ti po më merr në qafë, mendoi plak. Por ti e ke gjithashtu këtë të drejtë. Kurrë nuk kam parë në jetë gjë më të madhërishtme, më të bukur, më të qetë dhe më fisnike se ti, vëlla. Eja dhe vramë. Mua aq më bën kush nga ne do ta vrasë shoku-shokun.

(Shih faqen 92 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 83 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ky peshk shpatë vazhdon të bëjë rrethrotullime, të afrohet dhe të tërhiqet. Më në fund, ai është pranë barkës, dhe Santjagoja e shpon me fuzhnjën e tij në gjoks peshkun shpatë.

Krahaso:

Then the fish came alive, with his death in him, and rose high out of the water showing all his great length and width and all his power and his beauty.

Ahere peshku u gjallërua, megjithëse kishte vdekur brenda, dhe u ngrit lart mbi ujë, duke treguar gjithë gjatësinë dhe gjerësinë, dhe gjithë forcën dhe bukurinë e tij.

(Shih faqen 94 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 84 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Pastaj bie në ujë me zhurmë, duke qullur me stërkala uji deti Santjagon. Ashtu vetëtimthi, Santjagoja sheh bishën e vrarë kthyer me kurriz dhe gjakun e kuq që shpërndahet në ujin e kaltër. Teksa shikon shpërblimin e mundit të tij, Santjagoja i jep vetës zemër.

Krahaso:

“Get to work, old man,” he said. He took a very small drink of the water. “There is very much slave work to be done now that the fight is over.”

- Jepi plak, tha. Mori shishen dhe piu një gllënjë të vogël uji. Tani që lufta mbaroi, duhet të bëj një punë si prej skillavi.

(Shih faqen 95 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 86 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Pasi vret peshkun shpatë, Santjagoja rehaton trupin e tij në kaiken e vet. Ai fillon ta tërheq peshkun shpatë për ta afruar te buza e barkës, në mënyrë që të mund t'i fus litarin midis verzave dhe qafës, dhe t'ia lidhë kokën te bashi.

Krahaso:

I want to see him, he thought, and to touch and to feel him. He is my fortune, he thought.

Dua ta shikoj, mendoi, dhe ta prek me dorë dhe ta marr vesh si është. Ai është pasuria ime.

(Shih faqen 95 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 85 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plaku e heq litarin e fuzhnjës nga hallka e bashit, e kalon midis verzave dhe nofullave të peshkut, e hedh dy herë rrotull shpatës, pastaj e kalon në verzën tjetër, e mbështjell dhe një herë rreth shpatës dhe, si e bën nyje të dyfishtë, e lidh te hallka e bashit. Pastaj e këput litarin dhe shkon te kiçi që të lidhë bishtin. Plaku e lidh peshkun te kiçi dhe te bashi dhe te mezi i fronit. Peshku është kaq i madh, saqë dukek si një barkë më e madhe ku është lidhur barka e plakut. Plaku prët një copë litar dhe e lidh nofullen e poshtme të peshkut te shpata, në mënyrë që të mos i hapet goja dhe që barka të mund të lundrojë sa më lehtë. Pastaj ai vë drekun dhe, pasi tërheq litarin e pëlhurës me ndihmën e shkopit, pëlhura e arnuar fryhet, barka fillon të lëvizë dhe gjysmë i shtrirë te kiçi, plaku e drejton nga jug-perëndimi.

Plaku nuk i heq sytë nga peshku shpatë, që të sigurohet se nuk është në ëndërr. Pas një ore, atë e sulmon peshkaqeni i parë. Ai kishte ndjekur gjurmët e gjakut të peshkut të vvarë, të shpërnara thellë në det. Gjate kohës që peshkaqeni i afrohet anijes, Santjagoja përgatit fuzhnjën dhe lidh litarin për të vvarë peshkaqenin përpara se ky t'ia copëtojë peshkun shpatë.

Krahaso:

The shark's head was out of water and his back was coming out and the old man could hear the noise of skin and flesh ripping on the big fish when he rammed the harpoon down onto the shark's head at a spot where the line between his eyes intersected with the line that ran straight back from his nose.

Koka e peshkaqenit ishte mbi ujë dhe shpinën e kish jashtë, dhe plaku dëgjoi zhurmën e lëkurës dhe të mishit të peshkut të madh, që po shqyheshin nga nofullat, në kohën kur e nguli fuzhnjën mbi kokën e peshkaqenit në vendin ku kryqëzohej linja që bashkonte dy sytë e tij me linjën e drejtë të hundës.

(Shih faqet 101-102 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqet 90-91 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Peshkaqen i vdekur zhytet ngadalë në ujërat e thella të oqeanit. Megjithatë, dy orë më vonë, dy peshkaqenë hundëshypur mbërrijnë pranë barkës. Pas humbjes së shtizës tij në trupin e peshkaqeni mako, Santjago e fikson thikën te lopata dhe e përdor këtë si armë në luftën kundër peshkaqenëve. Plaku e vret peshkaqenin e parë me lehtësi, por ndërsa ai e bën këtë, peshkaqeni tjetër është duke duke bërë kërdrinë mbi peshkun shpatë. Santjagoja e kthen pëlhurën në atë mënyrë, që barka të kthehet anash dhe peshkaqeni të dalë nga ujët. Kur e sheh peshkaqenin, përkulet nga buza e barkës dhe e godet atë. Pas disa luftërave, Santjagoja e vret edhe këtë peshkaqen. Ai i kërkon ndjesë peshkut shpatë për gjymtimin që ka pësuar.

Krahaso:

“I shouldn't have gone out so far, fish,” he said. “Neither for you nor for me. I'm sorry, fish.”

- Nuk duhej të kisha shkuar kaq larg, o peshk, tha. Kjo s'ishte e mirë as për mua, as për ty. Më vjen keq, o peshk.

(Shih faqen 110 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 97 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

I lodhur dhe shpresëhumbur, Santjagoja është ulur dhe pret sulmuesin e radhës, një peshkaqen të vetëm hundështypur. Plaku arrin ta vrasë peshkaqenin, por thyen tehun e thikës në këtë përballje.

Më shumë peshkaqenë shfaqen në perëndim të diellit dhe Santjagoja ka vetëm një shkop me të cilin do t'i mundë. Ai nuk i vret peshkaqenët, por i dëmton ato aq sa duhet për të parandaluar kthimin e tyre. Santjagoja mezi pret mbrëmjen, pasi ai do të jetë në gjendje të shohë dritat e Havanës, duke i treguar rrugën e kthimit nga deti në tokë. Atij i vjen keq që nuk përdori shkopin me të dyja duart, ngaqë me siguri do ta kishte vrarë peshkaqenin e pare, dhe i kërkon falje përsëri peshkut. Ai sheh dritat e Havanës dhe lundron në drejtim të bregut. Në mesnatë peshkaqenë kthehen dhe slumojnë prapë.

Krahaso:

But by midnight he fought and this time he knew the fight was useless. They came in a pack and he could only see the lines in the water that their fins made and their phosphorescence as they threw themselves on the fish.

Në mesnatë ai luftoi dhe këtë herë e dinte se lufta që e kotë. Ata erdhën në tufë dhe ai mund të dallonte vetëm vijat që bënin fletët e tyre në ujë dhe ndriçimin fosforik që lëshonin trupat e tyre te i vërsuleshin peshkut.

(Shih faqet 118 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 103 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plaku godet me shkop kokat e tyre dhe dëgjon kërcitjen e nofullave, dhe ndien sesi dridhet barka kur ata e kafshojnë peshkun nga poshtë. Ai godet i dëshpëruar në diçka që nuk e sheh, por vetëm e dëgjon dhe ndien, kur befas dikush ia rrëmben shkopin dhe shkopi zhduket. Santiago shkul timonin nga vendi dhe godet me të djathtas e majtas, duke e mbajtur me të dyja duart dhe duke e ngritur dhe ulur pa pushim nëpër terr, derisa e thyen.

Krahaso:

That was the last shark of the pack that came. There was nothing more for them to eat.

Ky ishte peshkaqeni i fundit i tufës që u turr. Ai s'kish më ç'të hante.

(Shih faqet 118-119 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 104 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

He sailed lightly now and he had no thoughts nor any feelings of any kind.

Lundronte lehtë dhe nuk kishte asnjë mendim në kokë dhe nuk ndjente më asgjë.

(Shih faqen 119 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 105 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santiagoja hedh thesin mbi supë dhe e sjell barkën në drejtimin e mëparshëm. Ai lundron lehtë dhe nuk ka asnjë mendim në kokë dhe nuk ndien më asgjë. Tani aq i bën dhe po lundron që të arrijë sa më shpejt në bregun ku ka shtëpinë. Natën peshkaqenët sulmojnë skeletin e peshkut, si ata që rrëmbejnë thërrimet nga tryeza. Plaku nuk e çan kokën më për ta dhe nuk e çan kokën më për asgjë, por vetëm drejton barkën. Kur hyn në skelën e vogël, dritat e Tarraces janë të shuara dhe Santjagoja e di se të gjithë kanë rënë për të fjetur. Era sa vjen e ngrihet më shumë dhe tani fryn fort. Megjithatë në skelë ka qetësi dhe plaku e afron barkën te zalli nën shkëmbinjtë. S'ka njeri që ta ndihmojë, kështu që e tërheq barkën sa mundet. Pastaj zbrete dhe e lidh barkën te shkëmbi.

Krahaso:

He started to climb again and at the top he fell and lay for some time with the mast across his shoulder. He tried to get up. But it was too difficult and he sat there with the mast on his shoulder and looked at the road.

Zuri të ngjitej përsëri, dhe kur arriti në majë ra përmbys në dhë për ca kohë me direkun mbi sup. U përpoq të ngrihej. Por kjo ishte shumë vështirë dhe ai qëndroi i shtrirë me direkun mbi sup dhe vështronte rrugën.

(Shih faqen 121 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 106 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagoja detyrohet të çlodhet në tokë pesë herë para se të arrijë në kasollen. Me të arritur aty, ai shtrihet në shtrat dhe e zë gjumi.

Manolini arrin në kasolle ndërsa Santjagoja është ende në gjumë. Djali largohet shpejt për të marrë kafe për Santjagon, duke qarë rrugës për në Terracë. Manolini sheh peshkatarë të mbledhur rreth barkës duke matur peshkun shpatë në gjatësi prej tetëmbëdhjetë këmbëve. Kur Manolini kthehet në kasolle, Santjagoja është zgjuar. Ata të dy bisedojnë me njëri-tjetrin një grime kohë.

Krahaso:

“Now we fish together again.”

“No. I am not lucky. I am not lucky anymore.”

“The hell with luck,” the boy said. “I’ll bring the luck with me.”

- Tani do të peshkojmë përsëri bashkë.

- Jo. Unë s’kam fat. S’kam më fat.

- Në djall të vejë fati, - tha djali. - Të sjell unë fat.

(Shih faqen 125 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 109 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Pastaj Santjagoja hesht, kurse Manolini ikën për të marrë ushqim dhe një këmishë. Atë mbasdite në Terracë vjen një grup turistësh. Një grua sheh një kurriz të gjatë të bardhë me një bisht të madh në fund, që lëkundet e ngrihet nga batica. Duke mos njohur skeletin e gjatë të peshkut të madh, ajo pyet një kamarier se çfarë është. “Peshkaqen”, i përgjigjet ai duke dashur t’i tregojë se çfarë ka ngjarë.

Krahaso:

“What’s that?” she asked a waiter and pointed to the long backbone of the great fish that was now just garbage waiting to go out with the tide.

- Ç’është kjo? - pyeti ajo një kamarier dhe tregoi skeletin e gjatë të peshkut të madh që tani s’ ishte veç një plaçkë që priste ta merrte zbatia.

(Shih faqen 126 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 110 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ajo, e habitur, i thotë kamarierit se nuk e di që peshkaqenët kanë bishta kaq të bukur.

Krahaso:

“I didn’t know sharks had such handsome, beautifully formed tails.”

- Nuk e dija që peshkaqenët kanë bishta kaq të bukur dhe të përkulur kaq hijshëm.

(Shih faqen 127 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 110 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ndërkohë, në kasollen e tij, atje mbi rrugë, plaku përsëri është duke fjetur dhe duke parë ëndrra me luanë, vetëm se kësaj here pranë tij ndodhet djali që nuk ia ndan sytë për asnjë çast.

Krahaso:

He was still sleeping on his face and the boy was sitting by him watching him. The old man was dreaming about the lions.

Ai ende flinte përmbys dhe djali që ulur pranë tij dhe e ruante. Plaku shihte në ëndërr luanë.

(Shih faqen 127 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 110 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

4.1.3 Pjesa 1: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar

Përmbledhje

Është një peshkatar plak në Kubë. Ai quhet Santjago. Ai ka kaluar tetëdhjetekatër ditë pa kapur peshk. Ai është “thatanik dhe i rraskapitur, me rudha të thella ne qafe dhe në duar ka shenja të thella plagësh, të bëra nga litari kur ka tërhuqur ndonjë peshk të madh. Por asnjë nga këto shenja nuk është e freskët.

Krahaso:

They were as old as erosions in a fishless desert.

Ato ishin aq të vjetra, sa plasat e një shkretëtire pa ujë.

(Shih faqen 10 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 18 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Megjithatë, mungesa e suksesit, nuk e shkatërron shpirtin e Santjagos.

Krahaso:

Everything about him was old except his eyes and they were the same color as the sea and were cheerful and undefeated.

Çdo gjë e kish të vjetër, përveç syve, dhe sytë e tij kishin po atë ngjyrë që kishte deti dhe ishin gazmorë dhe të paepur.

(Shih faqen 10 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 18 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ai ka një mik të vetëm, një djalë me emrin Manolin, i cili e ndihmon atë gjatë dyzet ditëve të para të peshkimit të tij te pasuksesshëm. Pas dyzet ditësh, prindërit e Manolinit arrijnë në përfundimin se plaku është i pafat dhe e urdhërojnë atë për t’u bashkuar me një barkë tjetër. Përkundër kësaj, çdo ditë djali e ndihmon plakun sapo ky i fundit kthehet nga peshkimi me barkën e tij të zbrazët.

Pasi nxjerr fitime nga peshkimi me barkën tjetër, Manolini i kërkon Santjagos nëse ky pranon që ai të kthehet në shërbimin e plakut. Santjagoja nuk pranon duke i thënë djalit që të veprojë sipas këshillave të prindërve të vet dhe të qëndrojë me barkën e suksesshme. Santjagoja i tregon Manolinit se të nesërmen ai do të shkojë për të peshkuar larg në Gulf Strim. Ndërkaq, Manolini i shpjegon Santjagos se ai do të përpiqet ta bindë edhe peshkatarin e tij të shkojë sa më larg, dhe, pastaj, në qoftë se ti kap ndonjë peshk vërtet të madh, ne do të vijmë të të ndihmojmë. Përveç kësaj, Manolini shpreh dëshirën

dhe gatishmërinë për të marrë sardele për plakun, gjë që ky i fundit fillimisht e refuzon, por pastaj e pranon.

Krahaso:

He was too simple to wonder when he had attained humility. But he knew he had attained it and he knew it was not disgraceful and it carried no loss of true pride.

Ai kishte një shpirt aq të thjeshtë, sa që nuk e kish kuptuar as vetë se nga ç'kohë kish filluar të përulej. Por e dinte se tani përulej shpejt, dhe se përulja nuk kish sjellë me vete as turpin dhe as humbjen e krenarisë që ka njeriu.

(Shih faqen 14 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 20 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagoja dhe Manolini i nxjerrin veglat e peshkimit nga barka e të parit dhe shkojnë në shtëpinë e plakut. Shtëpia e Santjagos është një kasolle shumë e thjeshtë me një shtrat, me një tryezë, me një karrige, me fundshtrojë prej balte. Në muret ngjyrë kafe ka piktura fetare me ngjyra. Më parë, aty varej edhe një fotografi me ngjyra e gruas së tij, por plaku e kishte hequr andej, sepse kur e shihte e ndjente veten shumë të vetmuar

Në shtëpi, të dy flasin për vorbën e orizit me peshk dhe rrjetën megjithëse rrjetë nuk ka, dhe djalit i kujtohet koha kur e kanë shitur, por ata çdo ditë bëjnë sikur e kanë rrjetën. Nuk kae as vorbë orizi me peshk, dhe djali e di edhe këtë. Djali vendos të dalë për të marrë sardelet për të ngrënë. Pastaj, Santjagoja merr një gazetë dhe të dy diskutojnë për bejsbollin. Plaku flet me entuziazëm të madh për Di Maxhion. Ai gjithashtu i thotë Manolinit të mos i frikësohet nga Indianët e Kllivlendit, por të ketë besim te Jankitë dhe të kujtojë të madhin Di Maxhio. Ai i thotë Manolinit se numri tetëdhjetepesë është një numër me fat, dhe që nesër është “dita e tetëdhjetepesë” që ai nuk ka kapur peshkë, dhe që ndoshta ata duhet të blejnë një biletë lotarie me atë numër. Manolini largohet nga shtëpia dhe Santjagoja bie në gjumë.

Krahaso:

“I’ll get the cast net and go for sardines. Will you sit in the sun in the doorway?”

“Yes. I have yesterday’s paper and I will read the baseball.”

“I’ll be back when I have the sardines. I’ll keep yours and mine together on ice and we can share them in the morning. When I come back you can tell me about the baseball.”

“The Yankees cannot lose.”

“But I fear the Indians of Cleveland.”

“Have faith in the Yankees my son. Think of the great DiMaggio.”

“You study it and tell me when I come back.”

“Do you think we should buy a terminal of the lottery with an eighty-five?”

Tomorrow is the eighty-fifth day.”

“We can do that,” the boy said. “But what about the eighty-seven of your great record?”

“It could not happen twice. Do you think you can find an eighty-five?”

- Po marr rrjetën e po shkoj për sardele. Do rrish te pragu i derës të ngrohesh në diell?

- Mirë. Kam gazetën e djeshme dhe do të lexoj lajmet e bejsbollit.

- Do të kthehem si të kap sardelet. Të miat dhe të tuat do t'i vë bashkë në akull, dhe nesër në mëngjes mund t'i ndajmë. Kur të kthehem, do të më thuash lajmet e bejsbollit.

- Jankit s'mund të humbasin.

- Ua kam frikën Indianëve të Kllivlendit.

- Të kesh besim te “Jankit”, more bir. Kujto të madhin Di Maxhio.

- Lexoje mirë dhe më trego kur të kthehem.

- Si thua, të blejmë një biletë llotarie me numrin tetëdhjetë e pesë? Nesër është e tetëdhjetë e pesta ditë.

- Mund ta blejmë, - tha djali. - Po sikur ta blenim me shifrën tetëdhjetë e shtatë, që është rekordi yt i madh?

- S'mund të ndodhë dy herë ajo gjë. Ti mendon se mund të gjesh me tetëdhjetë e pesë?

(Shih faqet 16-17 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqet 23-24 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Analizë

Që në fjalinë e parë bie në sy mjeshtria e rrëfimit nga ana e autorit. Fjalët dhe strukturat e thjeshta (dy fjali të pavarura të lidhura me bashkërenditje) janë tiparet e zakonshme të stilit letrar të Heminguejt. Ndërsa në vepra të tjera kjo ekonomi e gjuhës përdoret për të përcjellë menjëherësinë e përvojës, mjeshtria e Heminguejt këtu arrin deri në pikën e thurjes së prozës së zbrazur në një rrafsh dhe shtatzënë me kuptimësinë në rrafshin tjetër, domethënë, fjalitë priren të humbasin lidhjen e tyre të veçantë me realitetin, por në të njëjtën kohë përftojnë një tipar përgjithësues, simbolik, gati-gati si ai që përshkon poezinë. Po ashtu, stili i Heminguejit ndihmon në shpjegimin e arsyes se përse kaq shumë kritikë letrare e shohin këtë roman më shumë si një legjendë se sa si një trill fantazie.

Krahaso:

Ai ishte një plak që peshkonte i vetëm me barkë mbi Gulf Strim dhe që kish tetëdhjetë e katër ditë pa kapur asnjë peshk.

He was an old man who fished alone in a skiff in the Gulf Stream and he had gone eighty-four days now without taking a fish.

(Shih faqen 14 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 9 të tekstit të përkthyer –

Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Përdorimi i numrit dyzet në fjalinë tjetër është i pari i shumë aluzioneve fetare në novelë. Ne na thuhet se pas dyzet ditëve (koha që iu desh Krishtit për ta mposhtur Djallin në shkretëtirë), prindërit e Manolinit marrin një vendim të dhimbshëm për plakun dhe djalin njëherazi.

Krahaso:

Dyzet ditët e para, me të shkante edhe një djalë. Por, kur kaluan dyzet ditë pa kapur asnjë peshk, prindërit i thanë djalit se plaku ish bërë tani përfundimisht salao, që do të thotë më tersi ndër të pafatët, dhe e kishin urdhëruar djalin të shkante në një barkë tjetër, e cila kapi tre peshq të mirë që javën e parë.

In the first forty days a boy had been with him. But after forty days without a fish the boy's parents had told him that the old man was now definitely and finally salao, which is the worst form of unlucky, and the boy had gone at their orders in another boat which caught three good fish the first week.

(Shih faqen 14 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 9 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Kjo fjali shpall një nga temat e kësaj vepre, lufta heroike kundër fatit të pandryshueshëm. Në të vërtetë, i gjithë paragrafi i parë thekson pamundësinë e qartë të Santjagos për të korrur fitore.

Krahaso:

"It made the boy sad to see the old man come in each day with his skiff empty ..."

"Djali pikëlluhej kur shihte plakun që kthehej çdo ditë me barkën bosh..."

(Shih faqen 9 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 17 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

The sail was patched with flour sacks and, furled, it looked like the flag of permanent defeat.

Pëlhura ishte arnuar me copa thasësh dhe, ashtu e mbështjellë, dukej si një flamur disfatash të përhershme.

(Shih faqen 9 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 17 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ky lloj përshkrimi degradues i Santiagos vazhdon me dhënien e hollësive në lidhje me trupin e tij të mplakur, të mbaruar. Edhe plagët e plakut, trashëgimia e fitoreve të tij të kaluara janë.

Krahaso:

They were as old as erosions in a fishless desert.

Ato ishin aq të vjetra, sa plasat e një shkretëtire pa ujë.

(Shih faqen 9 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 17 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Megjithatë, e gjithë kjo ndryshon papritur kur Heminguej shprehet me mjeshtëri:

Krahaso:

Everything about him was old except his eyes and they were the same color as the sea and were cheerful and undefeated.

Çdo gjë e kish të vjetër, përveç syve, dhe sytë e tij kishin po atë ngjyrë që kishte deti dhe ishin gazmorë dhe të paepur.

(Shih faqen 10 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 18 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Kjo tërheq vëmendjen drejt dallimit midis dy llojeve të ndryshme të suksesit: (1) suksesit të jashtëm, domethënë, suksesit material, dhe (2) suksesit të brendshëm, domethënë, suksesit shpirtëror. Ndërkohë që Santjagos i mungon qartazi lloji i parë i suksesit, kjo mungese është mbuluar më vonë nga arritja e tij. Ky triumf i frymës së paefektshme mbi burimet materiale të ndjeshme është një tjetër temë e rëndësishme e romanit. Gjithashtu, ngjyra e syve të Santjagos hedhin dritë mbi lidhjen gjithnjë e më të qartë të Santjagoa me detin duke nënkuptuar analogjinë midis shpirtit të pamposhtur të Santjagos dhe fuqisë së pakufishme të detit.

Lidhja ndërmjet Santjagos dhe Manolinit mund të përmbliidhet në një fjali:

Krahaso:

The old man had taught the boy to fish and the boy loved him.

Plaku e kish mësuar djalin të zinte peshq dhe djali e donte.

(Shih faqen 10 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 18 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Manolini është nxënës i Santjagos, por lidhja e tyre nuk kufizohet vetëm me peshkimin si veprimtari fitimprurëse. Manolini e idealizon Santjagon, vetëm se objekti i këtij idealizmi nuk është vetëm peshkatari dikur i madh, megjithëse aktualisht i dështuar; por edhe një idealizëm idealesh. Kjo ndihmon për të shpjeguar e përkushtimin unik, pothuajse fetar, të Manolinit ndaj Plakut, gjë që duket sidomos kur Manolini i lutet Santjagos që ta falë për largimin e detyruar prej tij.

Krahaso:

**“It was papa made me leave. I am a boy and I must obey him.”
“I know,” the old man said. “It is quite normal.”**

**- Babai më shtrëngoi të ikja. Unë jam i vogël dhe duhet t'i bindem.
- E di, - tha plaku. - Kjo është e natyrshme.**

(Shih faqen 10 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 18 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Pavarësisht nga hierarkia e qartë e kësaj lidhjeje mësues / nxënës, Santjagoja thekson barazinë e tij me djalin. Kur Manolini kërkon ta qerasë me një birrë, Santjagoja përgjigjet:

Krahaso:

“Why not?” the old man said. “Between fishermen.”

- Pse jo? - tha plaku. - Peshkatari mund ta gostisë peshkatarin.

(Shih faqen 11 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 18 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Dhe kur Manolini kërkon të ndihmojë Santjagon për të peshkuar, Santjago përgjigjet:

Krahaso:

“You bought me a beer,” the old man said. “You are already a man.”

- Ti më gostite me një birrë, - tha plaku. - Ti tani je burrë.

(Shih faqen 12 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 19 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Duke demonstruar se Santjagos ka shumë pak gjëra për t'i mësuar djalit, kjo barazi parashikon ndarjen e afërt të dy miqve, si dhe tregon se ky nuk do të jetë një rrëfim për një djalë që mëson nga një plak, por një histori e një plaku që jep mësimet e veta të përveçme në vjeshtën e jetës.

Një lloj i ngjashëm i barazimit të papritur vjen kur Heminguej përshkruan mënyrat e ndryshme se si trajtohen në breg marlini dhe peshkaqenët. Ndërsa parashikon luftën e Santjagos mes marlinit dhe peshkaqenëve, kjo gjithashtu vë shenjën e barazisë me pjesëmarrësve. Pavarësisht nga betejat në det, marlini dhe peshkaqenët theren dhe përdoren nga njerëzit në tokë, pra, antagonizmi i tyre nuk do të thotë asgjë në breg. Ashtu si rasti i Santjagos dhe Manolint, ky barazim shpalos shqetësimin tematik të romanit për unitetin e natyrës, duke përfshirë njerëzimin, një unitet që në fund të fundit ndihmon për të ardhur në ndihmë viktimës heroike të tragjedisë së madhe.

Heminguej gjithashtu e bën pikante romanin përmes referencave të shumta për sytë. Na thuhet, për shëmbull, se Santjagoja ka shikim tepër të mirë për një njeri të moshës dhe përvojës së tij, ndërsa punëdhënësi i ri i Manolinit është pothuajse i verbër. Kur Manolini e vë re këtë, Santjago përgjigjet thjesht:

Krahaso:

“I am a strange old man.”

- Unë jam plak i çuditshëm.

(Shih faqen 14 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 21 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Duke pasur parasysh analogjinë e përmendur më parë midis syve të Santjagos dhe detit, dyshohet se çudia e tij në këtë drejtim buron nga lidhja e tij me detin. Megjithatë, kjo lidhje është disi problematike, pasi mund të nënkuptojë se Santjagoja duhej të ishte peshkatari i suksesshëm. Sidoqoftë, lidhja e saktë e Santjagos me detin do të shihet në pjesët vijuese.

Thjeshtësia e shtëpisë së Santjagos e zgjeron më tej këndvështrimin tonë për Santiagon si materialisht të pasuksesshëm. Është interesante se si Heminguej tërheq vëmendjen ndaj kujtimeve të gruas së Santjagos në shtëpinë e tij duke paraqitur një aspekt të Santjagos, i cili mungon në të gjithë romanin. Kjo është domethënëse sepse nënkupton një plotësim të caktuar të karakterit të Santjagos, gjë që e bën atë më shumë si një njeri të çfardoshëm, të përshtatshëm për një alegori, pra, largimi i së shoqes nga skena e bën mungesën e saj edhe më të rëndësishme dhe mundëson nëse nëse karakteri i Santjagos është aq tërheqës saqë ta lejojë lexuesin që të identifikohet plotësisht me historinë e tij.

4.1.4 Pjesa 2: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar

Përmbledhje

Kur kthehet Manolini, ai zgjon Santiagon nga gjumi. Të dy hanë ushqimin që ka sjellë djali. Gjatë ngrënies së ushqimit, djali zbulon rrekat në të cilat jeton plaku dhe kujtohet që t'i sjellë plakut një këmishë, këpucë, një xhaketë dhe një batanije për dimrin e ardhshëm. Të dy flasin sërish bejsboll duke u përqendruar si zakonisht te Di Maxhio. Duke folur për yje të mëdhenj të bejsbollit, djali e quan plakun peshkatarin më të madh. Santjagoja e pranon komplimentin, por mohon vërtetësinë e thënies së Manolinit duke theksuar se ai ka njohur peshkatar më të mirë se veten. Djali pastaj ikën, që në mëngjes të zgjohet nga plaku. Santjagoja fle. Santiagoja sheh në ëndërr Afrikën e djalërisë së tij kur ishte ndihmës-marinar në një anije me vela.

Krahaso:

He was asleep in a short time and he dreamed of Africa when he was a boy and the long golden beaches and the white beaches, so white they hurt your eyes, and the high capes and the great brown mountains. He lived along that coast now every night and in his dreams he heard the surf roar and saw the native boats come riding through it. He smelled the tar and oakum of the deck as he slept and he smelled the smell of Africa that the land breeze brought at morning.

Gjumi e zuri shpejt, dhe në ëndërr pa Afrikën e djalërisë së tij dhe plazhet e arta të gjata dhe rërat e bardha, aq të bardha sa të dhembin sytë, dhe shkëmbinj të lartë dhe malet e mëdha ngjyrë kafe. Ai jetonte tani gjatë atyre brigjeve çdo natë, dhe në ëndrrat e tij dëgjonte zhurmën e erës mbi det dhe shikonte barkat e indigjenëve që çanin përmes tij. Në gjumë nuhaste erën e rrëshirës dhe të dushkut të kuvertës, dhe ndiente erën e Afrikës, që e sillte mëngjeseve fladi i bregdetit.

(Shih faqet 24-25 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 29 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

He only dreamed of places now and of the lions on the beach.

Tani shikonte në ëndrra vetëm vise dhe luanë nëpër plazh".

(Shih faqen 25 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqet 29-30 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plaku zgjohet dhe e merr djalin me vete nga shtëpia e tij. Të dy bashkë I çojnë veglat e peshkimit të plakut nga kasollja e tij në barkë dhe shijojnë kafënë në një lokal që u shërben peshkatarëve që herët në mëngjes. Djali largohet për të marrë sardelet për plakun. Kur kthehet, djali i uron fat plakut, dhe Santjagoja del në det. Santjagoja nis lundrimin herët në mëngjes, para lindjes së diellit.

Krahaso:

The old man knew he was going far out and he left the smell of the land behind and rowed out into the clean early morning smell of the ocean.

Plaku kish vendosur të shkonte larg, la prapa aromën e tokës dhe po voziste tutje nëpër aromën e freskët mëngjesore të oqeanit.

(Shih faqen 28 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 32 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Shumë shpejt ai vozit mbi atë pjesë të oqeanit që peshkatarët e quajnë pusi i madh, sepse atje thellësia zbret papritur në një mijë e katërqind metra dhe mblidhen të gjitha llojet e peshqve, ngaqë rrymat formojnë një vorbull, duke u përplasur pas rrëpirave të fundit të oqeanit. Dhe në errësirë, plaku dëgjon tingullin e dridhshëm të një peshku fluturues, që lë ujët dhe çan ajrin me krahët e tij të sertë. Ai i dashuron shumë peshqit fluturues, sepse ata janë miqtë e tij të parë në oqean.

Krahaso:

Why did they make birds so delicate and fine as those sea swallows when the ocean can be so cruel? She is kind and very beautiful.

Pse vallë zogjtë janë krijuar kaq të brishtë, si këto dallëndyshe deti, kurse oqeani nganjëherë bëhet aq i egër? Ai është i mirë dhe shumë i bukur.

(Shih faqen 28 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 32 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ndryshe nga disa peshkatarë, nga ata që përdorin fuçitë lundronjëse për rrjetat e tyre dhe që kanë barka me motor, e thërrasin detin në gjininë mashkullore, dhe flasin për të si për një rival ose hapësirë, ose madje si për një armik, Santjagoja e thërret në gjininë femërore.

Krahaso:

But the old man always thought of her as feminine and as something that gave or withheld great favours, and if she did wild or wicked things it was because she could not help them.

Kurse plaku gjithmonë mendonte për të, si për një grua që të jep disa gjëra ose nuk të jep asgjë, dhe kur disa herë bën gjëra të këqija që të mendojnë, kjo vjen sepse ashtu e ka natyrën dhe s'ke ç'i bën.

(Shih faqen 30 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 33 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagoja vozit ritmikiisht, kalon pusin, dhe nuk mundohet, sepse sipërfaqja e oqeanit është e lëmuar me përjashtim të vorbullave që krijonte rryma. Ai e lë rrymën të bëjë një të tretën e punës dhe kur fillon të gdhijë është më larg se ç'e ka parashikuar. Ai vendos të punojë larg poshit të thellë, atje ku ka tufa bonitash dhe albakorësh, dhe mbase dhe ndonjë peshk të madh.

Ende pa gdhirë mirë, Santjagoja hedh karremat dhe vozit ku ta çojë rryma. Mirëpo ai dëshiron të dijë me saktësi se në çfarë rthellësie janë karremat e tij.

Krahaso:

But, he thought, I keep them with precision. Only I have no luck any more. But who knows? Maybe today. Every day is a new day. It is better to be lucky. But I would rather be exact. Then when luck comes you are ready.

Kurse unë, mendonte ai, e hedh grepin me përpikmëri. Vetëm se unë nuk kam më fat. Po ku ta dish? Mbase do kem sot. Çdo ditë është një ditë e re. Është mirë kur të ecën fati. Por unë duhet të jem i përpiktë. Pastaj në më ardhhtë fati, të jem gati.

(Shih faqen 32 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 35 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plaku sheh zogun fregat që po sillet mbi kokën e tij, që zhytet pingul dhe pastaj përsëri fillon të sillet mbi det. Plaku e kupton se zogu ka rënë në gjah, madje këtë ai e thotë me zë të lartë dhe vozit ngadalë dhe ritmikiisht drejt vendit, mbi të cilin vjen vërdallë zogu. Nuk shpejton dhe i mban fijet drejt. Por barkën e mënjanon pak rryma, megjithëse plaku peshkon ashtu siç duhet. Kur zogu ngjitet më lart në erë dhe pastaj zhytet në mënyrë të beftë, plaku sheh një peshk fluturues që kërcen nga ujët dhe fluturon i dëshpëruar mbi sipërfaqen e detit. Plaku nxjerr lopatat, merr një fill të vogël, në fund të të cilit është lidhur me tel një grep, dhe shkon një nga sardetet. Ai e hodhi fillin në ujë dhe pastaj e lidh fundin te hallka e hekurt e kështjës së barkës. Pastaj ai shkon një karrem në fillin tjetër dhe vihet përsëri të vozitë dhe të vërejë zogun e zi me krahë të gjata, që po gjuan tani fare poshtë, pranë faqes së ujit. Ndërsa plaku e ndjek me sy zogun që zhytet përsëri me krahët e mbledhura dhe pastaj, duke përplasur krahët me rrëmbim, fillon të ndjekë i shqetësuar peshkun fluturues. Plaku sheh se si ujët ngrihet pak përpjetë dhe makreli i madh i artë po ndjek peshkun që po largohet. Makreli noton me shpejtësi nën peshkun fluturues, duke i prerë udhën në mënyrë që të ndodhet mu poshtë tij, kur peshku të bjerë në ujë. Plaku kupton se aty ndodhet një tufë e madhe makrelësh. Ai nuk ia ndanë sytë peshkut fluturues që hidhet nga ujët përsëri dhe përsëri, dhe sesi zogu më kot përpqej që ta kapë. Megjithëse kjo tufë makrelësh i shpëton, plaku shpreson se do të gjej ndonjë që është shkëputur nga tufa dhe se ndoshta peshku i tij i madh duhet të jetë diku pranë tij. Një fizali portugeze me këmbët e saj vdekjeprurëse ngjyrë vjollcë i afrohet barkës. Plaku e quan bushtër të keqe. Teksa u jep lopatave, ai vështron poshtë në ujë dhe sheh ca peshq të vegjël, të cilët kanë po atë ngjyrë që kanë këmbët e zvergura në ujë dhe që notojnë midis tyre nën hijen e kandilit që e merr deti. Plaku e di se atyre nuk u shkakton dëm helmi i tij, por prapë gëzon se do të jetë dëshmitar i shkatërrimit të tyre.

Krahaso:

The iridescent bubbles were beautiful. But they were the falsest thing in the sea and the old man loved to see the big sea turtles eating them.

Kandilët e detit, plot pikëzime ngjyrash, ishin shumë të bukur. Por ata ishin gjërat më të pabesa në det, dhe plakut i pëlqente kur shihte sesi i hanin breshkat e mëdha të detit.

(Shih faqen 35 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 38 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Përvoja e ka mësuar Santjagon t'i dojë breshkat, prandaj ai edhe shpreh keqardhjen e tij për to.

Krahaso:

Shumë njerëz janë zemërgur ndaj breshkave, sepse zemra e breshkës rreh edhe shumë kohë më vonë pasi ta kenë vrrarë dhe ta kenë bërë copa. Por edhe unë kam një zemër të tillë, mendonte plaku, edhe këmbët dhe duart i kam si të tyre.

Most people are heartless about turtles because a turtle's heart will beat for hours after he has been cut up and butchered. But the old man thought, I have such a heart too and my feet and hands are like theirs.

(Shih faqen 37 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 39 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Analizë

Ka një ironi interesante në përmbysjen e roleve midis mësuesit Santjago, me kujdesin prej babai, dhe nxënësit të tij, Manolinit. Ndërsa Santjagoja kujdeset për Manolinin në ujë dhe i mëson atij se si të peshkojë, Manolini kujdeset për Santiago në tokë, për shembull, duke u siguruar që plaku të ushqehet dhe të mos ndihet i vetmuar. Kur Santjago dëshiron të peshkojë pa ngrënë, Manolini mban një qëndrim prindëror.

Krahaso:

"You'll not fish without eating while I'm alive."

- Ti kurrë nuk do të dalësh në det pa ngrënë, derisa të jem unë gjallë.

(Shih faqen 19 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 25 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagos i pëlqen kjo sjellje prindërore dhe këtë gjë e shpreh me gjysmë shakaje.

Krahaso:

“Then live a long time and take care of yourself...”

- Ahere jeto sa më shumë dhe kujdesu për veten...

(Shih faqen 19 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 25 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ky inversion i jep jetë rrëfimit pasues, duke e shndërruar Santjagon nga plak, në fëmijë që është gati të veprojë në përputhje me këshillat e urta të djalit. Edhe ëndrrat pothuajse fëmijnore të Santjagos me luanët nëpër plazhe, këto simbole të fuqisë dhe virtytit të burrit, janë gjithashtu një përsëdytje e rinisë së Santjagos.

Përveç kësaj, ëndrra me luanë nëpër plazhet e Afrikës tërheq vëmendjen në drejtim të historisë personale të Santjagos, si një spanjoll nga ishujt Kanarine. Santiago është emri në spanjisht për emrin James në anglisht, që shenjon shenjtorin mbrojtës të Spanjës. Ashtu si Santiago, edhe Shën Jakovi ishte peshkatar para se t’i përgjigjej thirrjes së Krishtit, si dhe ai që solli për herë të parë Krishterimin në Spanjë. Kjo paralele më tej vesh me një frymë fetare Santjagon dhe luftën e tij pasuese.

Natyra e këtyre vlerave nuk është aq e qartë, sidomos në këtë pikë të romanit, por Heminguej jep disa të dhëna. Ka, siç ndodh gjithmonë me Heminguej, një premisë të vendosur në maskulinitetin dhe detyrimet që burojnë prej burrërisë. Kur Santjagoja zgjon Manolinin për ta ndihmuar atë, djaloshi i lodhur thotë thjesht:

Krahaso:

“It is what a man must do.”

- Kështu e kanë punët e burrave.

(Shih faqen 26 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner’s Sons, New York, 1952 – dhe faqen 30 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Pranimi i detyrimit, atëherë, duhet të jetë shenjë e burrërisë, një koncept që Heminguej do ta mishërojë gjatë rrjedhës së romanit.

Fillimi i daljes së Santjagos në det është një pasqyrim i shkëlqyer i artit përshkrues të Heminguejit përmes përdorimit të njëpasnjëshëm të shqisave të ndryshme.

Krahaso:

He saw the phosphorescence of the Gulf weed in the water as he rowed over the part of the ocean that the fishermen called the great well because there was a sudden deep of seven hundred fathoms where all sorts of fish congregated because of the swirl the current made against the steep walls of the floor of the ocean. Here there were concentrations of shrimp and bait fish and sometimes

schools of squid in the deepest holes and these rose close to the surface at night where all the wandering fish fed on them. In the dark the old man could feel the morning coming and as he rowed he heard the trembling sound as flying fish left the water and the hissing that their stiff set wings made as they soared away in the darkness.

Plaku kish vendosur të shkonte larg, la prapa aromën e tokës dhe po voziste tutje nëpër aromën e freskët mëngjesore të oqeanit. Ai pa mbi ujë leshterikët fosforeshentë të Gulf Strimit, ndërsa po voziste mbi atë pjesë të oqeanit që peshkatarët e quajnë pusi i madh, sepse atje thellësia zbret papritur në një mijë e katërqind metra dhe mblidhen të gjitha llojet e peshqve, ngaqë rrymat formojnë një vorbull, duke u përplasur pas rrëpirave të fundit të oqeanit. Këtu mblidhen karavidhet dhe peshqit e vegjël dhe disa herë molusqet, në thellësitë më të mëdha, dhe natën ngjiten në sipërfaqe ku i hanë peshqit endacakë. Në errësirë, plaku ndjente afrimin e mëngjesit, dhe përmes zhurmës së vozitjes dëgjoji tingullin e dridhshëm të një peshku fluturues, që la ujët dhe po çante ajrin me krahët e tij të sertë, që vërshëllenin në errësirë.

(Shih faqet 28-29 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 32 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Ky përdorim i imazheve të ndryshme ndijore ndihmon në krijimin e një përshkrimi të fuqishëm të detit. Siç e tregon vetë titulli i romanit, deti duhet të luajë një rol shumë të rëndësishëm në rrëfim dhe përshkrimi nga Heminguej me hollësi i daljes në det të Santjagos në fillim të romanit, duke nënvizuar bukurinë e qëndrueshme, i jep sinjale lexuesit për këtë lloj rëndësie.

Këndvështrimi i detit nga pikëpamja gjinore nënkupton një konceptim alternative të unitetit, të unitetit midis mashkullit dhe femrës. Ndërkaq, në lidhje me përshkrimet e atyre që e shohin detin si një mashkull dhe kështu hedhin në të një dritë negative, mund të argumentohet se historia është mohimi i një bote homoseksuale të konkurrencës mashkullore. Burri me burrin gjithmonë do të sjellin grindje; ndërkohë, burri me gruan, Santjagoja me detin, plotësojnë njëri-tjetrin dhe krijojnë një unitet paqësor. Përfaqësimi i kontekstit femëror, megjithëse kaq abstrakt, e problematizon këtë gjykim, veçanërisht kur e vetmja grua që hasim në këtë rrëfim është turistja në mbyllje të tij, e cila supozohet se mund të na shkaktojë një fare mërzie.

Thënia e Santjagos se sytë e tij përshtaten me diellin gjatë pjesëve të ndryshme të ditës jep një shembull tjetër të rëndësisë së shikimit dhe pamjes vizuale në roman.

Krahaso:

All my life the early sun has hurt my eyes, he thought. Yet they are still good. In the evening I can look straight into it without getting the blackness. It has more force in the evening too. But in the morning it is painful.

Gjithë jetën, dielli i mëngjesit më ka vrrarë sytë, mendoi ai. Por gjer tani syte i kam mirë. Në mbrëmje mund ta vështroj diellin drejt, dhe në sy nuk më bëhen njolla të zeza. Dielli ka më shumë force në mbrëmje. Por në mëngjes të vret sytë.

(Shih faqen 33 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 35 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Duke pasur parasysh krahasimin e cikleve të kohës natyrore me moshën njerëzore, për shembull, duke e parë shtatorin si vjeshtën e jetës, është e besueshme që kjo pjesë të lexohet si një deklaratë e fuqisë ndërtuese të moshës. Ndërsa është e vështirë për të gjetur një rrugë që të shpie në mëngjesin e rinisë, kjo detyrë lehtësohet kur bëhet nga ata që kanë jetuar gjatë ditës në mbrëmjen e jetës.

4.1.5 Pjesa 3: Përmbledhje: Krahasim përkthimi përmes shtjellimit letrar

Përmbledhje

Santjagoja shikon përsëri zogun dhe dyshon se ka gjetur peshq. Plaku vështronte se si tunat, duke u vërtitur, e bëjnë ujët të bardhë, dhe zogu zhytet tani dhe bie mbi peshqit e vegjël që dalin në sipërfaqe në panik e sipër. Menjëherë pas kësaj, filli që ka lëshuar nga kiçi i barkës tendoset nën këmbën e tij, dhe plaku lëshon lopatat dhe ndien peshën e një tune të vogël, që po e tërheq fillin me dridhje, ndërsa ai e mban fort duke e afruar te barka. Ndërsa e tërheq, filli dridhet edhe më shumë, dhe plaku sheh në ujë shpinën e kaltërt të peshkut dhe ijet e tij të praruara, pa e hedhur ende mbi barkë. Peshku dergjet në qiç duke dredhur e përplasur në dërrasat e barkës bishtin e tij të lëvizshëm. Plaku e godet në kokë me keqardhje dhe pastaj e shtyn me këmbë trupin që po dridhet ende në hijen e qiçit.

Plaku shumë shpejt e kupton se po flet me vete.

Krahaso:

It was considered a virtue not to talk unnecessarily at sea and the old man had always considered it so and respected it. But now he said his thoughts aloud many times since there was no one that they could annoy.

Të mos bisedoje në det, kur s'ishte nevoja, konsiderohej si një virtyt, dhe megjithëse plakut nuk i pëlqente kjo gjë, ai e respektonte. Por tani i kish thënë shumë herë mendimet e tij me zë të lartë, përderisa kjo gjë nuk i prishte punë njeriu.

(Shih faqen 39 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 41 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagoja këshillon veten se duhet ta përqendrojë vëmendjen për të zbuluar arsyen e ardhjes së tij në jetë.

Krahaso:

Now is the time to think of only one thing. That which I was born for.

Tani është koha të mendoj vetëm për një gjë. Për ç'gjë kam lindur në këtë botë.

(Shih faqen 39 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 41 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Shumë shpejt ndodh një kafshim i fortë në një nga karremat që Santjagoja ka hedhur në thellësi të ujit më herët. Pikërisht në atë çast, ai sheh se një nga kallamat e gjelbërt të fillit u përkul dhe u zhyt në ujë. Santjagoja zgjatet dhe e arrin fillin, duke e mbajtur ngadalë midis gishtit të madh dhe gishtit tregues të dorës së djathtë. Ai nuk ndien as

tërheqje dhe as peshë dhe e mban fillin lehtë. Filli dridhet përsëri. Këtë here është një përpjekje për të ndukur fillin dhe ndukja është e lehtë dhe e kujdesshme dhe ai e di me përpikmëri se ç'po ndodh.

Krahaso:

One hundred fathoms down a marlin was eating the sardines that covered the point and the shank of the hook where the hand-forged hook projected from the head of the small tuna.

Dyqind metra thellë, marlina po hante sardelet që mbulonin majën dhe pjesën e përkulur të grepit, atje ku grepi i punuar me dorë kishte shpuar kokat e tunave të vogla.

(Shih faqen 39 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 41 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Duke marrë zemër nga këto ndukje në një thellësi aq të madhe, Santjagoja thotë se peshqit duhet të jenë shumë të mëdhenj.

Marlini sillet rreth grepit dhe kafshon në të disa herë, por refuzon të marrë karremin plotësisht. Santjagoja flet me zë të lartë, sikur të ishte duke iu lutur peshkut për të ngrënë karremin.

Krahaso:

“Come on,” the old man said aloud. “Make another turn. Just smell them. Aren't they lovely? Eat them good now and then there is the tuna. Hard and cold and lovely. Don't be shy, fish. Eat them.”

- Eja, - tha plaku me zë të lartë. - Kthehu dhe një herë. Merru erë. A nuk janë të shijshme? Haji një here ato mirë e mirë, se pastaj ke dhe tunat. Janë të forta, të freskëta dhe të shijshme. Mos ki turp o peshk. Haji.

(Shih faqen 42 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 43 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Pas shumë kafshimeve të rreme, marlini më në fund gëlltit tunën dhe tërheq me vete një gjatësi të madhe të fillit. Santjagoja pret që marlini të gëlltisë grepin dhe pastaj e tërheq shumë fillin për të nxjerrë peshkun në sipërfaqe. Peshku është shumë i fuqishëm dhe nuk pranon të dalë. Në vend të kësaj, ai noton larg duke tërhequr plakun dhe barkën e tij së bashku prapa. Santjagoja dëshiron që ai të ketë Manolinin me vete për ta ndihmuar. Megjithatë, ai duhet të lejojë që peshku të tëheq fillin aq sa dëshiron, përndryshe do t'i humabsë nga duart. Përveç kësaj, plaku e di se peshqit, pasi lodhen, dorëzojnë shpirtin dhe veten.

Krahaso:

But four hours later the fish was still swimming steadily out to sea, towing the skiff, and the old man was still braced solidly with the line across his back.

Por katër orë më vonë peshku notonte ende pa pushuar në det të hapët, duke tërhequr barkën, dhe plaku akoma mbante litarin e tendosur mbi shpinë.

(Shih faqen 45 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 46 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Teksa perëndon dielli, marlini vazhdon të ndjekë të njëjtin drejtim, kurse Santjagoja nuk sheh tokë me sy krejtësisht. Rezultati është i brabarabratë, asnjëra nga të dy palët e përfshira në këtë luftë ende nuk ka fituar.

Krahaso:

I can do nothing with him and he can do nothing with me, he thought. Not as long as he keeps this up.

Unë nuk kam se ç't'i bëj atij, por dhe ai s'ka se ç'të më bëjë mua. Së paku gjersa të mos i ketë shkrepur në kokë ndonjë trill tjetër.

(Shih faqen 47 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 47 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plaku përsëri dëshiron ta ketë djalin me vete.

Krahaso:

No one should be alone in their old age, he thought. But it is unavoidable.

- Asnjëri nuk duhet të mbetet i vetmuar në pleqërinë e tij, mendoi. Por kësaj s'ke si i shpëton.

(Shih faqen 48 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 48 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Si përgjigje ndaj kësaj shprehjeje të vetmisë, dy peshq dalin në sipërfaqe. Teksa i vështron, Santjagoja thotë:

Krahaso:

"They are good," he said. "They play and make jokes and love one another. They are our brothers like the flying fish."

- Janë të mirë, - tha. - Lozin e bëjnë marrëzira dhe e duan njëri-tjetrin. Ata janë vëllezërit e tu, si dhe peshqit fluturues.

(Shih faqen 48 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 48 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Santjagoja pastaj kujton një marlinë femër që ai dhe Manolini kanë pas kapur. Marlina mashkull kishte qëndruar pranë barkës në dëshpërim, kishte kërcyer në ajër për të parë bashkëshorten e tij në barkë para se ai vetë të zhdukej në oqeanin e thellë. Plakut i kujtohet se ai ishte i bukur dhe kish qëndruar gjer në fund pranë mikeshës. Ishte gjëja më e trishtë që Santjagoja kishte parë ndonjëherë.

Pak kohë para se të gdhijë, diçka e kafshon njërin nga karremat që ka pas shpine. Plaku dëgjon se si thuhet kallami dhe filli rrëshqet me shpejtësi nga buza e barkës. Në errësirë ai nxjerr thikën nga këllëfi dhe pret fillin te druri i buzës së barkës. Pastaj pret fillin që ka më pranë, dhe në errësirë lidh fundet e lira të lëmsheve rezervë, duke mos dashur të shpërqendrohet nga marlini, si dhe duke dëshiruar që Manolini të ishte atje për t'u kujdesur për fijet e tjerë. Santjagos nuk i lëkundet aspak vendosmëria.

Krahaso:

“Fish,” he said softly, aloud, “I’ll stay with you until I am dead.”

- Peshk, - i tha me zë të ulët, - unë nuk ndahem nga ty gjersa të jem gjallë.

(Shih faqen 52 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 51 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Plaku dëshiron që peshku të kërcejë, duke dashur të përfundojë luftën sa më shpejt që të jetë e mundur, por edhe shqetësohet se mos kërcimet mund të shkaktojnë zhvendosjen e grepit nga goja e peshkut. Duke i bërë jehonë ish vendosmërisë së tij, megjithëse me më pak siguri, Santjagoja thotë:

Krahaso:

“Fish,” he said, “I love you and respect you very much. But I will kill you dead before this day ends.”

- Peshk, - i tha plaku. - Unë të dua dhe të nderoj shumë. Por do të të vras për vdekje para se të ngryset kjo ditë.

(Shih faqen 54 të tekstit burimor – Ernest Hemingway, *The Old Man and the Sea*, Charles Scribner's Sons, New York, 1952 – dhe faqen 53 të tekstit të përkthyer – Ernest Hemingway, *Plaku dhe deti*, Onufri, 2002.)

Analizë

Faqti që të gjithë peshkatarët e quajnë peshk tunë dhe dallojnë mes peshqve të tjerë vetëm kur i shesin është njëkohësisht një shprehje e temës së unitetit të detit dhe e shpërfilljes së tregut. Nuk është injoranca që nënkupton këtë praktikë, por një vlerësim thjeshtësues i unitetit të detit. Ka peshq dhe ka peshkatar; ata që kapen dhe

ata që kapin. Ky distilim i palëve rrit kualitetin alegorik të novelës. Tregu i detyron peshkatarët të harrojnë këtë marrëdhënie simbolike binare dhe të përqendrohen në diferencimin duke kërkuar një shumëzim të kushteve të ndryshimit. Ndërsa romani merr anën e mitit të unitetit të detit, ky sistemim i nxitur nga tregu pritet negativisht. Kjo përfton kuptim në dritën e zemërimit të përmendur më parë, të cilin tashmë e njeh audienca letrare e Heminguejit nëpërmjet veprave më të hershme.

Lidhur me kafshimet fillestare të marlinit në karrem, Heminguej përdor të njëjtat shprehje herë pas here si, për shembu, “ndjeu një ndukje tjetër të lehtë dhe delikate, dhe pastaj një ndukje më të forte”. Ndërsa kjo mund të shprehë ngjarjen e vërtetë gjer në përsosje, përsëritja krijon një efekt distancues duke e shtyrë prozën më shumë në drejtim të poezisë dhe më pak në drejtim të drejtë realitetit objektivit. Kjo rrit aftësinë alegorike të rrëfimit.

Litari rrëshqiste, rrëshqiste dhe rrëshqiste, por tani pak më ngadalë, dhe plaku mundohej që peshku ta fitonte me zor çdo centimetër filli. Tani plaku e ngriti kokën nga dërrasa dhe e largoi nga mishi i peshkut që i qe shtypur në fytyrë. Pastaj u ngrit mbi gjunjë dhe me ngadalë u ngrit fare në këmbë. Litarin e lëshonte ende, por gjithmonë më ngadalë. U kthye pas, gjersa gjeti me këmbë lëmshet e fillit që nuk mund t'i shihte me sy. Kish ende shumë fill, dhe peshku kish tërhequr kaq tepër, saqë nuk do t'ia dilte dot mbanë me litarin e ri që endej nëpër ujë.

Në **paragrafin e treqindetëdhjetenëntë** autori i tekstit burimor ka përdorur 97 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 100 fjalë, 3 fjalë më pak.

Krahaso:

Yes, he thought. And now he has jumped more than a dozen times and filled the sacks along his back with air and he cannot go down deep to die where I cannot bring him up. He will start circling soon and then I must work on him. I wonder what started him so suddenly? Could it have been hunger that made him desperate, or was he frightened by something in the night? Maybe he suddenly felt fear. But he was such a calm, strong fish and he seemed so fearless and so confident. It is strange.

Kështu, tha me vete. Tani ai ka kërcyer nja dymbëdhjetë herë dhe i ka mbushur fluskat me ajër, dhe nuk mund të zbresë poshtë dhe të vdesë atje, nga ku unë s'mund ta nxjerr dot. Së shpejti do fillojë të sillet rrotull dhe atëhere duhet të nis unë nga puna. Çuditë, ç'pësoi kështu papritur? Ndoshta ishte shumë i uritur, dhe kjo e dëshpëroi, apo mos e trembi ndonjë gjë në errësirë? Mbase papritur e ka zënë frika. Por ai ishte një peshk kaq i qetë, i fortë, dhe dukej aq i patrembur dhe me besim të madh. E çuditshme është.

Në **paragrafin e treqindëntëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 26 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 38 fjalë, 12 fjalë më shumë.

Krahaso:

“You better be fearless and confident yourself, old man,” he said. “You’re holding him again but you cannot get line. But soon he has to circle.”

- Ti më mirë bëhu vetë më guximtar dhe ki më shumë besim te vetja, o plak, - tha. - Ti po e mban përsëri, por fillin nuk ia tërheq dot prapë. Veçse së shpejti, ai do fillojë të sillet përçark.

Në **paragrafin e treqindëntëdhjetënjëtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 112 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 110 fjalë, 2 fjalë më pak.

Krahaso:

The old man held him with his left hand and his shoulders now and stooped down and scooped up water in his right hand to get the crushed dolphin flesh off of his face. He was afraid that it might nauseate him and he would vomit and lose his strength. When his face was cleaned he washed his right hand in the water over the side and then let it stay in the salt water while he watched the first light come before the sunrise. He’s headed almost east, he thought. That means he is tired and going with the current. Soon he will have to circle. Then our true work begins.

Plaku e mbante tani litarin me dorën e majtë dhe me shpatulla, dhe u ul e mori ujë me dorën e djathtë që të lante fytyrën nga mishi i makrelit. Pati frikë se mos i vinte ndot dhe villte, dhe kështu humbte fuqinë. Pasi e pastroi fytyrën, lau dorën e djathtë në det duke u përkulur, dhe e la një copë herë në ujin e kripur, ndërsa po vështronte se si zbardhëllonte qielli përpara lindjes së diellit; Peshku ecën pothuaj drejt lindjes, mendoi. Kjo do të thotë se ai është kapitur dhe po shkon pas rrymës. Së shpejti do të fillojë të vijë rrotull. Ahere fillon puna jonë e vërtetë.

Në **paragrafin e treqindëntëdhjetedytë** autori i tekstit burimor ka përdorur 22 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 23 fjalë, 1 fjalë më shumë.

Krahaso:

After he judged that his right hand had been in the water long enough he took it out and looked at it.

Pas kësaj, ai mendoi se dora e tij e djathtë kish qëndruar mjaft kohë në ujë dhe prandaj e nxori dhe e pa.

Në **paragrafin e treqindenëntëdhjetetretë** autori i tekstit burimor ka përdorur 14 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 10 fjalë, 4 fjalë më pak.

Krahaso:

“It is not bad,” he said. “And pain does not matter to a man.”

- S’është keq, - tha. - Dhe dhimbja nuk i bën përshtypje burrit.

Në **paragrafin e treqindenëntëdhjetekatërt** autori i tekstit burimor ka përdorur 42 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 41 fjalë, 1 fjalë më pak.

Krahaso:

He took hold of the line carefully so that it did not fit into any of the fresh line cuts and shifted his weight so that he could put his left hand into the sea on the other side of the skiff.

E mbajti litarin me kujdes, në mënyrë që të mos i lëndonte të prerat e freskëta të dorës, dhe peshën e mbajti me trup, që të mund të fuste dhe dorën e majtë në det, nga ana tjetër e barkës.

Në **paragrafin e treqindenëntëdhjetepesë** autori i tekstit burimor ka përdorur 26 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 33 fjalë, 7 fjalë më shumë.

Krahaso:

“You did not do so badly for something worthless,” he said to his left hand. “But there was a moment when I could not find you.”

- Në krahasim me atë që mund të presë njeriu nga një mizerje si ti, nuk u solle keq, - i tha plaku dorës së majtë. - Por pate një çast kur më le në baltë.

Në **paragrafin e treqindenëntëdhjetegjashtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 58 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 64 fjalë, 6 fjalë më shumë.

Krahaso:

Why was I not born with two good hands? he thought. Perhaps it was my fault in not training that one properly. But God knows he has had enough chances to learn. He did not do so badly in the night, though, and he has only cramped once. If he cramps again let the line cut him off.

Përse nuk kam lindur me dy duar të mira? Mendoj. Mbase është faji im që nuk e kam stërvitur siç duhet. Por e di Perëndia se sa herë pati rast ajo që të mësonte, dhe nuk deshi. Megjithatë, natën nuk u soll kaq keq dhe vetëm një herë u mpi. Në qoftë se do të mpihet përsëri, le ta presë më mirë litari.

Në **paragrafin e treqindëntëdhjeteshtatë** autori i tekstit burimor ka përdorur 92 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 105 fjalë, 13 fjalë më shumë.

Krahaso:

When he thought that he knew that he was not being clear-headed and he thought he should chew some more of the dolphin. But I can't, he told himself. It is better to be light-headed than to lose your strength from nausea. And I know I cannot keep it if I eat it since my face was in it. I will keep it for an emergency until it goes bad. But it is too late to try for strength now through nourishment. You're stupid, he told himself. Eat the other flying fish.

Kur mendoj këto, plaku e kuptoi se filloi t'i turbullohej koka dhe tha me vete se duhej të kish ngrënë ca më shumë nga mishi i makrelit. Por nuk mundem, i tha vetes. Më mirë ta kem kokën turbull, sesa të humbas fuqinë nga të vjellët. Dhe unë e di se nuk do të ma mbajë stomaku, në qoftë se ha mishin që më ishte shtypur në fytyrë. Do ta ruaj për kohë më të keqe, derisa të mos jetë prishur. Por tani gjithashtu është vonë që të përpiqem të shtoj fuqinë me të ngrënë. Ti je budalla, i tha vetes. Ha peshkun tjetër fluturues.

Në **paragrafin e treqindëntëdhjetetete** autori i tekstit burimor ka përdorur 31 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 29 fjalë, 2 fjalë më pak.

Krahaso:

It was there, cleaned and ready, and he picked it up with his left hand and ate it chewing the bones carefully and eating all of it down to the tail.

E kish përpara të qëruar dhe gati, e ngriti me dorën e majtë dhe e hëngri duke pështyrë halat me kujdes, derisa e mbaroi të tërë, gjerë te bishti.

Në **paragrafin e treqindëntëdhjetenëntë** autori i tekstit burimor ka përdorur 38 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 43 fjalë, 5 fjalë më shumë.

Krahaso:

It has more nourishment than almost any fish, he thought. At least the kind of strength that I need. Now I have done what I can, he thought. Let him begin to circle and let the fight come.

Ky ka më tepër ushqim se çdo peshk tjetër pothuaj, mendoj plaku. Së paku ka atë lloj fuqie që më duhet mua. Tani atë që munda ta bëj, e bëra. Le të fillojë tani

ai të vijë rrotull dhe le të nisë lufta.

Në **paragrafin e katërqindtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 20 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 22 fjalë, 2 fjalë më shumë.

Krahaso:

The sun was rising for the third time since he had put to sea when the fish started to circle.

Dielli po ngrihej për të tretën herë që nga koha që plaku kish dalë në det, kur peshku filloi të vijë përçark.

Në **paragrafin e katërqindnjëtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 123 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 108 fjalë, 15 fjalë më pak.

Krahaso:

He could not see by the slant of the line that the fish was circling. It was too early for that. He just felt a faint slackening of the pressure of the line and he commenced to pull on it gently with his right hand. It tightened, as always, but just when he reached the point where it would break, line began to come in. He slipped his shoulders and head from under the line and began to pull in line steadily and gently. He used both of his hands in a swinging motion and tried to do the pulling as much as he could with his body and his legs. His old legs and shoulders pivoted with the swinging of the pulling.

Plaku nuk mundi të kuptonte nga këndi i litarit mbi faqen e detit, nëse peshku kish filluar të vijë rrotull. Ishte herët ende për këtë gjë. Porsa ndjeu që tërheqja e litarit u dobësua pak, filloi ta tërhiqte ngadalë me dorën e djathtë. Litari u tendos si zakonisht, por, kur qe gati të këputej, nisi të mblidhej përsëri. Plaku kaloi duke rrëshqitur supet dhe kryet nën litar dhe zuri të tërheqë ngadalë dhe pa ngut. Ai përdorte të dyja duart, duke i lëvizur bashkë dhe përpiquej të tërhiqte sa mundte me ndihmën e trupit dhe të këmbëve. Këmbët e tij të plakura dhe shpatullat ndihmonin lëvizjet dhe tërheqjen.

Në **paragrafin e katërqindedytë** autori i tekstit burimor ka përdorur 12 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 13 fjalë, 1 fjalë më shumë.

Krahaso:

"It is a very big circle," he said. "But he is circling."

- Po bën një rreth shumë të madh, - tha ai. - Por sidoqoftë vjen përçark.

Në **paragrafin e katërqindtretë** autori i tekstit burimor ka përdorur 44 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 51 fjalë, 7 fjalë më shumë.

Krahaso:

Then the line would not come in any more and he held it until he saw the drops jumping from it in the sun. Then it started out and the old man knelt down and let it go grudgingly back into the dark water.

Pastaj litari filloi të mos mblidhej më, dhe ai e mbajti, gjersa pa pikat e ujit që kërcyen rreth tij e shndëritën në diell. Pastaj litari nisi të zbresë përsëri në det, dhe plaku u ul në gjunjë dhe e la të rrëshqiste, me zemër të thyer, në ujët e zi.

Në **paragrafin e katërqindekatërt** autori i tekstit burimor ka përdorur 47 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 45 fjalë, 2 fjalë më pak.

Krahaso:

“He is making the far part of his circle now,” he said. I must hold all I can, he thought. The strain will shorten his circle each time. Perhaps in an hour I will see him. Now I must convince him and then I must kill him.

- Tani po bën pjesën më të largët të rrethit, - tha plaku. Duhet ta mbaj sa të mund, mendoi. Po ta tendos litarin, do t’ia zvogëloj rrethin. Mbase do ta shikoj pas ndonjë ore. Tani duhet ta bind për forcën time dhe pastaj ta vras.

Në **paragrafin e katërqindepestë** autori i tekstit burimor ka përdorur 49 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 46 fjalë, 3 fjalë më pak.

Krahaso:

But the fish kept on circling slowly and the old man was wet with sweat and tired deep into his bones two hours later. But the circles were much shorter now and from the way the line slanted he could tell the fish had risen steadily while he swam.

Por peshku vazhdoi të vinte rrotull ngadalë edhe dy orë më vonë dhe plaku ishte qullur në djersë dhe ish rraskapitur e i dhimbnin kockat. Veçse tani rrathët sa vinin zvogëloheshin dhe nga prerja e litarit mbi det dukej që peshku ngrihej pa pushim ndërsa notonte.

Në **paragrafin e katërqindegjashtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 65 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 60 fjalë, 5 fjalë më pak.

Krahaso:

For an hour the old man had been seeing black spots before his eyes and the sweat salted his eyes and salted the cut over his eye and on his forehead. He was not afraid of the black spots. They were normal at the tension that he was pulling on the line. Twice, though, he had felt faint and dizzy and that had worried him.

Kish një orë që plakut i bëheshin njolla të zeza para syve dhe djersa i digjte sytë, i digjte plagët sipër syrit dhe në ballë. Njollat e zeza nuk e trembnin plakun. Ato ishin të natyrshme për një trysni të tillë, në të cilën ai punonte. Por dy herë rresht ndjeu dobësi dhe iu morën mendtë dhe kjo e shqetësoi.

Në **paragrafin e katërqindestatë** autori i tekstit burimor ka përdorur 43 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 48 fjalë, 5 fjalë më shumë.

Krahaso:

"I could not fail myself and die on a fish like this," he said. "Now that I have him coming so beautifully, God help me endure. I'll say a hundred Our Fathers and a hundred Hail Marys. But I cannot say them now.

- Nuk mund ta lëshoj veten dhe të vdes për një peshk të tillë, - tha ai. Tani që punën e solla kaq bukur, Zoti do të më ndihmojë. Do të them njëqind herë lutjen "Ati ynë" dhe njëqind here lutjen e Shën Mërisë. Veçse nuk mund t'i them tani.

Në **paragrafin e katërqindtetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 9 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 11 fjalë, 2 fjalë më shumë.

Krahaso:

Consider them said, he thought. I'll say them later.

E zëmë se i thashë, mendoi. Do t'i them më vonë.

Në **paragrafin e katërqindnëntë** autori i tekstit burimor ka përdorur 25 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 29 fjalë, 4 fjalë më shumë.

Krahaso:

Just then he felt a sudden banging and jerking on the line he held with his two hands. It was sharp and hard-feeling and heavy.

Në atë çast ndjeu një goditje të papritur dhe një dridhje të litarit që e mbante me të dyja duart. Goditja ishte e mprehtë, e fortë dhe e rëndë.

Në **paragrafin e katërqindedhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 63 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 71 fjalë, 8 fjalë më shumë.

Krahaso:

He is hitting the wire leader with his spear, he thought. That was bound to come. He had to do that. It may make him jump though and I would rather he stayed circling now. The jumps were necessary for him to take air. But after that each one can widen the opening of the hook wound and he can throw the hook.

Po e godet fillin, ku është lidhur grepi, me shpatën e tij, mendoi plaku. Këtë gjë e prisja. Ai duhej ta bënte këtë gjë. Kjo mund ta bëjë që të hidhet, ndonëse do të ishte më mirë të vinte ende rrotull. Kërcimet janë të domosdoshme për të, që të mbushet me ajër. Por pas çdo kërcimi, mund t'i zgjerohet plaga që i ka bërë grepi dhe mund të shkëputet prej tij.

Në **paragrafin e katërqindnjëmbëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 7 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 9 fjalë, 2 fjalë më shumë.

Krahaso:

“Don’t jump, fish,” he said. “Don’t jump.”

- Mos u hidh, peshk, - tha ai. - Mos u hidh.

Në **paragrafin e katërqindedymbëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 23 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 19 fjalë, 4 fjalë më pak.

Krahaso:

The fish hit the wire several times more and each time he shook his head the old man gave up a little line.

Peshku e goditi fillin edhe disa herë akoma dhe çdo herë, pasi tundte kokën, plaku lëshonte nga pak litar.

Në **paragrafin e katërqindetrembëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 25 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 26 fjalë, 1 fjalë më shumë.

Krahaso:

I must hold his pain where it is, he thought. Mine does not matter. I can control mine. But his pain could drive him mad.

Nuk duhet t’ia shtoj dhimbjen, mendoi. Dhimbja ime s’ka rëndësi. Unë mund ta përmbaj veten. Por dhimbja e tij mund ta bëjë peshkun si të marrë.

Në **paragrafin e katërqindekatëmbëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 55 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 49 fjalë, 6 fjalë më pak.

Krahaso:

After a while the fish stopped beating at the wire and started circling slowly again. The old man was gaining line steadily now. But he felt faint again. He lifted some sea water with his left hand and put it on his head. Then he put more on and rubbed the back of his neck.

Pas pak, peshku pushoi së godituri fillin, dhe filloi përsëri të vinte rrotull ngadalë. Tani plaku po e mbledhte litarin pak nga pak. Por përsëri ndjeu një dobësi. Mori ca ujë deti me dorën e majtë dhe lagu kokën. Pastaj e lagu edhe më tepër kokën dhe fshiu qafën.

Në **paragrafin e katërqindepesëmbëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 23 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 33 fjalë, 10 fjalë më shumë.

Krahaso:

“I have no cramps,” he said. “He’ll be up soon and I can last. You have to last. Don’t even speak of it.”

- Tani nuk kam më ngërç, - tha. - Së shpejti ai do të dalë mbi sipërfaqe dhe unë mund të mbahem ende. Ti duhet të mbahesh. As mos guxo të mendosh se s’mund të mbahesh.

Në **paragrafin e katërqindëgjatëmbëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 40 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 43 fjalë, 3 fjalë më shumë.

Krahaso:

He kneeled against the bow and, for a moment, slipped the line over his back again. I’ll rest now while he goes out on the circle and then stand up and work on him when he comes in, he decided.

U ul në gjunjë te bashi dhe për një çast e kaloi litarin përsëri në shpinë. Do të çlodhem në kohën që peshku vjen rrotull, dhe pastaj kur të më afrohet, do të çohem dhe do të filloj nga puna, vendosi me vete.

Në **paragrafin e katërqindëstetëmbëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 60 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 67 fjalë, 7 fjalë më shumë.

Krahaso:

It was a great temptation to rest in the bow and let the fish make one circle by himself without recovering any line. But when the strain showed the fish had turned to come toward the boat, the old man rose to his feet and started the pivoting and the weaving pulling that brought in all the line he gained.

Kishte dëshirë të madhe të çlodhej te bashi dhe ta linte peshkun të bënte një rreth të tepërt, pa e mbledhur litarin. Por kur tendosja e litarit e lajmëroi se peshku u kthye dhe po vinte drejt barkës, plaku u ngrit në këmbë dhe filloi ta tërhiqte litarin duke punuar me të dyja duart me radhë dhe duke lëvizur trupin, në mënyrë që ta mblidhte të gjithë.

Në **paragrafin e katërqindëtetëmbëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 30 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 31 fjalë, 1 fjalë më shumë.

Krahaso:

I’m tiredder than I have ever been, he thought, and now the trade wind is rising. But that will be good to take him in with. I need that badly.

Kurrë s'jam lodhur ndonjëherë kaq shumë në jetën time, mendoj, dhe tani u ngrit dhe erë. Por era do më ndihmojë ta çoj peshkun në breg. Kam shumë nevojë për erën.

Në **paragrafin e katërqindentëmbëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 27 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 28 fjalë, 1 fjalë më shumë.

Krahaso:

"I'll rest on the next turn as he goes out," he said. "I feel much better. Then in two or three turns more I will have him."

- Do të çlodhem kur peshku të fillojë rrethin tjetër, - tha. - E ndjej veten shumë mirë. Pastaj, dy a tre rrrathë të tjerë dhe peshku do të jetë i imi.

Në **paragrafin e katërqindnjëzetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 30 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 23 fjalë, 7 fjalë më pak.

Krahaso:

His straw hat was far on the back of his head and he sank down into the bow with the pull of the line as he felt the fish turn.

Kësula prej kashte i qe rrasur gjerë në qafë dhe kur peshku e tërhoqi përsëri litarin, plaku u rrëzua mbi bashin e barkës.

Në **paragrafin e katërqindnjëzetënjëtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 12 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 12 fjalë, numër të barabartë fjalësh.

Krahaso:

You work now, fish, he thought. I'll take you at the turn.

Tani puno ti, peshk, mendoj. Kur të kthehesh, do merrem me ty.

Në **paragrafin e katërqindnjëzetedytë** autori i tekstit burimor ka përdorur 20 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 25 fjalë, 5 fjalë më shumë.

Krahaso:

The sea had risen considerably. But it was a fair-weather breeze and he had to have it to get home.

Deti nisi të bëjë valë të mëdha. Por frynte era që paralajmëronte mot të mirë dhe që atij i duhej për t'u kthyer në shtëpi.

Në **paragrafin e katërqindenjzetedytë** autori i tekstit burimor ka përdorur 21 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 21 fjalë, numër të barabartë fjalësh.

Krahaso:

“I’ll just steer south and west,” he said. “A man is never lost at sea and it is a long island.”

- Do të lundroj nga jugu dhe nga perëndimi, - tha. - Njeriu nuk humbet kurrë në det dhe ishulli ynë është i gjatë.

Në **paragrafin e katërqindenjzete katërt** autori i tekstit burimor ka përdorur 12 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 10 fjalë, 2 fjalë më pak.

Krahaso:

It was on the third turn that he saw the fish first.

Peshku po bënte rrethin e tretë kur plaku e pa.

Në **paragrafin e katërqindenjzete pestë** autori i tekstit burimor ka përdorur 24 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 23 fjalë, 1 fjalë më pak.

Krahaso:

He saw him first as a dark shadow that took so long to pass under the boat that he could not believe its length.

Në fillim pa një si hije të zezë që kaloi nën barkë, dhe iu duk aq e gjatë, sa që nuk u besoi syve.

Në **paragrafin e katërqindenjzete gjashtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 8 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 8 fjalë, numër të barabartë fjalësh.

Krahaso:

“No,” he said. “He can’t be that big.”

- Jo, - tha. - S’mund të jetë kaq i madh.

Në **paragrafin e katërqindenjzete shtatë** autori i tekstit burimor ka përdorur 87 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 96 fjalë, 9 fjalë më shumë.

Krahaso:

But he was that big and at the end of this circle he came to the surface only thirty yards away and the man saw his tail out of water. It was higher than a big scythe

blade and a very pale lavender above the dark blue water. It raked back and as the fish swam just below the surface the old man could see his huge bulk and the purple stripes that banded him. His dorsal fin was down and his huge pectorals were spread wide.

Por ai ishte aq i madh saç iu duk, dhe kur mbaroi rrethin e tretë, doli në sipërfaqe, gjithësej tridhjetë jardë larg nga barka, dhe plaku pa bishtin e tij mbi ujë. Bishti ishte më i lartë se një kosë dhe me një ngjyrë vjollcë të zbehtë, mbi ujin mavi të errët. Ai u zhduk përsëri, dhe kur peshku notoi në një thellësi të vogël, plaku mundi të shikonte gjoksin e tij të madh dhe vijat ngjyrë jargavani mbi të. Fletën e kurrizit e kish të ulur, kurse fletët e mëdha të kraharorit i kish të shtrira.

Në **paragrafin e katërqindnjëzetetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 58 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 54 fjalë, 4 fjalë më pak.

Krahaso:

On this circle the old man could see the fish's eye and the two gray sucking fish that swam around him. Sometimes they attached themselves to him. Sometimes they darted off. Sometimes they would swim easily in his shadow. They were each over three feet long and when they swam fast they lashed their whole bodies like eels.

Kur peshku bënte rrethin, plaku mundi t'i shikonte syri dhe dy peshq të vegjël të hirtë që notonin rreth tij. Nganjëherë i qepeshin dhe s'i ndaheshin. Nganjëherë iknin me shpejtësi. Nganjëherë notonin plot gëzim nën hijen e tij. Ata ishin nga tre këmbë të gjatë secili dhe kur notonin shpejt, përdridhnin trupin si ngjalë.

Në **paragrafin e katërqindnjëzetënëntë** autori i tekstit burimor ka përdorur 44 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 40 fjalë, 4 fjalë më pak.

Krahaso:

The old man was sweating now but from something else besides the sun. On each calm placid turn the fish made he was gaining line and he was sure that in two turns more he would have a chance to get the harpoon in.

Plaku qe mbytur në djersë dhe jo vetëm nga dielli. Në çdo rreth të ri që peshku e bënte i qetë, ai mblidhte litarin dhe ishte i sigurt se pas dy rrathëve të tjerë do të mund t'i ngulte fuzhnjën.

Në **paragrafin e katërqindtridhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 21 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 19 fjalë, 2 fjalë më pak.

Krahaso:

But I must get him close, close, close, he thought. I mustn't try for the head. I must get the heart.

Veçse duhet ta sjell afër, afër, afër, mendoi. Nuk duhet ta godas në kokë. Duhet ta godas në zemër.

Në **paragrafin e katërqindetridhjetenjë** autori i tekstit burimor ka përdorur 8 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 9 fjalë, 1 fjalë më shumë.

Krahaso:

“Be calm and strong, old man,” he said.

- Bëhu i qetë dhe i fortë, o plak, - tha.

Në **paragrafin e katërqindetridhjetedytë** autori i tekstit burimor ka përdorur 53 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 48 fjalë, 5 fjalë më pak.

Krahaso:

On the next circle the fish’s beck was out but he was a little too far from the boat. On the next circle he was still too far away but he was higher out of water and the old man was sure that by gaining some more line he could have him alongside.

Në rrethin tjetër u duk shpina e peshkut, por ai ishte ende larg nga barka. Në rrethin tjetër ishte përsëri larg, por kishte dalë më shumë mbi ujë dhe plaku qe i sigurt se po të mblidhte dhe pak litar do ta sillte peshkun te buza e barkës.

Në **paragrafin e katërqindetridhjetetretë** autori i tekstit burimor ka përdorur 30 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 28 fjalë, 2 fjalë më pak.

Krahaso:

He had rigged his harpoon long before and its coil of light rope was in a round basket and the end was made fast to the bitt in the bow.

Fuzhnjën e kish bërë gati shumë kohë më parë dhe fundin e lëmshit të litarit të hollë që ishte në shportë e kishte lidhur te hallka e bashit.

Në **paragrafin e katërqindetridhjetekatërt** autori i tekstit burimor ka përdorur 53 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 52 fjalë, 1 fjalë më pak.

Krahaso:

The fish was coming in on his circle now calm and beautiful looking and only his great tail moving. The old man pulled on him all that he could to bring him closer. For just a moment the fish turned a little on his side. Then he straightened himself and began another circle.

Peshku po afrohej duke u sjellë rrotull i qetë dhe me pamje të bukur, duke tundur vetëm bishtin e madh. Plaku e tërhoqi sa mundi, që ta sillte sa më pranë. Për një çast të vetëm, peshku u kthye në ije. Pastaj e drejtoi trupin dhe filloi të

bëjë një tjetër rreth.

Në **paragrafin e katërqindetridhjetepestë** autori i tekstit burimor ka përdorur 11 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 10 fjalë, 1 fjalë më pak.

Krahaso:

“I moved him,” the old man said. “I moved him then.”

- E lëviza, - tha plaku. - E bëra të kthehej në ije.

Në **paragrafin e katërqindetridhjetegjashtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 54 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 53 fjalë, 1 fjalë më pak.

Krahaso:

He felt faint again now but he held on the great fish all the strain that he could. I moved him, he thought. Maybe this time I can get him over. Pull, hands, he thought. Hold up, legs. Last for me, head. Last for me. You never went. This time I'll pull him over.

Ai ndjeu përsëri një ligështi në trup, por tani e mbante peshkun e madh duke tendosur litarin me gjithë fuqinë. E lëviza, mendoi. Mbase këtë herë e bëj të kthehet në shpinë. Tërhiqni, duar, mendoi. Mbamëni këmbë. Mos më lër, kokë. Shërbemë. Asnjëherë s' më ke lënë. Këtë here do ta kthej në shpinë.

Në **paragrafin e katërqindetridhjeteshtatë** autori i tekstit burimor ka përdorur 54 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 53 fjalë, 1 fjalë më pak.

Krahaso:

But when he put all of his effort on, starting it well out before the fish came alongside and pulling with all his strength, the fish pulled part way over and then righted himself and swam away.

Por, kur ai vazhdonte të shtrëngonte të gjithë muskujt për ta tërhequr sërish, pa u afruar mirë, peshku lëvizi pak në ije dhe pastaj e drejtoi trupin dhe iku më tej.

Në **paragrafin e katërqindetridhjetetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 21 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 22 fjalë, 1 fjalë më shumë.

Krahaso:

“Fish,” the old man said. “Fish, you are going to have to die anyway. Do you have to kill me too?”

- Peshk, - tha plaku. - Ti për të vdekur që për të vdekur ke. Mos vallë do që edhe unë të vdes me ty?

Në **paragrafin e katërqindetridhjetenëntë** autori i tekstit burimor ka përdorur 50 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 58 fjalë, 8 fjalë më shumë.

Krahaso:

That way nothing is accomplished, he thought. His mouth was too dry to speak but he could not reach for the water now. I must get him alongside this time, he thought. I am not good for many more turns. Yes you are, he told himself. You're good for ever.

Kështu si e kam zënë s'kam gjë në vijë, mendoi. Goja i qe tharë, saqë nuk fliste dot dhe nuk mundte as të arrinte shishen e ujit. Duhet ta afroj te buza e barkës këtë here, mendoi. S'do kem fuqi, po të vazhdojë dhe ca. Jo, do të kesh, i tha vetes. Ti ke fuqi për tërë jetën.

Në **paragrafin e katërqindedyzetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 18 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 17 fjalë, 1 fjalë më pak.

Krahaso:

On the next turn, he nearly had him. But again the fish righted himself and swam slowly away.

Në rrotullimin tjetër plaku pothuaj e afroi. Por peshku e drejtoi përsëri trupin dhe notoi ngadalë tutje.

Në **paragrafin e katërqindedyzetënjëtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 46 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 53 fjalë, 7 fjalë më shumë.

Krahaso:

You are killing me, fish, the old man thought. But you have a right to. Never have I seen a greater, or more beautiful, or a calmer or more noble thing than you, brother. Come on and kill me. I do not care who kills who.

Peshk, ti po më merr në qafë, mendoi plaku. Por ti e ke gjithashtu këtë të drejtë. Kurrë nuk kam parë në jetë gjë më të madhërishme, më të bukur, më të qetë dhe më fisnike se ti, vëlla. Eja dhe vramë. Mua aq më bën kush nga ne do ta vrasë shoku-shokun.

Në **paragrafin e katërqindedyzetedytë** autori i tekstit burimor ka përdorur 33 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 24 fjalë, 9 fjalë më pak.

Krahaso:

Now you are getting confused in the head, he thought. You must keep your head clear. Keep your head clear and know how to suffer like a man. Or a fish, he thought.

Përsëri t'u turbullua koka, mendoi. Duhet ta kesh kokën të kthjellët. Ruaj kthjelltësinë e mendjes dhe duroji vuajtjet si burrë. Ose si peshk, mendoi.

Në **paragrafin e katërqindëzetetretë** autori i tekstit burimor ka përdorur 14 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 16 fjalë, 2 fjalë më shumë.

Krahaso:

“Clear up, head,” he said in a voice he could hardly hear. “Clear up.”

- Kthjellohu kokë, - tha me zë të atillë, saqë mezi e dëgjoji dhe vetë. - Kthjellohu të them.

Në **paragrafin e katërqindëzetekatërt** autori i tekstit burimor ka përdorur 40 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 34 fjalë, 6 fjalë më pak.

Krahaso:

Twice more it was the same on the turns. I do not know, the old man thought. He had been on the point of feeling himself go each time. I do not know. But I will try it once more.

Gjatë dy rrotullimeve të tjera, nuk ndodhi gjë. Nuk di si t'ia bëj, mendoi plaku. Çdo herë dukej se do t'i binte të fikët. S'di ç'të bëj. Por do ta provoj edhe një herë.

Në **paragrafin e katërqindëzetepestë** autori i tekstit burimor ka përdorur 32 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 35 fjalë, 3 fjalë më shumë.

Krahaso:

He tried it once more and he felt himself going when he turned the fish. The fish righted himself and swam off again slowly with the great tail weaving in the air.

E provoi dhe një here dhe e ndjeu se po i binte të fikët, ndërsa po e kthente peshkun. Peshku drejtoi trupin dhe notoi përsëri ngadalë me bishtin e madh që e tundte në erë.

Në **paragrafin e katërqindëzetegjastë** autori i tekstit burimor ka përdorur 22 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 17 fjalë, 5 fjalë më pak.

Krahaso:

I'll try it again, the old man promised, although his hands were mushy now and he could only see well in flashes.

Do ta provoj përsëri, mendoi plaku, megjithëse duart i qenë mpirë krejt dhe në sy kish mjegull.

Në **paragrafin e katërqindedyzeteshtatë** autori i tekstit burimor ka përdorur 26 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 28 fjalë, 2 fjalë më shumë.

Krahaso:

He tried it again and it was the same. So he thought, and he felt himself going before he started; I will try it once again.

E provoi prapë dhe ndodhi e njëjta gjë. Kështu, mendoi, e ndjeu se po e linte jeta, përpara se të mendonte: unë do ta provoj dhe një herë.

Në **paragrafin e katërqindedyzetetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 67 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 75 fjalë, 8 fjalë më shumë.

Krahaso:

He took all his pain and what was left of his strength and his long gone pride and he put it against the fish's agony and the fish came over onto his side and swam gently on his side, his bill almost touching the planking of the skiff and started to pass the boat, long, deep, wide, silver and barred with purple and interminable in the water.

Mblodhi të gjithë dhimbjen dhe gjithçka që i kish mbetur nga fuqia e tij, dhe krenarinë që e kish humbur prej kohësh, dhe ia vuri përballë agonisë së peshkut, dhe peshku u kthye në ije dhe zuri të notojë ngadalë, mënjanë, me bishtin që pothuajse prekte dërrasat e barkës, dhe pastaj zuri të kalojë përmbri barkës, i gjatë, i lartë, i gjerë, i argjendtë dhe plot vija ngjyrë vjollcë dhe dukej sikur s'kish të mbaruar.

Në **paragrafin e katërqindedyzetënëntë** autori i tekstit burimor ka përdorur 82 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 79 fjalë, 3 fjalë më pak.

Krahaso:

The old man dropped the line and put his foot on it and lifted the harpoon as high as he could and drove it down with all his strength, and more strength he had just summoned, into the fish's side just behind the great chest fin that rose high in the air to the altitude of the man's chest. He felt the iron go in and he leaned on it and drove it further and then pushed all his weight after it.

Plaku lëshoi fillin, i vuri këmbën sipër dhe ngriti fuzhnjën aq lart sa mundi dhe me gjithë fuqinë që kish dhe fuqinë që mundi të mbledhë në atë çast, e nguli në ijen e peshkut, mu prapa fletës së madhe të gjoksit që ngrihej e lartë sa një shtat njeriu. Ai e ndjeu se si hekuri hyri në mish dhe u mbështet mbi të dhe e futi ende më thellë, duke rënduar me gjithë peshën e trupit mbi fuzhnjën.

Në **paragrafin e katërqindepesëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 67 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 51 fjalë, 16 fjalë më pak.

Krahaso:

Then the fish came alive, with his death in him, and rose high out of the water showing all his great length and width and all his power and his beauty. He seemed to hang in the air above the old man in the skiff. Then he fell into the water with a crash that sent spray over the old man and over all of the skiff.

Ahere peshku u gjallërua, megjithëse kishte vdekur brenda, dhe u ngrit lart mbi ujë, duke treguar gjithë gjatësinë dhe gjerësinë, dhe gjithë forcën dhe bukurinë e tij. U duk sikur që varur në erë përmbi plakun dhe barkën. Pastaj ra në ujë me zhurmë, duke qullur me stërkla barkën dhe plakun.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjetenjtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 109 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 102 fjalë, 7 fjalë më pak.

Krahaso:

The old man felt faint and sick and he could not see well. But he cleared the harpoon line and let it run slowly through his raw hands and, when he could see, he saw the fish was on his back with his silver belly up. The shaft of the harpoon was projecting at an angle from the fish's shoulder and the sea was discolouring with the red of the blood from his heart. First it was dark as a shoal in the blue water that was more than a mile deep. Then it spread like a cloud. The fish was silvery and still and floated with the waves.

Plaku ndjeu dobësi të madhe dhe i vinte për të vjellë dhe sytë nuk i shikonin pothuaj fare. Por ai lëshoi litarin e fuzhnjës dhe e la të rrëshqasë midis duarve të plagosura, dhe kur iu kthye përsëri shikimi, pa se peshku ishte kthyer në shpinë me barkun e argjendtë lart. Dorëza e fuzhnjës rrinte pjerrtas mbi shpatull dhe deti që skuqur nga gjaku i zemrës së peshkut. Në fillim njolla ishte e errët, sikur uji i kaltër që mbushur me peshq një milje thellë. Pastaj njolla u hap si një re. Peshku dukej ende i argjendtë dhe lëkundej mbi valët.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjetedytë** autori i tekstit burimor ka përdorur 35 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 28 fjalë, 7 fjalë më pak.

Krahaso:

The old man looked carefully in the glimpse of vision that he had. Then he took two turns of the harpoon line around the bitt in the bow and hid his head on his hands.

Plaku e shikonte me kujdes me sytë e mjegulluar. Pastaj e mbështolli dy herë litarin e fuzhnjës te hallka e bashit dhe e mbështeti kokën mbi dorë.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjetetretë** autori i tekstit burimor ka përdorur 36 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 36 fjalë, numër të barabartë fjalësh.

Krahaso:

“Keep my head dear,” he said against the wood of the bow. “I am a tired old man. But I have killed this fish which is my brother and now I must do the slave work.”

- Mos m’u turbullo moj kokë, - tha me ballin e mbështetur te dërrasat e bashit. - Jam një plak i rraskapitur. Por e vrava këtë peshk që e kisha si vëlla dhe tani duhet të punoj si skllav.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjetekatërt** autori i tekstit burimor ka përdorur 57 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 79 fjalë, domethënë, 22 fjalë më shumë.

Krahaso:

Now I must prepare the nooses and the rope to lash him alongside, he thought. Even if we were two and swamped her to load him and bailed her out, this skiff would never hold him. I must prepare everything, then bring him in and lash him well and step the mast and set sail for home.

Tani duhet të përgatis litarët dhe të bëj nyjet, që ta lidh peshkun te buza e barkës, mendoi. Madje dhe sikur të ishim dy veta dhe sikur ta ulnim barkën nën ujë për të ngarkuar peshkun dhe pastaj të nxirrnim ujin përsëri, kjo barkë nuk do ta mbante dot peshën e tij. Duhet të përgatis çdo gjë, pastaj ta afrojmë peshkun dhe ta lidh mirë e mirë dhe të ngre direkun me pëlhurën dhe të nisem për në shtëpi.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjetepestë** autori i tekstit burimor ka përdorur 107 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 98 fjalë, domethënë, 9 fjalë më pak.

Krahaso:

He started to pull the fish in to have him alongside so that he could pass a line through his gills and out his mouth and make his head fast alongside the bow. I want to see him, he thought, and to touch and to feel him. He is my fortune, he thought. But that is not why I wish to feel him. I think I felt his heart, he thought. When I pushed on the harpoon shaft the second time. Bring him in now and make him fast and get the noose around his tail and another around his middle to bind him to the skiff.

Filloi ta tërhiqte peshkun për ta afruar te buza e barkës, në mënyrë që të mund t’i fuste litarin midis verzave dhe qafës, dhe t’ia lidhte kokën te bashi. Dua ta shikoj, mendoi, dhe ta prek me dorë dhe ta marr vesh si është. Ai është pasuria ime. Por nuk dua ta prek për këtë arsye. Besoj se ia kam prekur zemrën, mendoi, atëherë kur i futa majën e fuzhnjës për herë të dytë. Afroje tani dhe lidhe duke i bërë një nyje pranë bishtit dhe një tjetër në mes të trupit, që ta puthitësh mirë pas barkës.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjetegjashtë** autori i tekstit burimor ka përdorur 31 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 24 fjalë, domethënë, 7 fjalë më pak.

Krahaso:

“Get to work, old man,” he said. He took a very small drink of the water. “There is very much slave work to be done now that the fight is over.”

- Jepi plak, - tha. Mori shishen dhe piu një gllënjë të vogël uji. - Tani që lufta mbaroi, duhet të bëj një punë si prej skllavi.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjeteshtatë** autori i tekstit burimor ka përdorur 50 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 45 fjalë, domethënë, 5 fjalë më pak.

Krahaso:

He looked up at the sky and then out to his fish. He looked at the sun carefully. It is not much more than noon, he thought. And the trade wind is rising. The lines all mean nothing now. The boy and I will splice them when we are home.

Ai hodhi sytë lart në qiell dhe pastaj vështroi peshkun. Pastaj vështroi diellin me vëmendje. S’ka shumë kohë që ka kaluar dreka, mendoi. Dhe filloi të ngrihet erë. Fijet tani s’ka nevojë t’i rregulloj. Do t’i ngjitim me djalin bashkë, kur të kthehem në shtëpi.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjetetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 30 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 27 fjalë, domethënë, 2 fjalë më pak.

Krahaso:

“Come on, fish,” he said. But the fish did not come. Instead he lay there wallowing now in the seas and the old man pulled the skiff upon to him.

- Afrohu, peshk, - i tha. Por peshku nuk u afrua. Në vend që të afrohej, ai lëkundej i qetë mbi valët dhe plaku e çoi barkën pranë tij.

Në **paragrafin e katërqindpesëdhjetenëntë** autori i tekstit burimor ka përdorur 140 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 150 fjalë, domethënë, 10 fjalë më shumë.

Krahaso:

When he was even with him and had the fish’s head against the bow he could not believe his size. But he untied the harpoon rope from the bitt, passed it through the fish’s gills and out his jaws, made a turn around his sword then passed the rope through the other gill, made another turn around the bill and knotted the double rope and made it fast to the bitt in the bow. He cut the rope then and

went astern to noose the tail. The fish had turned silver from his original purple and silver, and the stripes showed the same pale violet colour as his tail. They were wider than a man's hand with his fingers spread and the fish's eye looked as detached as the mirrors in a periscope or as a saint in a procession.

Kur e afroi fare pranë dhe kur koka e peshkut ishte përballë bashit, plaku nuk mund t'u besonte syve se ishte aq i madh. E hoqi litarin e fuzhnjës nga hallka e bashit, e kaloi midis verzave dhe nofullave të peshkut, e hodhi dy herë rrotull shpatës, pastaj e kaloi në verzën tjetër, e mbështolli dhe një herë rreth shpatës dhe, si e bëri nyje të dyfishtë, e lidhi te hallka e bashit. Pastaj e këputi litarin dhe shkoi te kiçi që të lidhte bishtin. Peshku kish marrë tani ngjyrën e argjendtë në vend të ngjyrës parake, që ishte e argjendtë përzier me ngjyrë vjollcë, dhe vijat i dukeshin ngjyrë jargavani të zbehtë, ashtu si dhe bishti. Vijat ishin më të gjera se dora e njeriut me gishtat e hapura dhe syri i peshkut dukej aq shpërfillës, sa dhe pasqyra e periskopit ose sytë e një shenjtori gjatë procesionit fetar.

Në **paragrafin e katërqindëgjashhtëdhjetë** autori i tekstit burimor ka përdorur 58 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 65 fjalë, domethënë, 7 fjalë më shumë.

Krahaso:

"It was the only way to kill him," the old man said. He was feeling better since the water and he knew he would not go away and his head was clear. He's over fifteen hundred pounds the way he is, he thought. Maybe much more. If he dresses out two-thirds of that at thirty cents a pound?

- Vetëm kështu mund ta vrisja, - tha plaku. - Ai e ndjente veten më mirë pasi piu ujë dhe e dinte që nuk do të humbte ndjenjat dhe kokën e kish të kthjellët. Me siguri i kalon të pesë kuintalët, mendoi. Mbase edhe më shumë. Në qoftë se nga kjo peshë nxjerr dy të tretat mish dhe e shes për nëntëdhjetë cent kilogramin, sa para do nxjerr?

Në **paragrafin e katërqindëgjashhtëdhjetenjë** autori i tekstit burimor ka përdorur 56 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 60 fjalë, domethënë, 4 fjalë më shumë.

Krahaso:

"I need a pencil for that," he said. "My head is not that clear. But I think the great DiMaggio would be proud of me today. I had no bone spurs. But the hands and the back hurt truly." I wonder what a bone spur is, he thought. Maybe we have them without knowing of it.

- Për këtë hesap më duhet lapsi, - tha. - Koka ime s'është kaq e kthjellët. Por mendoj se Di Maxhoja i madh do të ishte sot krenar për mua. Unë s'e kam kallon e kockës. Por duart dhe shpina më dhembin vërtet. Ç'të jetë vallë kjo kalloja e kockës? Mbase e kemi dhe ne këtë gjë, pa e ditur që e kemi.

Në **paragrafin e katërqindëgjashtëdhjetedytë** autori i tekstit burimor ka përdorur 92 fjalë, ndërsa autori i tekstit përkthimor përkatës ka përdorur 101 fjalë, domethënë, 9 fjalë më shumë.

Krahaso:

He made the fish fast to bow and stern and to the middle thwart. He was so big it was like lashing a much bigger skiff alongside. He cut a piece of line and tied the fish's lower jaw against his bill so his mouth would not open and they would sail as cleanly as possible. Then he stepped the mast and, with the stick that was his gaff and with his boom rigged, the patched sail drew, the boat began to move, and half lying in the stern he sailed south-west.

